

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Manuali i Mbikëqyrjes me Bazë Rreziku të Fondeve Vullnetare të Pensionit



Falenderime

Dëshirojmë të falenderojmë Bordin e Autoritetit dhe stafin e tij për mikpritjen dhe ndihmën, me falenderime të veçanta për stafin e mbikëqyrjes së fondeve të pensioneve dhe investimeve si dhe kolegë të lidhur me këtë staf, përkushtimi dhe angazhimi i të cilëve ka kontribuar kaq shumë për hartimin e këtij manuali

Grupi i Bankës Botërore, financuar nga Nisma FIRST,
2016

Pasqyra e lëndës

Kapitulli 1. Metodologjia	6
Hyrje në Manual.....	6
Objektivat e mbikëqyrjes	6
Çfarë nënkuptojmë me mbikëqyrje me bazë rreziku	7
Zinxhiri i vlerës për realizimin e mbikëqyrjes me bazë rrezikun.....	10
<i>Roli i proceseve analitike dhe të inspektimit për të monitoruar përmbushjen e pritshmërive të AMF-së</i>	<i>12</i>
Konceptet e vlerësimit të rrezikut që përdoren në këtë Udhëzues	13
<i>Reagimi (qëndrimi) mbikëqyrës – ndikimi në sjellje.....</i>	<i>16</i>
<i>Përse me bazë rreziku: përfitimet dhe sfidat</i>	<i>17</i>
Komiteti i Rrezikut për Fondet e Pensionit	20
Kapitulli 2. Vlerësimi i rrezikut dhe planifikimi për zbutjen e rreziqeve	24
Strategjitë e zbutjes së rrezikut	25
HAPI 1: Identifikimi i rreziqeve në tregun e fondeve të pensionit	27
HAPI 2: Vlerësimi i rrezikut në tregun e fondeve të pensionit	30
<i>Kontributet për vlerësimin</i>	<i>30</i>
<i>Ndikimi i pranishëm</i>	<i>32</i>
<i>Probabiliteti i pranishëm.....</i>	<i>33</i>
<i>Vlerësimi i rrezikut të pranishëm – faktorë të tjerë për t’u marrë në konsideratë</i>	<i>34</i>
<i>Procesi i vlerësimit të rrezikut të pranishëm</i>	<i>35</i>
<i>Marrja në konsideratë e vlerësimit të rrezikut të mbetur.....</i>	<i>38</i>
<i>Efektet e vlerësimit të rrezikut në strategjitë e zbutjes së rrezikut.....</i>	<i>38</i>
<i>Përditësimi i profileve specifike të shoqërive</i>	<i>40</i>
HAPI 3: Përgatitja/rishikimi i strategjisë së zbutjes së rrezikut të pensioneve	41
<i>Strategjitë që përfshijnë analizën dhe inspektimin në vend, përfshi qeverisjen e shoqërisë</i>	<i>43</i>
<i>Alternativa të tjera strategjike dhe pasojat.....</i>	<i>45</i>
HAPI 4: Përgatitja e planit të mbikëqyrjes	46
<i>Plani i vitit të parë.....</i>	<i>49</i>
<i>Të dhëna për Strategjinë Afat Mesme të AMF-së.....</i>	<i>49</i>
HAPI 5: Përfundimi i ciklit të strategjisë për zbutjen e rrezikut.....	49
Zbatimi	49
<i>Raportimi gjatë vitit</i>	<i>50</i>
<i>Shqyrtimi i fundvitit.....</i>	<i>50</i>
Kapitulli3. Përcaktimi dhe vlerësimi i rezultateve të veprimtarisë së inspektimit në vend dhe analizës.....	51
Parimet mbikëqyrëse të zbutjes së rrezikut (përfshi qeverisjen)	51
Qasja e përgjithshme ndaj vlerësimit të rrezikut.....	53
<i>Vlerësimi i parimeve të mbikëqyrjes</i>	<i>54</i>
<i>Kombinimi i vlerësimeve të parimeve në vlerësimin e rrezikut të mbetur.....</i>	<i>57</i>
<i>Faktorizimi i pasojave negative në vlerësimin e rrezikut të mbetur</i>	<i>61</i>
<i>Përdorimi i matjeve të rrezikut të mbetur</i>	<i>62</i>
Matja dhe vlerësimi i qeverisjes së shoqërisë administruese	63
Konsiderata të përgjithshme	63
Parimet e mbikëqyrjes së qeverisjes	65

Vlerësimi i strategjive të investimeve dhe inspektimet në vend në shoqëritë administruese	66
<i>Parimet e investimit</i>	66
Vlerësimi i rreziqeve operacionale në shoqërinë administruese	73
Vlerësimi i rreziqeve të biznesit në shoqëritë administruese	76
Vlerësimi i zbutjes së rrezikut të depozitarëve	78
Kapitulli4. Analiza dokumentare (off-site)	81
<i>Qëllimet e analizës dokumentare (off-site)</i>	81
<i>Planifikimi i analizës dokumentare (off-site)</i>	82
<i>Marrja e të dhënave për analizën off-site</i>	83
<i>Dokumentimi i analizës dokumentare (off-site) dhe përfundimet</i>	83
<i>Veprimi(et) në vijim</i>	83
<i>Veprimet në përgjigje të gjetjeve serioze nga analiza e dokumentare (off-site)</i> ..	84
<i>Sigurimi i cilësisë</i>	85
Analizat specifike	85
Shqyrtim i procesverbalit të Këshillit të shoqërisë dhe i komitetit të investimeve...	86
Analizat e raporteve të auditimit dhe marrëdhënia me audituesit	87
Analiza e deklaratave të parimeve të investimit ose dokumenta të tjerë për strategjinë e investimeve	87
Analiza e portofolit të investimeve	87
Analiza e të dhënave financiare nga shoqëritë administruese dhe depozitarët	89
Testimi i materialit të marketingut	89
Shqyrtimi i transfertave nga fondet e pensionit	89
Analiza e planit të biznesit të shoqërisë administruese	90
<i>Analiza e kapitalit të shoqërisë administruese</i>	90
Kapitulli5. Inspektimet në vend të shoqërive administruese dhe depozitarëve	91
Vështrim i përgjithshëm	91
<i>Llojet e inspektimit</i>	91
<i>Qëllimet dhe procesi i përgjithshëm</i>	92
Qasja e përgjithshme ndaj vlerësimit dhe dokumentimit	93
<i>Formularët e Planifikimit të Mbikëqyrjes dhe Vlerësimit (FPMV)</i>	94
<i>Vlerësimi i lidhur me kategoritë e rrezikut dhe qeverisjen e shoqërisë administruese</i>	94
HAPI 1: Planifikimi i inspektimeve në vend	95
<i>Kërkesat paraprake të inspektimit</i>	97
<i>Përgatitja e pyetjeve dhe e testeve</i>	97
<i>Aspekte specifike për inspektimet e depozitarit</i>	99
HAPI 2: Ndërmarrja dhe dokumentimi i inspektimeve në vend	100
<i>Takimi fillestar</i>	100
<i>Raundi i parë i intervistave</i>	100
<i>Takimi i ndërmjetëm i vlerësimit</i>	102
<i>Testimi në vend</i>	103
<i>Intervistat pasuese</i>	104
HAPI 3: Vlerësimi i zbutjes dhe shqyrtimi i rreziqeve	105
HAPI 4: Raportimi dhe sigurimi i cilësisë	105
<i>Verifikimi i gjetjeve dhe vlerësimi i tyre</i>	105
<i>Dokumentimi i gjetjeve të inspektimit</i>	105

<i>Draft-raporti i inspektimit – përgatitja dhe sigurimi i cilësisë</i>	<i>106</i>
<i>Mbledhja përfundimtare dhe pranimi i konkluzioneve dhe rekomandimeve</i>	<i>106</i>
<i>Raporti Final</i>	<i>107</i>
HAPI 5: Ndërhyrja dhe ndjekja në vijimësi	108
<i>Përshkallëzimi i nivelit të ndërhyrjes në përputhje me nivelin e rrezikut</i>	<i>108</i>
<i>Rekomandimet pasuese</i>	<i>112</i>
Aneksi	114
Lista e shtojcave	114
Lista e materialeve	114

Kapitulli 1. Metodologjia

Hyrje në Manual

- 1.1 Objektivi i këtij manuali është t'i sigurojë AMF-së material thelbësor referimi për të mundësuar zbatimin nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) të mbikëqyrjes me bazë rreziku të tregut të fondeve të pensionit vullnetar. Duke e bërë këtë, ai plotëson trajnimet dhe zhvillimet e tjera që po ndodhin për të përditësuar kuadrin mbikëqyrës të pensioneve në vend. Ky manual nuk ka për qëllim të jetë një enciklopedi gjithëpërfshirëse me zgjidhje të gatshme që trajton të gjitha problemet e përditshme të mbikëqyrjes së pensioneve në Shqipëri. Më shumë, shpresojmë që ai të mbulojë një gamë të mjaftueshme problemesh, në thellësinë e duhur për të lehtësuar hartimin e qasjeve praktike ndaj problemeve të ndryshme e të paparashikueshme që do të lindin.
- 1.2 Një mjet i rëndësishëm për përmbushjen e këtij objektivi është përqendrimi te konceptet themelore dhe parimet ku ato mbështeten. Po kështu, manuali vendos theksin te proceset kryesore dhe modelet që duhen rishikuar e rifreskuar, të paktën çdo vit. Këto produkte përbëjnë manualin dhe sigurohen që qasja mbikëqyrëse të jetë e përditësuar.
- 1.3 Duke qenë se një prej shoqërive administruese të fondeve të pensionit është gjithashtu përgjegjëse edhe për fondet e investimit, në praktikë, një pjesë e madhe e këtij manuali gjen zbatim edhe për tregun e fondit të investimeve, të paktën deri kur të përgatitet një manual i veçantë për fondin e investimeve.

Objektivat e mbikëqyrjes

- 1.4 Objektivi i AMF-së për mbikëqyrjen e pensioneve është:

“Inkurajimi i pensioneve të financuara në mënyrë të qëndrueshme duke maksimizuar pjesëmarrjen e punëdhënësit, punëmarrësit dhe atë individuale përmes një sistemi të besuar, efikas dhe të drejtë, që, në një periudhë afatgjatë, iu shton vlerë të ardhurave nga pensioni”.

- 1.5 Arsyeimi drejt këtij objektivi dhe efekteve të tij përfshin sa vijon:

- Qëllimi në themel të politikës publike për sistemin e pensioneve është përmirësimi i të ardhurave nga pensioni për qytetarët shqiptarë në mënyrë të qëndrueshme, duke lehtësuar mbështetjen të të ardhurat e qeverisë, që duhen për t'i mbajtur pensionistët jashtë varfërisë. Sa më shumë punëdhënës e punëmarrës të marrin pjesë në sistem dhe sa më shumë të kontribuojnë ata, aq më shumë duhet që sistemi ta realizojë këtë qëllim. Prandaj, objektivi primar është ndërmarrja e atyre veprimeve që do të **inkurajojnë dhe mbështesin rritjen e mbulimit**.
- Duke qenë se pjesëmarrja në sistemin e pensioneve është vullnetare, nëse mbulimi do të rritet në mënyrë të qëndrueshme, është me rëndësi jetike që kontribuesit, punëmarrësit dhe publiku **t'i besojnë** sistemit dhe, kështu, duhen ndërmarrë veprime që sigurojnë se besimi është i bazuar dhe i mbështetur. Veçanërisht, çdo humbje nga

mashtimi apo gabimi duhet shmangur ose, në çdo rast, të korrigohet pa vonesë. Shërbimi i ofruar duhet të jetë në kohë dhe me kompetencë. Informacioni që jepet lidhur me sistemin duhet të jetë i saktë, jo çorientues dhe të sigurojë një llogaridhënie transparente për administrimin e fondeve të besuara.

- Një prej parakushteve për besimin te sistemi është që ai të jetë i drejtë dhe të duket se është **i drejtë**. Kjo nënkupton që kontribuesit të marrin përfitime në përputhje me rregullat e sistemit dhe që asnjë kategori e tyre të mos favorizohet në mënyrë të padrejtë në raport me kategoritë e tjera në vendimet që merren lidhur me sistemin.
- Një tjetër parakusht për besimin është që institucionet e përfshira në administrimin e fondeve të pensionit të jenë të **shëndosha** nga pikëpamja financiare dhe e administrimit dhe të shihen si të tilla, si dhe që sistemi të jetë në mënyrë të dukshme i financuar plotësisht gjatë gjithë kohës me likuiditet të mjaftueshëm për të bërë pagesat në kohë.
- Thelbi i sistemit është që kontributet administrohen dhe investohen në mënyrë që, për një periudhë afatgjatë, të maksimizohet fitimi i tyre, ndaj, për këtë, është e nevojshme që ai të jetë **efikas**, po aq sa edhe praktik. Efikasiteti është me rëndësi për ndërtimin e besimit dhe për pjesëmarrjen, duke qenë se kontribuesit dhe punëmarrësit duan të shohin një performancë më të mirë sesa ajo që mund të arrihet, në rast se i mbajnë kontributet vetë. Në të vërtetë, ata duan të shohin **vlerën afatgjatë** që iu shtohet produkteve.

1.6 Për ta realizuar këtë objektiv AMF-ja zbaton një qasje me bazë rreziku lidhur me legjislacionin dhe rregulloret e reja ose të rishikuara, si edhe për mbikëqyrjen e fondeve të pensionit, shoqërive administruese dhe depozitarëve.

Çfarë nënkuptojmë me mbikëqyrje me bazë rreziku

1.7 Mbikëqyrja moderne me bazë rreziku për fondet e pensionit mund të shihet e mbështetur mbi gjashtë shtylla kryesore, të cilat ofrojnë një metodologji për konceptimin e një zgjidhje të fokusuar për Shqipërinë, më shumë sesa një plan i imponuar së jashtmi. Këto gjashtë shtylla janë:

- i. Fillohet me një objektiv të përqendruar te rezultati afatgjatë për mbikëqyrësin;
- ii. Mbahet përqendrimi te rreziqet e sistemit dhe subjektit;
- iii. Përdorimi i një game instrumentesh për vlerësimin dhe kuptimin e rrezikut dhe zgjidhjeve, përfshi instrumentet sasiore, kur është nevoja;
- iv. Zhvillimi i mirëqeverisjes së fondeve të pensionit dhe menaxhimit të rrezikut të fondit të pensioneve, si mënyra kryesore për zbutjen e rreziqeve;
- v. Bëhet përzgjedhja me bazë rreziku të enteve dhe subjekteve për përqendrimin e mbikëqyrjes; dhe
- vi. Së pari parandalimi dhe korrigjimi, më pas, me sanksione dhe ekzekutimi për problemet kritike ose të vazhdueshme.

1.8 Mbikëqyrja me bazë rreziku (MBR) e fondeve të pensionit është identifikuar nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS) si pjesë e rëndësishme e

paketës së mbikëqyrjes dhe parashikohet nga Parimet e Mbikëqyrjes të IOPS-së¹. IOPS-ja e përkufizon MBR-në si:

Qasje e strukturuar që përqendrohet në identifikimin e rreziqeve të mundshme, me të cilat përballen planet ose fondet e pensionit dhe vlerësimi i faktorëve financiarë e operativë në fuqi, për të minimizuar dhe zbutur këto rreziqe. Ky proces, më pas, e lejon autoritetin mbikëqyrës t'i drejtojë burimet e veta drejt çështjeve dhe subjekteve që paraqesin kërcënimet më të mëdha.

1.9 Konceptet kryesore të përfshira në këtë përkufizim janë:

- **Strukturimi** i qasjes: shumica e mbikëqyrësve gjykojnë për rrezikun kur marrin vendime mbi përparësitë apo reagimet e mbikëqyrjes. MBR-ja përfshin zbatimin e një strukture për vendimet mbi rrezikun, me qëllim që t'i bëjë ato më të njëtrajtshme, me qëllim që të mund të mbrohen, nëse kundërshtohen. Është thelbësore të vërejmë se struktura nuk zëvendëson vendimet, por, më shumë, ofron një kuadër dhe dokumentacion për krijimin dhe justifikimin e gjykimeve në mënyrë transparente e të njëtrajtshme.
- Faza e parë e vëmendjes është **identifikimi i rreziqeve** të objektivave të mbikëqyrësit, që meqë duhet të jenë në përputhje me objektivat e sistemit, janë, rrjedhimisht, rreziqe për sistemin². Këndvështrimi për rrezikun duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe pavarësisht nëse mbikëqyrësi ka kompetenca apo detyra të caktuara që lidhen me rreziqet. Një problem i zakonshëm është kur mbikëqyrësit i shpërfillojnë rreziqet, pasi është e vështirë të merresh me to në kuadrin e kompetencave ekzistuese të mbikëqyrësit. Brenda identifikimit të rrezikut ka edhe një lloj vlerësimi të nënkuptuar të seriozitetit të rreziqeve dhe prandaj iu duhet kushtuar vëmendje.
- Faza e dytë e vëmendjes është **vlerësimi sesa mirë po zbuten tanimë rreziqet**, qoftë kjo përmes mbikëqyrjes ekzistuese, efektit rregullator, strukturës së tregut ose stimuljt që kanë pasur subjektet e mbikëqyrura. Në praktikë, vëmendje e madhe i kushtohet masave zbutëse brenda subjekteve, por mbikëqyrësi duhet të shohë më gjerë të gjitha masat zbutëse ekzistuese. E nënkuptuar brenda vlerësimit të rrezikut është edhe matja e besueshmërisë së zbutjes dhe krijimi apo forcimi i masave zbutëse të tilla, me qëllim që rreziku të ulet në një nivel të pranueshëm.
- Së fundi, MBR-ja përdoret për të **vendosur përparësi në ndërhyrje**, duke marrë parasysh nivelin aktual të rrezikut, vlerën që ka gjasë t'i shtohet nga veprimi i mëtejshëm dhe burimet e vlefshme. Këto mund të jenë ndërhyrje në nivel subjekti apo sistemi, përfshi rekomandimin e rregulloreve të përmirësuara dhe të përfshijnë edhe planifikimin e mbikëqyrjes.

1.10 Qasja e bazuar në rrezik e përqendron përgjegjësinë për ta mbajtur institucionin të sigurt dhe të shëndetshëm aty ku duhet - të këshilli mbikëqyrës dhe drejtuesit e lartë të shoqërive administruuese dhe depozitarët e tyre. Është përgjegjësia e tyre që të kenë politika dhe praktika ekzistuese të menaxhimit të rrezikut dhe zbutjes së duhur të rreziqeve domethënëse që shoqërojnë punën. Procesi i ndryshimit për mbështetje më të madhe në qeverisjen e shoqërisë dhe në menaxhimin e rrezikut, paralelizon modelin e “tre


¹Dokumentet e Punës të IOPS-së për Mbikëqyrjen Efektive të Pensioneve, Nr.16, “Struktura e Autoriteteve Mbikëqyrëse të Pensioneve dhe qasja e tyre ndaj Mbikëqyrjes me Bazë Rreziku”, korrik 2012.

²Ato mund të jenë një nëngrup i rreziqeve të sistemit, ku për disa prej rreziqeve mbajnë përgjegjësi organizma të tjera qeveritare.

linjave të mbrojtjes” në Basel II dhe është ilustruar në Figurën 1 më poshtë – në përmbledhje:

- Mbikëqyrja e përputhshmërisë, e bazuar në rregulla, synon të fokusohet në transaksionet dhe në dobësitë specifike të kontrolleve të brendshme, të cilat mund të rezultojnë në dukuri negative.
- Kjo mbikëqyrje e nivelit të ulët dyfishon rolin qeverisës të Këshillit Mbikëqyrës, për faktin se Këshilli duhet të ketë mekanizmat e vet, një linjë të dytë mbrojtëse, për t’u siguruar që ka kontrolle të brendshme efektive për të parandaluar apo zbuluar ngjarjet negative. Këtu përfshihet auditimi, menaxhimi i rrezikut dhe funksionet e përputhshmërisë me bazën ligjore, si edhe mbikëqyrja e drejtuesve të nivelit të lartë. Kur këto nuk ekzistojnë, vëmendja kryesore shkon për t’u siguruar që ato të miratohen ose t’i ndalohet subjektit të merret me biznes.
- Miratimi i mbikëqyrjes me bazë rreziku e zhvendos përqendrimin mbikëqyrës tek efektiviteti i veprimeve që ka ndërmarrë Bordi për t’u siguruar se ka kontroll të brendshëm efektiv dhe se ngjarjet negative janë parandaluar apo zbuluar. Në këtë mënyrë, mbikëqyrësi kërkon të mbështetet në qeverisjen e subjektit si linja e parë e mbikëqyrjes.
- Përqendrimi te qeverisja mundëson, gjithashtu, marrjen në konsideratë të politikave strategjike të shoqërisë, që mund të sjellin si rezultat efekte negative të qëllimshme që, duke qenë të tilla, nuk do të zbulohen nga sistemi i kontrollit.

Figura 1: Mbikëqyrja me bazë rreziku zhvendos vëmendjen drej kontrolleve të nivelit të lartë dhe qeverisjes




1.11 Edhe pse manuali i referohet gjatë gjithë kohës mbikëqyrjes me bazë rreziku, në praktikë ai përfshin të gjitha veprimet që mund të ndërmarrë AMF për të arritur objektivin e saj, përfshi propozimin apo kryerjen e ndryshimeve rregullatore dhe shfrytëzimin e ndikimit të saj te pjesëmarrësit e industrisë, kur fuqitë rregullatore janë të pamjaftueshme, joefektive ose të papërshtatshme. Disa strategji mbështeten vetëm në atë që, tradicionalisht, përshkruhet si “mbikëqyrje”, disa të tjera te përmirësimi i

rregullave, por disa i përfshijnë të dyja këto që funksionojnë krah për krah me njëra-tjetrën. Në të gjitha rastet, kur bëhet zgjedhja e alternativave për zbatim, duhen krahasuar kostot dhe përfitimet përkatëse të instrumenteve rregullatore, duke pasur parasysh se rregullat mund të mos jenë efektive për aq kohë sa nuk mbikëqyrren në mënyrë efektive. Kështu, metodologjia e parashtruar në këtë manual mund të konceptohet më mirë si mbikëqyrje dhe rregullim me bazë rrezikun.

Zinxhiri i vlerës për realizimin e mbikëqyrjes me bazë rrezikun

1.12 Në thelb, procesi i mbikëqyrjes me bazë rrezikun përfshin identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe zbutjen e rreziqeve lidhur me objektivin e AMF-së, në mënyrë të tillë që të jetë i qëndrueshëm dhe i mundshëm për t'u mbrojtur. Për këtë duhet që i gjithë procesi i AMF-së për mbikëqyrjen e pensioneve të jetë bazuar në rrezik për të gjitha veprimtaritë që lidhen me pensionet, qofshin mbikëqyrëse apo rregullatore. Këto mund të shihen si përbërëse të një zinxhiri vlere, që fillon me marrjen e të dhënave dhe përfundon me vlerësimin e performancës, që qëndron në themel të arritjes së objektivit të AMF-së. Vetë zinxhiri i vlerës mbështetet nga organizimi dhe burimet e duhura (Figura 2).

Figura 2: Zinxhiri i vlerës për realizimin e mbikëqyrjes së pensioneve nga AMF-ja



1.13 Zinxhiri i vlerës për realizimin e objektivit të AMF-së është si vijon:

- i. Ai fillon me të dhënat që merr AMF, financiare, sasiore dhe cilësore, prej një sërë burimesh të ndryshme, përfshin inspektimin në vend, që e kthen në informacion të përdorshëm për sistemin e pensioneve dhe subjektet e tij. Të dhënat e përftuara duhet të jenë minimumi i mjaftueshëm për të ofruar informacion, pasi të jenë analizuar, mbi

- nivelin e rrezikut të pranishëm dhe të mbetur në sistem dhe në secilin prej subjekteve (në atë pikë ku rreziku i pranishëm ndryshon midis subjekteve)³.
- ii. Më pas, **informacioni mbi rrezikun analizohet**, në mënyrë që të identifikojë kategoritë kryesore të rrezikut dhe të mundësojë përllogaritjen e nivelit të rrezikut, sa i përket probabilitetit dhe ndikimit, qoftë në sistem, ashtu edhe për secilin subjekt. Kjo nuk është shkencë ekzakte dhe një lloj gjykimi subjektiv është i pashmangshëm, sidomos në lidhje me ndikimin ku përfshihen lloje të ndryshme ndikimesh, shpesh të pamundura për t'u llogaritur. Përveç kësaj AMF-ja ka nevojë për hipoteza se cilat ndryshime të sjelljes dhe masa zbutëse duhet të ulin nivelin e secilit prej rreziqeve. Shkalla e efektivitetit të këtyre ndryshimeve dhe masave zbutëse, si dhe pasojat e dështimeve të masave zbutëse ofrojnë një matje të përafërt të probabilitetit të materializimit të rreziqeve.
 - iii. Analizat e rrezikut përbëjnë bazën për **strategjitë e zbutjes së rrezikut**, të hartuara për të zvogëluar rreziqet e mbetura të vlerësuara dhe të pranishme në sistem deri në një nivel të tolerueshëm ose për t'i mbajtur ato aty, si dhe t'i mundësojnë AMF-së, nëpërmjet inspektimit dhe analizës, që të marrë mbështetje në përfshirjen e disa llojeve të ndryshme të veprimeve, të cilat shpeshherë do të përfshijnë inspektime në vend dhe analiza dokumentare (off-site), por të cilat mund të përfshijnë, krahas saj, veprime të tjera siç është ndryshimi rregullator. Strategjitë mund të përmbajnë një gamë të gjerë veprimesh, mes të cilave inspektimet në vend dhe analizat dokumentare janë një element i rëndësishëm, por mund të mos jetë i mjaftueshëm. Strategjitë e rrezikut janë pjesë përbërëse e një strategjie të përgjithshme të mbikëqyrjes së pensioneve që lejon caktimin e përparësive për burimet brenda dhe midis viteve dhe ekipeve të AMF-së.
 - iv. Më pas, alternativat për ndryshimin e sjelljes së pritshme nga subjektet e mbikëqyrura të përcaktuara me përparësi në strategjitë e zbutjes së rrezikut **zbatohen dhe komunikohen**. Është me rëndësi që AMF-ja të komunikojë me subjektet e mbikëqyrura dhe aktorët e tjerë lidhur me atë çfarë është e nevojshme për të zbutur rrezikun. Kjo mund të drejtohet nga Departamenti i Mbikëqyrjes ose nga departamente të tjera në varësi të llojit të komunikimit që është parashikuar. Është thelbësore të kuptohet se komunikimi është një instrument themelor i mbikëqyrjes. Ai mund të përfshijë ndryshimet e propozuara rregullatore, që inkurajojnë veprimin në përputhje me pritshmëritë e AMF-së.
 - v. Përputhshmëria në mbikëqyrjen me bazë rreziku i referohet **përputhjes me sjelljet e pritshme nga AMF-ja**, të cilat shprehen, veçanërisht, në parimet mbikëqyrëse të mirëqeverisjes dhe menaxhimit të rrezikut dhe, kur bëhet fjalë për vlerësimin e zbutjes së rrezikut, përfshijnë përputhshmërinë rregullatore. Kjo monitorohet me inspektime në vend dhe analiza të dokumenteve, që përqendrohen në rreziqet më të larta dhe masat zbutëse përkatëse dhe planifikohen e dokumentohen në vijimësi, me qëllim që gjykimet mbi rezultatet e kontrollit të jenë të njëjtrajshme.
 - vi. AMF-ja ndërmerr **veprime për të bindur subjektet** të korrigjojnë çdo rast në të cilin njësitë e mbikëqyrura nuk përmbushin pritshmëritë e saj. Forca e mekanizmave bindëse të përdorura varet nga sa serioz është rreziku, qëndrimi mbikëqyrës i AMF-së dhe, kur problemet janë serioze, ato mund të përfshijnë sanksione dhe ndërhyrje.
 - vii. Së fundi, **rezultatet e mbikëqyrjes shqyrtohen** për të ushqyer me informacion analizën e rrezikut dhe rishikimin e strategjive apo hartimin e atyre të reja, duke e plotësuar

³ Të dhënat që merren jashtë terrenit për çdo subjekt të mbikëqyrur përcaktohen në fillim të Kapitullit 4 dhe në Materialin 4.1. Aktualisht, rreziku i pranishëm nuk ndryshon midis subjekteve, por në Kapitullin 2 shpjegohet përse kjo mund të ndryshojë.


ciklin. Këtu përfshihet ndryshimi i klasifikimit të rreziqeve në subjektet e mbikëqyrura, në përputhje me rezultatet e kontrollit.

- 1.14 Këto hapa të zinxhirit të vlerës shpjegohen në rubrikat e mëtejshme të këtij manuali. Është me rëndësi të vërehet se qasja me bazë rrezikun duhet plotësuar me orientimin drejt një qeverisje dhe menaxhimi rreziku më të fortë të subjektit, për shkak të mbështetjes në rritje të mbikëqyrësit të këshilli mbikëqyrës dhe drejtuesit të lartë, për t'u siguruar që institucioni t'i ulë rreziqet në sistem në minimum.
- 1.15 Kështu, është me rëndësi jetike që të ketë komunikim efektiv me subjektet e mbikëqyrura lidhur me atë çka AMF pret prej tyre – ky, në të vërtetë, është elementi kryesor në zinxhirin e vlerës dhe nuk duhet anashkaluar. Në pikëpamjen konceptuale, ai përbën fazën e parë të modelit "EME" për të bindur subjektet që të ndryshojnë sjellje, si vijon:
- **Eduko:** sigurohu që subjektet e mbikëqyrura të kuptojnë atë çka pritet prej tyre;
 - **Mundëso/oriento:** ndihmo subjektet e mbikëqyrura të zbatojnë atë çka pritet prej tyre përmes procesit të kontrollit; dhe
 - **Ekzekuto:** ndërmerr veprime të synuara, kur subjektet e mbikëqyrura nuk tregohen të gatshme të zbatojnë vullnetarisht atë çka AMF-ja pret prej tyre.

Roli i proceseve analitike dhe të inspektimit për të monitoruar përmbushjen e pritshmërive të AMF-së

- 1.16 Edhe pse ky Manual mbulon të gjitha aspektet e mbikëqyrjes së pensioneve, një element i rëndësishëm i udhëzimit të tij orientohet te procesi në vijim (ilustrohet në Figurën 3):
- Përcaktimi nga procesi i planifikimit, i dokumentuar në Kapitullin 2, saktësisht cilat rreziqe duhen shqyrtuar dhe nga kush (Kapitulli 3);
 - Hartimi i parimeve mbikëqyrëse të asaj çka përbën praktikën më të mirë të shoqërisë administruese në qeverisje dhe menaxhim rreziku, me qëllim zbutjen e rreziqeve (Kapitulli 3);
 - Ndërmarrja e analizave dhe monitorimit mbështetur në dokumente, të përcaktuara në strategjitë e rrezikut dhe të nevojshme për të lejuar pyetje hulumtuese gjatë inspektimeve në vend dhe për të kuptuar shenjat e hershme paralajmëruese të problemeve të mëdha (Kapitulli 4);
 - Kryerja e intervistave në vend, për të ndihmuar në vlerësimin e cilësisë që qeverisjes dhe menaxhimit të rrezikut të subjektit (Kapitulli 5);
 - Ndjekja e intervistave me verifikime në vend, për të përfutur të dhëna pohuese në terren (Kapitulli 5);
 - Përcaktimi dhe vlerësimi i rreziqeve dhe qeverisjes në bazën e parimeve vlerësuese dhe të dhënave të përfutura (Kapitulli 3).

Figura 3: Fazat e përcaktimit dhe vlerësimit të rreziqeve përmes proceseve analitike dhe të kontrollit



1.17 Është gjithnjë me rëndësi të kuptojmë se ka edhe të tjera masa për zbutjen e rrezikut që nuk mbulohen nga kjo qasje, që përfshijnë posaçërisht kontrollet e depozitarëve, por edhe rregullimin, kërkimin, komunikimin dhe bindjen. Kjo nuk i bën ato më pak të rëndësishme dhe nuk duhen lënë mënjanë.

Konceptet e vlerësimit të rrezikut që përdoren në këtë Manual


1.18 Ekzistojnë disa koncepte kyçe të vlerësimit të rrezikut që duhet t'i njohim:

- i. **Çdo kategori rreziku ka dy përmasa.** Ajo duhet përcaktuar sa i përket (1) ngjarjes që sjell pasojën negative dhe (2) pasojave negative që mund të vijnë nëse rreziku konkretizohet. Këto përmasa mund të klasifikohen në kuptimin e **probabilitetit dhe ndikimit**.
- ii. **Tabloja e rrezikut** është shpërndarja e rreziqeve të përkufizuara nga AMF-ja, kategorizuar sipas probabilitetit dhe ndikimit, përgjatë sistemit në tërësi. Ajo duhet të orientojë strategjinë e mbikëqyrjes së pensioneve nga AMF-ja.

- iii. **Vlerësimi i rrezikut të subjektit** tregon shkallën në të cilën niveli i çdo rreziku në një subjekt ndryshon nga vlerësimi për të gjithë sistemin. Kështu, nëse një rrezik vlerësohet si më i ulët se mesatarja në shoqërinë administruese, disa prej masave të zbutjes së rrezikut të AMF-së, shpesh, mund të mos jenë të nevojshme për t'u zbatuar ose nuk duhen fare në atë subjekt. Kjo metodologji nuk parashikon një vlerësim të vetëm për të gjitha rreziqet në subjekt, pasi siguria se një rrezik është i zbutur mjaftueshëm, mund të mos vlejë për një rrezik tjetër – kështu, mbikëqyrja bazuar në mesataren e të gjitha rreziqeve në një subjekt mund të sjellë si rezultat që rreziqeve të mëdha të mos iu kushtohet vëmendje e mjaftueshme apo që kjo vëmendje për rreziqet e vogla të jetë më shumë sesa duhet. Kur duhen bërë zgjedhje midis subjekteve për t'u inspektuar, kjo duhet mbështetur në dallimet e vlerësimeve të rreziqeve të larta, si edhe në peshën e subjektit.
 - iv. **Rreziku i pranishëm** është niveli i rrezikut që perceptohet se do të ekzistonte, në rast se AMF-ja nuk do të mbështetej te qeverisja apo menaxhimi i rrezikut në subjektet e mbikëqyrura, duke mbajtur parasysh se niveli bazë i qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe përputhshmërisë ligjore do të ekzistonte, sidoqoftë, kur subjektet janë të interesuara që të jetë kështu. Vëmendja e përgjithshme e AMF-së te rreziqe të ndryshme duhet të jetë gjerësisht në raport të drejtë me tablonë e rrezikut të pranishëm.
 - v. **Rreziku i mbetur** është niveli i rrezikut i vlerësuar aktualisht, duke marrë parasysh qeverisjen dhe menaxhimin e rrezikut në shoqëri, sipas vlerësimit prej mbikëqyrjes së AMF-së. Hendeku midis rrezikut të pranishëm dhe atij të mbetur tregon rëndësinë e masave aktuale zbutëse të AMF-së dhe, kështu, përparësinë për të vazhduar e për t'i mbështetur me burime.
 - vi. **Niveli i pranueshëm rreziku** është niveli i rrezikut të mbetur që nuk kërkon përpjekje të mëtejshme për zbutjen e rrezikut nga AMF-ja, duke qenë se kjo përpjekje nuk do të ishte në raport të drejtë. Hendeku midis rrezikut të mbetur dhe nivelit të tolerueshëm të rrezikut ofron një tregues për punën shtesë që duhet të bëjë AMF-ja për të zbutur rrezikun dhe, veçanërisht, për të bindur subjektet e mbikëqyrura që ta menaxhojnë rrezikun më mirë. AMF-ja duhet të jetë e hapur rreth nivelit të rrezikut që do të pranojë - AMF-ja nuk mund të parandalojë të gjitha rreziqet pa përpjekje të shpërpjesëtuar.
 - vii. Probabiliteti (dhe, në disa raste, ndikimi) i një rreziku mund të ulet me anë të **zbutjes së rrezikut**. Kjo mund të marrë njërën ose të dyja format. Ose siguria mund të merret nga masat zbutëse, të cilat tashmë operojnë në sistem, të tilla si qeverisja, politikat dhe procedurat e kontrollit të zbatuara në praktikë nga shoqëritë administruese dhe depozitarët. Ose AMF-ja mund të ndërmarrë veprime që synojnë zvogëlimin e nivelit të rrezikut, të tilla si ndryshimi në rregullore ose bindja e subjekteve të mbikëqyrura për të ndryshuar sjelljen e tyre ose për të përmirësuar qeverisjen apo kontrollin. Proceset e inspektimit mund të arrijnë të dyja format e zbutjes. Në çdo rast, niveli i vlerësuar i rrezikut mund të zvogëlohet vetëm kur AMF-ja ka siguruar prova se zbutjet janë të efektshme.
- 1.19 Vlerësimi i rrezikut në mënyrë të pashmangshme mbështetet në gjykimin e mbikëqyrjes, bazuar në evidencën e disponueshme. Kjo evidencë shpeshherë është cilësore por, për të qenë e mbrojtur dhe e qëndrueshme, duhet ende të strukturohet, siç jepet në Kapitullin 3. Për të ndihmuar në vlerësimin e disa rreziqeve, janë të disponueshme disa analiza sasiore, siç jepet në Kapitullin 4. Shtojca 2 jep udhëzime për mënyrën se si mund të kombinohen të gjitha burimet e evidencës për të vlerësuar

rrezikun. AMF-ja duhet të marrë në konsideratë në mënyrë të vazhdueshme nëse mund të gjenden mënyra të tjera të përcaktimit sasior për të forcuar bazën e provës (evidencës).

Figura 4: Matrica e rrezikut për sistemin



1.20 Përkufizimi i secilës kategori rreziku që përdoret në matricë është si vijon:

Probabiliteti

- **I lartë:** rreziku është materializuar tanimë dhe/ose duket sikur do të rrijë siç është ose ka gjasë të përsëritet së shpejti, ose duket sikur do të ndodhë së shpejti, pa veprimin parandalues të AMF-së. Pa masë zbutëse, është afër së pashmangshmes.
- **I mesëm i lartë:** rreziku është materializuar edhe pse jo për një kohë të gjatë, ose ka gjasë të materializohet në një pikë të caktuar gjatë viteve të ardhshme. Pa masë zbutëse, ka gjasë të ndodhë dikur.
- **I mesëm i ulët:** ka mundësi të arsyeshme që rreziku të materializohet, edhe pse nuk është materializuar për një kohë të caktuar dhe ka gjasë pak ose aspak të ndodhë. Pa masë zbutëse, ka ende të ngjarë të mos ndodhë, por rreziku ekziston.
- **I ulët:** rreziku nuk është materializuar dhe do të materializohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Pa masa zbutëse nuk mund të përjashtohet tërësisht. Po të ishte kështu, nuk do të ishte rrezik.

Ndikimi

- **I lartë:** dështim i madh në arritjen e objektivave të sistemit (dhe AMF-së), që ka çuar në humbjen e besimit publik ose politik në sistem ose në një situatë ku shumë persona, të cilëve iu takon, nuk marrin të ardhurat e pensionit nga sistemi apo shumë pjesëmarrës humbin një pjesë të madhe të akumulimit të pensionit, të themi, të paktën 20%.
- **I mesëm i lartë:** shumë kontribues marrin më pak të ardhura nga pensioni, sesa do të merrnin po t'i kishin mbajtur paratë në depozita bankare ose njerëzit nuk bëhen pjesë e sistemit apo nuk qëndrojnë aty, për shkak të cilësisë së ulët të shërbimit ose rezultateve të përftuara, ose prej dëmit që i është bërë emrit të sistemit dhe jo më pak, për shkak se ofruesit e shërbimeve përfitojnë nga ai në mënyrë të padrejtë.
- **I mesëm i ulët:** shumë përfitues marrin më pak të ardhura nga pensioni sesa do të merrnin nëse sistemi do të realizonte objektivat e veta apo disa përfitues pësojnë humbje më të mëdha të të ardhurave; ose disa dëme të përkohshme të perceptimit të përgjithshëm apo të përfituesve për sistemin, për shembull për shkak të problemeve me shërbimet e ofruara, teknikat e shitjes, spekulimin e perceptuar ose krizën në një shoqëri administrimi të pensioneve.
- **I ulët:** asnjë ndikim i menjëhershëm mbi rezultatet apo emrin që ka sistemi, edhe pse vetëm pak përfitues mund të jenë vendosur në pozita të pavoritshme ose një shoqëri administruese duhet të ndërmarrë veprime korrigjuese për të shmangur ndikime më të mëdha apo për të qenë në përputhje me ligjin.

1.23 Çdo kuti e matricës është e koduar me ngjyrë, sipas nivelit të duhur të reagimit të AMF-së, në raport me intensitetin e inspektimit/analizës dhe shkallës së seriozitetit të veprimit të ndërmarrë nga AMF-ja me subjektet ku konstatohen probleme (qëndrimi mbikëqyrës) – shih rubrikën tjetër.

Reagimi (qëndrimi) mbikëqyrës – ndikimi në sjellje

1.24 Përgjatë proceseve të dokumentuara në këtë manual, duhet mbajtur gjithnjë parasysh se qëllimi i mbikëqyrjes është të ndikojë sjelljen, me qëllim që të ulë rrezikun në lidhje me arritjen e objektivave të AMF-së për mbikëqyrjen e fondeve të pensionit. Ashtu siç shpjegohet në paragrafin 1.15, kjo mund të arrihet, zakonisht, me anë të edukimit dhe mundësimit/orientimit. Megjithatë, mund të duhet veprim për të ekzekutuar kërkesat e ligjit apo praktikën e mirë, sipas përkufizimit në parimet e gjithëpranuara të mbikëqyrjes, kur problemet janë serioze ose të vazhdueshme apo për të ndërhyrë, me qëllim parandalimin e humbjeve për përfituesit.

1.25 Llojet e veprimeve në dispozicion të AMF-së për të ndikuar sjelljen ilustrohen në Figurën 5 më poshtë, e cila është e koduar me ngjyra afërsisht në përputhje me nivelin e rrezikut **të mbetur** në linjë me veprimin përkatës. Kjo është e dhënë në vija të përgjithshme, duke qenë se gama e vlefshme e ndërhyrjeve mund të jetë më e gjerë, sidomos në skajin e sipërm. Më shumë hollësi jepen në Hapin 5 të Kapitullit 5 (që mund të gjejë zbatim si për aktivitetin mbikëqyrës në vend dhe atë dokumentar).

Figura 5: Piramida e zbatimit/shkalla e ndërhyrjes



Përse me bazë rreziku: përfitimet dhe sfidat

1.26 Mbikëqyrësit në mbarë botën kanë konstatuar se, krahasuar me metodologjinë tradicionale, qasja me bazë rreziku është një bazë më efektive dhe më efikase për arritjen e objektivave të mbikëqyrjes. Përvoja tregon se problemet në institucionet e dështuara nuk mund t'i atribuoheshin mosrespektimit të legjislacionit apo dispozitave rregullore. Në të kundërt, në thuajse çdo rast, problemi ishin praktikat e dobëta të menaxhimit, mungesa e kontroleve të mjaftueshme financiare dhe mospasja e sistemeve të përshtatshme të menaxhimit të rrezikut. Kështu, u bë e qartë se sistemi mbikëqyrës do të ishte shumë më efektiv, po të siguronte paralajmërime të hershme të problemeve që haseshin, duke dhënë mundësi për ndërhyrje të hershme dhe efektive, në rast se mbikëqyrësi do të ishte përqendruar te menaxhimi i rreziqeve të biznesit nga subjektet, më shumë se te cilësia e të dhënave të transaksioneve apo probleme të vogla të përputhshmërisë.

1.27 Për ta përmbledhur, mbikëqyrja me bazë rrezikun është thelbësore për mbikëqyrjen efikase dhe efektive të sistemeve të fondeve të pensionit vullnetar, pasi:

- **Mbikëqyrja e përqendruar te përputhshmëria me rregullat nuk identifikon apo trajton disa prej rreziqeve më të rëndësishme** – për shembull, shfrytëzimi i tepërt i investimeve për t'iu sjellë përfitime ndërmjetësve mund të mos jetë shprehimisht i ndaluar, por mund t'i shtohet në mënyrë të konsiderueshme kostove që iu faturohen llogarive të përfituesve.
- **Për rrjedhojë, objektivi parësor është rritja e tërheqjes drejt rreziqeve më serioze, përmes mbikëqyrjes intensive dhe të përqendruar, me synimin për t'i zbutur ato** – këto rreziqe karakterizohen përgjithësisht nga probleme principal/agjenci dhe mungesë të qenësishme transparence, duke përfshirë, shpesh, qeverisjen e pamjaftueshme.
- **Për ta bërë këtë me burime të kufizuara, mbikëqyrësi duhet të lirojë burimet që aktualisht shkojnë për rreziqe më pak serioze, si burimet e shpenzuara për përmbushjen e**

hollësishtme ligjore mund të shpenzohen më mirë për të siguruar mirëqeverisje dhe menaxhim të rrezikut, si dhe për ato rreziqe ku problemet autorizues/agjenci nënkuptojnë se shoqëritë kanë pak stimul për të ulur rrezikun e të ardhurave përfundimtare për anëtarin nga pensioni.


- **Posaçërisht, duke u mbështetur më shumë te subjektet e mbikëqyrura që ato t'i menaxhojnë vetë rreziqet më pak serioze,** për shembull, shumë rreziqe operative janë problem më i madh për shoqëritë administruese, sesa janë për kuotambajtësit, kështu, shoqëritë administruese kanë stimul më të fortë për t'i administruar ato në mënyrë efektive. Kontributi mbikëqyrës mund të përqendrohet, më pas, për t'u siguruar që qeverisja të jetë mjaftueshëm efektive dhe që rreziqet të menaxhohen.
- **Kontrolli efektiv i rreziqeve kërkon që subjektet të kenë qeverisje dhe sisteme efektive të menaxhimit të rrezikut,** në të kundërt, AMF-ja nuk ka asnjë siguri që edhe ato rreziqe që menaxhohen mirë do të qëndrojnë ashtu. Po kështu, ajo nuk mund të ketë siguri që subjektet e mbikëqyrura kanë nivel të mirë të përmbushjes ligjore, kështu, ky duhet të jetë fokus kryesor i mbikëqyrjes.

1.28 Tipare të tjera që sjellin avantazhe:

- **Proaktiviteti:** Mbikëqyrja me bazë rrezikun tejkalon disa prej dizavantazheve të qasjes bazuar në rregulla, duke punuar në mënyrë proaktive për të zbatuar uljen e rrezikut dhe masat e kontrollit përpara sesa situata të shndërrohet në kritike. Nëse veprimet e hershme mund të parandalojnë problemet e mundshme përpara sesa ato të ndodhin, situata do të përmirësohet shumë. Ky është koncept i mirënjohur i shëndetit publik: është më mirë që t'i ruajmë shëndetin pjesëtarëve të publikut, sesa t'i lëmë ata të sëmuren dhe, më pas, të përpiqemi t'i kurojmë.
- **I strukturuar dhe konsistent:** në praktikë, thuajse të gjithë mbikëqyrësit gjykojnë në bazë të rrezikut. Mbikëqyrja me bazë rreziku ofron strukturë dhe njëtrajtshmëri për vendimet e tyre. Synimi është që personeli mbikëqyrës të reagojë në mënyrë të njëjtë në të njëjtat rrethana dhe të marrë vendime duke përdorur variabla të matjes së rrezikut për të cilat është rënë dakord.
- **Transparent:** duke qenë se rreziqet dhe masat për zbutjen e tyre komunikohen publikisht, subjektet e mbikëqyrura dhe aktorët e tjerë janë të vetëdijshme për atë çka pritët si praktikë e mirë – nuk ka surpriza. Për këtë arsye, parimet e mbikëqyrjes ndaj të cilave subjektet duhet të vlerësohen, duhet të ndahen me subjektet. Megjithatë, kjo transparencë, nuk duhet të zgjatet deri në proceset e detajuara të përdorura për vlerësim. Pasi bihet dakord se si duhet të jetë një praktikë e mirë, diskutimet që vijnë duhet të përqendrohen te fakti nëse po veprohet në përputhje me të.
- **Zbaton zgjidhjen më të mirë apo kombinimin e zgjidhjeve për rreziqet:** Siç tregohet në Figurën 6 më poshtë, ka një sërë ndërhyrjesh të mundshme që AMF-ja është në gjendje të ndërmarrë. Ato shkojnë nga rregullat e reja, në inspektimet në vend apo analizat dokumentare, deri te komunikimi dhe orientimi. Një prej përfitimeve kryesore të mbikëqyrjes së konceptuar mirë me bazë rrezikun (përfshi rregullimet), që rrjedh nga përqendrimi për të arritur objektivat afatgjata, është se organizata mund të marrë në konsideratë të gjitha instrumentet e mundshme që i vijnë në ndihmë. Për më tepër, kur kjo qasje lidhet me procesin e analizës vjetore, organizata mund të provojë një qasje, të vlerësojë përfitimet dhe, më tej, të provojë ndërhyrje të ndryshme, kur është nevoja.

- **Në raport të drejtë me madhësinë dhe zhvillimin e tregut ose subjekteve të mbikëqyrura:** mbikëqyrja me bazë rrezikun bën të mundur një qasje të mbrojtshme për nivelin e ndryshueshëm të angazhimit mbikëqyrës, në varësi të masës të tregut apo të subjekteve individuale. Më tej, duke qenë dinamik, intensiteti mund të rritet menjëherë, në rast se madhësia e tregut ose e subjekteve (dhe, po ashtu, ndikimi i mundshëm i dështimeve) rritet. Kështu, qasja e dokumentuar në këtë manual mund të zbatohet “pa probleme” për sa kohë tregu është relativisht i vogël e i papjekur, por është i mbrojtur në të ardhmen nga çdo rasti që mbulimi i pensioneve të rritet dhe kundrejt maturimit të provigjioneve.
- **Potencialisht më në përputhje me mbikëqyrjen e tregjeve të tjera:** duke qenë se mbikëqyrja kryhet në bazë të parimeve të përgjithshme të praktikës së mirë, më shumë sesa të kriterëve ligjore specifike për pensionet, ka gjasa që të ketë më shumë të përbashkëta në qasje me tregjet e tjera ku këto parime gjejnë, po ashtu, zbatim. Në të vërtetë, disa prej materialeve në këtë manual mund të përkthehen edhe për tregjet e tjera. Kështu, AMF-ja dhe drejtuesit e personeli i subjekteve duhet ta kenë më të lehtë të zhvendosen midis pensioneve dhe tregjeve të tjera të shërbimeve financiare.

Figura 6: Ndërhyrjet e mundshme që mund të ndërmerren nga AMF-ja në bazë të strategjive të zbutjes së rrezikut



1.29 Sfidat e zbatimit të mbikëqyrjes me bazë rreziku përfshijnë:

- **Të dhëna më të forta apo më të vështira për t’u përfutur mund të duhen për të justifikuar gjetjet e mbikëqyrjes:** të dëshmosh se qeverisja apo, për shembull, strategjitë e investimeve nuk janë në përputhje me pritshmëritë e AMF-së mund të jetë më e vështirë sesa të provosh se kërkesa të caktuara ligjore nuk janë përmbushur. Edhe pse kjo mund të bëhet më e lehtë nëse rregullorja parashikon shprehimisht standardet e sjelljes së pritshme, ende mund të ketë subjektivitet të pashmangshëm. Në praktikë, në vend të veprimeve ligjore mund të jetë përdorur trysnia morale, për t’iu kërkuar subjekteve të mbikëqyrura që të respektojnë vendimet e AMF-së. Po kështu, është e nevojshme që cilësia e dokumentacionit në mbështetje të vendimit të jetë e mjaftueshme, në rast se çështja kundërshtohet në gjykatë.

- **Ekspertizë dhe kompetencë më e madhe e personelit mbikëqyrës krahasuar me qasjen me bazë rregullat.** Qasja me bazë rrezikun kërkon që mbikëqyrësi të diskutojë aktivitetet dhe planet e ardhshme të shoqërisë administruese me pjesëtarët e këshillit mbikëqyrës, pasi ata janë njerëz vendimet e të cilëve kanë ndikim në kryerjen e detyrave të besuara të shoqërisë drejt përfituesve të saj. Ata duhet të jenë në gjendje të bindin anëtarët e këshillit mbikëqyrës se e kuptojnë punën e tyre dhe se rekomandimet e tyre janë të mbështetura mirë. Kjo është shumë më komplekse dhe kërkuese sesa thjesht të vlerësosh nëse një transaksion i caktuar është në përputhje me legjislacionin. Vazhdimësia dhe trajnimi i personelit janë thelbësore. Duke qenë se përvoja dhe ekspertiza e anëtarëve të ekipit mbikëqyrës ndryshon, është me rëndësi që vlerësimi i rreziqeve dhe masave zbutëse, bashkë me formulimin e rekomandimeve, të bëhet në kuadër të qasjes në ekip, për qëllime njëtrajtshmërie dhe zhvillimi të personelit.
- **Anëtarët e këshillit mbikëqyrës të subjekteve të mbikëqyrura ka të ngjarë të jenë më rezistentë ndaj rekomandimeve që lidhen me strategjitë e qeverisjes dhe biznesit,** duke theksuar më tej sesa e rëndësishme është që personeli mbikëqyrës të jetë i besueshëm, si edhe t'i sfidosh ata të nxjerrin përfundime e rekomandime që janë të bazuara dhe të detyrueshme.
- **Inspektimi në vend merr edhe më shumë kuptim sesa në qasjen tradicionale ndaj mbikëqyrjes.** Kjo ndodh sepse shumica e informacionit të kërkuar nga mbikëqyrësi për të vlerësuar menaxhimin e rrezikut është i njëjtë ose i ngjashëm me informacionin që i duhet drejtuesve të subjektit për të menaxhuar biznesin dhe për të hartuar dhe zbatuar strategjitë e tyre të biznesit. Më tej, qeverisja vlerësohet kryesisht përmes intervistave. Proçeset e planifikimit, kryerjes dhe dokumentimit të inspektimeve duhet të jenë, për rrjedhojë, gjithëpërfshirëse dhe të forta.
- **Mbikëqyrja me bazë rreziku është më efektive kur këshillat mbikëqyrëse të subjekteve të mbikëqyrura kanë aftësitë dhe botëkuptimin për t'i menaxhuar të gjitha rreziqet e tyre efektivisht.** Në pikën ku ata nuk e arrijnë këtë, ekziston sfida për të punuar në partneritet me ta, për rritjen e kapaciteteve.

Komiteti i Rrezikut për Fondet e Pensionit

1.30 Mbikëqyrja me bazë rreziku është një proces për futjen në sistem dhe dokumentimin e gjykimeve dhe vendimeve pasuese bazuar në vlerësimin e rrezikut, jo për të zëvendësuar gjykimin mbikëqyrës. Kështu, ekziston nevoja për zhvillimin e një procesi të shëndoshë për t'iu dhënë vlerë gjykimeve kryesore për vlerësimin e rrezikut. Komiteti i Rrezikut për Fondet e Pensionit është ngritur për këtë qëllim. Synimi i tij është të sigurohet se ekziston komunikim efektiv midis gjithë personave në AMF që janë përgjegjës për veprimet e ndërmarra lidhur me mbikëqyrjen dhe zbutjen e rreziqeve në sistemin vullnetar të pensioneve. Kjo përfshin edhe pasjen e një kuptimi të përbashkët për rreziqet në treg, që mbështetet në të gjitha këndvështrimet e disponueshme dhe përkthehet në një strategji për vlerësimin dhe zbutjen e tyre. Në mënyrë të veçantë, është kriter që i gjithë informacioni që Drejtoritë e tjera kanë në lidhje me pensionet vullnetare, shoqëritë e administrimit dhe depozitarët duhet të njoftohet menjëherë tek Departamenti i Mbikëqyrjes dhe një funksion i Komitetit është që të kontrollojë nëse kjo ndodh në praktikë.

1.31 Përbërja e Komitetit paraqitet në Kutinë 1 më poshtë. Roli i Sekretarisë përfshin sigurinë që takimet e Komitetit organizohen sipas nevojës dhe i sigurojnë anëtarët e Komitetit paraprakisht informacionin përkatës, për t'i mundësuar Komitetit që të jetë i mirëpërgatitur për të marrë në konsideratë çështjet e ngritura. Komiteti duhet të mbledhet të paktën një herë në gjashtë muaj, me një axhendë të përgatitur, e cila mund të përfshijë⁴:

- Çdo anëtar përditëson Komitetin lidhur me zhvillimet që kanë të bëjnë me pensionet vullnetare. Për hir të efikasitetit të Komitetit, do të ishte me dobi që ato çështje që mund të komunikohen përmes postës elektronike përpara mbledhjes, të përcilleshin në këtë mënyrë;
- Ndan informacion lidhur me ecurinë e rezultateve të masave të ndërmarra, për vlerësimin dhe zbutjen e rreziqeve në treg, por pa cënuar detyrimin e fshehtësisë dhe përgjegjësinë e drejtuesve të lartë dhe Bordit për të miratuar përgjigjet formale ndaj problemeve të konstatuara;
- Bie dakord çdo vit për vlerësimin e rreziqeve të pranishëm në sistem dhe, në periudhat midis, merr në konsideratë nëse vlerësimi duhet të ndryshojë. Kjo mbulohet nga Hapi 3 në Kapitullin 2 të këtij Manuali⁵. Pika fillestare e vlerësimit do të jetë informacioni i dhënë përpara dhe gjatë takimit, por pa rritur në mënyrë të shpërpjesëtuar ngarkesën e punës. Ky vlerësim duhet mbështetur me informacion nga anëtarët e tjerë të Komitetit dhe të testohet përmes pyetjeve të anëtarëve të Komitetit;
- Merr në konsideratë përgjigjet ndaj rreziqeve më akute ose të reja në sistem dhe fushën e veprimit për nisma të reja ose të ndryshuara për zbutjen e tyre;
- Informon çdo vit të gjitha palët e interesuara për strategjinë e vlerësimit dhe zbutjes së rreziqeve që prekin fondet e pensionit, duke dhënë mundësinë për marrjen e kontributeve, sidomos lidhur me veprimtaritë që janë ndërmarrë apo mund të ndërmerren jashtë ekipit mbikëqyrës të pensioneve.

Kutia 1: Përbërja e Komitetit të Rrezikut për Pensionet me rolet përkatëse

- **Të gjithë:** japin kontribut vetjak për vlerësimin e rrezikut të pranishëm në sistemin e pensioneve dhe e ndajnë këtë informacion për të informuar përgjigje efektive dhe përpjesëtimore ndaj rreziqeve. Komiteti nuk ka për qëllim të zëvendësojë komunikimin ballë për ballë me Autoritetin apo të minojë linjat e menaxhimit dhe kontrollit brenda Autoritetit.
- **Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve:** kryeson mbledhjet, merr vendime në emër të departamentit të mbikëqyrjes, kërkon të arrijë marrëveshje, i drejtohet Drejtorit ekzekutiv, nëse ka ndryshime në pikëpamje që nuk mund të zgjidhen, i raporton Drejtorit Ekzekutiv, sa herë që është e nevojshme. Ai/ajo siguron që një person i përshtatshëm të drejtojë takimin në mungesë të tij/saj.

⁴ Ndonjëherë do të jetë e nevojshme të bëhet një takim i Komitetit jashtë takimeve normale, në rast të ndryshimit thelbësor të panoramës së rrezikut, e cila mund të rezultojë në një vlerësim të ri për një ose më shumë nga rreziqet e natyrshme. Shefi i Mbikëqyrjes është përgjegjës për të thirrur takimin (për të kërkuar organizimin e mbledhjes).

⁵ Kjo pjesë e manualit mund të shpërndahet në dobi të të gjithë personave që marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit, për të shpëtuar ata që kanë për të lexuar të gjithë Manualin, dhe me të vërtetë mund të shpërndahet si një rregullore e brendshme.

- **Drejtori ekzekutiv ose Zëvendësdrejtori ekzekutiv:** vëzhgon dhe mbështet Drejtorin e Departamentit të Mbikëqyrjes. Mund të marrë përsipër rolin e Kryetarit të Mbikëqyrjes, nëse ai nuk është. Mund të drejtojë veprimet që përfshijnë bashkëpunimin me Bankën Qendrore, Autoritetin Tatimor ose agjenci të tjera qeveritare.
- **Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve:** sekretar i komitetit dhe vepron si kryetar në qoftë se caktohet kështu nga Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes. Kërkon që të sigurojë se ka komunikim efektiv në çështjet që lidhen me pensionet ndërmjet Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamenteve të tjera. Në veçanti, ofron përmbledhje të informacionit herë pas here për anëtarët e tjerë të komitetit. Paraqet tablonë e rrezikut të pranishëm dhe rrezikut të mbetur, së bashku me strategjitë për zbutjen e rrezikut që janë caktuar si parësore dhe rezultatet e mbikëqyrjes dhe shqetësimet e ngritura nga subjektet mbikëqyrëse. Kur dalin probleme serioze, shpjegon se si kjo mund të ndryshojë tablonë e rrezikut dhe konsulton rrugëzgjdhjet e mundshme që mund të jenë kontribute në strategjitë e mbikëqyrjes, duke u mbështetur te të dhënat nga Mbikëqyrja dhe Kërkimi. Ndërmerr veprim për çdo rekomandim lidhur me mbikëqyrjen e pensioneve, për të cilin Komiteti ka rënë dakord.
- **Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve ose Përfaqësues nga Drejtoria me përvojë në fushën e pensioneve:** përditëson Komitetin lidhur me zhvillimet përkatëse në fushën e mbikëqyrjes dhe analizës së sigurimeve, të ndërmarra në mbështetje të strategjive për zbutjen e rrezikut. Bie dakord ose komenton për punën analitike që duhet kryer nga kjo Drejtori në mbështetje të strategjive të zbutjes së rrezikut apo inspektimeve në vend. I raporton drejtorisë për zhvillimet në mbikëqyrjen e pensioneve dhe analizën e rrezikut të pranishëm, që lidhet me punën e Drejtorisë.
- **Drejtor i Drejtorisë së Statistikës ose Përfaqësues i Drejtorisë me përvojë në fushën e pensioneve:** përditëson Komitetin me informacione lidhur me pensionet nga aktivitetet më të fundit kërkimore, të TI-së, statistikore dhe marrëdhëniet me publikun. Bie dakord ose komenton punën e kryer, për të dhënë më shumë informacion për rreziqet e pranishme ose për të mbështetur strategjitë e zbutjes së rreziqeve. Drejton strategjinë për rritjen e mbulimit dhe raporton mbi ecurinë e saj, si dhe dëgjon nga të tjerët komente se sa efektive duket ajo dhe kërkon mbështetjen e nevojshme nga Drejtoria e Mbikëqyrjes. Po kështu, merr drejtimin për çdo veprimtari të marrëdhënies me publikun për të cilën është rënë dakord, përfshi edukimin e publikut. Bie dakord me kontributet që personeli i TI-së i ofron mbikëqyrjes. I raporton kësaj drejtorie për zhvillimet në mbikëqyrjen e fondeve të pensionit dhe analizën e rrezikut të pranishëm, që mund të ketë lidhje me punën e drejtorisë.
- **Përgjegjësi i Zyrës së Licencimit në Departamentin e Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve ose Përfaqësues i Drejtorisë me përvojë në fushën e pensioneve:** përditëson Komitetin lidhur me informacionet përkatëse nga veprimtaria e licencimit dhe monitorimit, kontrollit e përshtatshmërisë dhe puna për sjelljen e tregut. Veçanërisht, ai vë në pah problemet e lindura dhe mund të ofrojë bazën për një përgjigje mbikëqyrëse. Bie dakord me çdo veprim të ri zbutës për Drejtorinë, që rrjedh prej strategjive për zbutjen e rrezikut. I raporton kësaj Drejtorie lidhur me zhvillimet në mbikëqyrjen e pensioneve dhe analizën e rreziqeve të pranishëm që mund të vlejnjë për punën e Drejtorisë.
- **Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Integritetit ose Përfaqësues i Drejtorisë me përvojë në fushën e pensioneve:** përditëson Komitetin me informacionet përkatëse nga veprimtaria zbatuese, ankesat dhe trajtimin e mbrojtjes së konsumatorit, hartimin dhe miratimin e legjislacionit. Komenton lidhur me nevojën, karakterin praktik dhe konceptimin e çdo akti ligjor të ri që propozohet nga Drejtoria e Mbikëqyrjes në strategjitë e saj për zbutjen e rreziqeve apo si kundërpërgjigje ndaj problemeve të shfaqura. Komenton mbi karakterin praktik dhe nevojën për ndërmarrjen e veprimeve ekzekutuese që Mbikëqyrja

merr në konsideratë. I raporton kësaj Drejtorie për zhvillimet në fushën e mbikëqyrjes së pensioneve dhe për analizën e rrezikut të pranishëm, që mund të jetë me vlerë për punën e Drejtorisë.


- **Drejtori i Drejtorisë së Mbrojtjes Konsumatore, në rast se rendi i ditës lidhet me punën e tyre:** përditëson Komitetin për trajnimet që janë në dispozicion dhe sa efektive kanë qenë ato. Jep kontribute për vendimet lidhur me caktimin si detyrim apo ofrimin e trajnimeve për anëtarët e këshillit ose profesionistët e pensioneve. I komunikon kësaj drejtorie se çfarë bën mbikëqyrja e pensioneve dhe përse.
- Do të ishte me dobi për funksionimin efektiv të Komitetit, nëse departamentet dhe drejtoritë e ndryshme të lartpërmendura do të ruanin një lloj vazhdimësie në përfaqësim.
- Përveç kësaj, anëtarë të tjerë të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve duhet të marrin pjesë në mbledhje si vëzhgues, për të ofruar kontribute të specializuara, kur është nevoja, të reagojnë ndaj informacionit të marrë nga diku tjetër në AMF dhe të mbajnë të dhënat.

Kapitulli 2. Vlerësimi i rrezikut dhe planifikimi për zbutjen e rreziqeve

- 2.1 Ashtu siç e thotë edhe titulli, vlerësimi i rrezikut është thelbësor për qasjen me bazë rrezikun. Strategjitë të cilat lindin nga analiza e rrezikut duhet të informojnë planet vjetore dhe, kur ka ndërlkime të konsiderueshme, Strategjinë Afat Mesme të AMF-së. Kur konsiderohen ose planifikon veprimtari mbikëqyrëse, personeli i përfshirë duhet të jetë i qartë lidhur me rreziqet e përfshira dhe sesi propozohet që këto rreziqe të zbuten. Aktiviteti duhet të zhvillohet vetëm nëse përpjekja e bërë është në raport të drejtë me rreziqet e përfshira.
- 2.2 Kështu, mbikëqyrja me bazë rrezikun është proces dinamik me rivlerësim sistematik të faktit se ku gjenden rreziqet më serioze dhe sa përpjekje duhen, nëse duhen, zbatuar për të ulur rreziqet. Vlerësimet ndryshojnë gjatë kohës, pasi AMF të ketë krijuar besim në mënyrën se si zbuten disa nga rreziqet dhe identifikon kërcënime të reja ndaj ofrimit të pensionit për anëtarët ose për imazhin e tregut. Identifikimi dhe analiza e rreziqeve në treg ndërmerren në periudha të ndryshme, për arsye të ndryshme. Këto vlerësime, që kontribuojnë në ciklin vjetor dhe ilustrohen në Figurën 7 më poshtë, janë si vijon:
- **Kontrolli i mjedisit:** gjatë gjithë vitit, AMF-ja monitoron zhvillimet në mjedisin e jashtëm të cilat ndikojnë në fondet e pensionit, nga informacionet publike, bashkërendimi me organet e tjera mbikëqyrëse dhe informacionet e disponueshme kudo në AMF.
 - **Vlerësimi i rrezikut të mbetur:** në rast se veprimtaria mbikëqyrëse e vitit është përfunduar (më së shumti), të themi, në tetor, rreziku i mbetur në sistem mund të vlerësohet duke marrë parasysh rezultatet e vlerësimeve të rrezikut të mbetur që janë bërë nga subjekti, si rezultat i veprimtarive mbikëqyrëse gjatë vitit (dhe gjatë viteve të mëparshme për ato rreziqe që nuk janë vlerësuar gjatë vitit).
 - **Vlerësimi i rrezikut të pranishëm:** kjo është përcaktuar në ciklet e mëparshme, por duhet rishikuar çdo vit, nga Komiteti i Koordinimit të Rrezikut të Pensioneve, duke marrë parasysh vlerësimin e rrezikut të mbetur, kontrollin mjedisor dhe ndryshimet e elementeve rregullatore, etj. Faktorët jashtë kontrollit të subjekteve të mbikëqyrura, si ndryshimet e kushteve të tregut financiar apo, thjesht, në shkallën e tregut të pensioneve mund të kenë ndikim.
 - **Rishikimi i strategjive të zbutjes së rrezikut:** strategjitë për zbutjen e rreziqeve deri në një nivel të pranueshëm duhen rishikuar duke pasur parasysh vlerësimet e rrezikut të mbetur dhe të pranishëm. Këto, së bashku me vetë vlerësimet, duhet të konsiderohen të vlefshme dhe të miratohen nga Komiteti i Koordinimit të Rrezikut të Fondeve të Pensionit (paragrafi 2.32 e në vijim), të themi, në fillim të nëntorit.
 - **Koordinimi sipas nevojës me Strategjinë Afat Mesme:** kur veprimet që lindin nga strategjitë e zbutjes së rrezikut, do të kenë ndërlkime të konsiderueshme të burimit në qoftë se janë ndërmarrë paraprakisht, disponueshmëria e këtyre burimeve duhet të justifikohet dhe të konfirmohet në kontekstin e Strategjisë Afat Mesme. Plani miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i AMF-së, le të themi në dhjetor.

- **Zbatimi i veprimtarive off-site dhe on-site:** në përputhje me planin vjetor, rishikimin tremujor të ecurisë dhe ndryshimet në tablonë e rrezikut që duhen pasqyruar në përparësitë e përditësuara apo ndryshuara jashtë ciklit normal vjetor.
- **Vlerësimi i rreziqeve në subjekte:** për secilin subjekt përgatitet një tablo e rrezikut të mbetur, mbi bazën e inspektimeve në vend, duke pasur parasysh edhe rezultatet e analizave dokumentare. Vlerësimi është pika fillestare e vlerësimit të rrezikut të mbetur në fund të vitit.

Figura 7: Cikli vjetor i vlerësimit të rrezikut (datat janë treguese dhe subjekt ndryshimi)



2.3 Duhet theksuar se afatet janë treguese dhe mund të duhet të përshtaten në përputhje me përparësitë e tjera. Proceset e vlerësimit të rrezikut të mbetur dhe të pranishëm, strategjitë, rishikimi i strategjive të zbutjes së rrezikut dhe planifikimi shpjegohen më me hollësi në pjesën e mbetur të këtij kapitulli të manualit. Proceset e vlerësimit të rrezikut të mbetur nga rezultatet e kontrolleve dhe analizave mbulojnë në Kapitullin 3. Kapitujt 4 dhe 5, përkatësisht, mbulojnë inspektimet on-site dhe analizën dokumentare.

Strategjitë e zbutjes së rrezikut

2.4 Përqendrimi te rreziqet më të mëdha, zgjedhja e strategjive të përshtatshme për zbutjen e rrezikut dhe përzgjedhja se cilat rreziqe duhen shqyrtuar dhe në cilin subjekt janë elemente themelore të mbikëqyrjes me bazë rrezikun. Kështu, në qendër të mbikëqyrjes me bazë rrezikun është një metodologji që siguron që AMF të ndërmarrë veprimet më efektive për ta zbutur rrezikun në nivele të pranueshme. Për vlerësimin e nivelit të rreziqeve të ndryshme dhe mënyra si duhen zbutur, duhet kohë dhe përpjekje. Hapat në proces krijojnë një cikël, që ilustron në Figurën 8 më poshtë.

Figura 8: Cikli i strategjisë së rrezikut



2.5 Çdo hap i ciklit trajtohet në rubrikat e mëposhtme dhe është i dokumentuar në formularët e strategjisë së zbutjes së rrezikut, një model i së cilës është Materiali 2.1 i këtij manuali, ndërkohë që grupi aktual i strategjive gjendet në 2.2-2.14. Strategjitë e zbutjes së rrezikut përfshijnë elementet në vijim:

- Identifikimi i rrezikut, në termat e dukurisë dhe pasojave, duke përfshirë të gjitha rreziqet përbërëse të cilat janë subjekt i vlerësimeve të veçanta të nivelit të rrezikut (Hapi 1);
- Vlerësimi i nivelit të rrezikut të pranishëm, i cili mund të paraqitet në mënyrë të veçantë nga të gjithë nën-rreziqet brenda kategorisë (Hapi 2);
- Vlerësimi i nivelit të rrezikut të mbetur që ka lindur nga inspektimi në vend ose nga procedura të tjera përkatëse, të cilat mund të paraqiten në mënyrë të veçantë për të gjithë nën-rreziqet brenda kategorisë ose subjekteve të ndryshme (Hapi 2);
- Qëllimi i AMF-së për të zvogëluar vlerësimin e rrezikut të mbetur (nën rrezikun e pranishëm dhe aktual të mbetur) mbështetur nga inspektimi në vend, analiza dokumentare ose nga burimet e tjera të evidencës (Hapi 3);
- Disa tregues të përparësisë në bazë të nivelit të pranishëm të rrezikut (ngjyra) dhe qëllimi për të zvogëluar rrezikun e mbetur deri në një nivel të tolerueshëm (Hapi 3);


- Çfarë sjelljesh duhet të ndryshohen në qoftë se rreziku i mbetur duhet të zvogëlohet (më tej) – aty ku siguria nuk është kërkuar ende nëpërmjet proceseve të mbikëqyrjes, është e mundur që ndryshimi i nevojshëm tashmë të jetë realitet (Hapi 3);
- Opsionet e disponueshme për zbutjen e rreziqeve që të zvogëlojnë ndikimin e mbetur ose probabilitetin në nivelin e vlerësimit aktual (ose të pritshëm) (Hapi 3);
- Një përmbledhje e opsioneve për të marrë sigurinë ose për të zbutur rreziqet që duhet të ndërmerren më tutje (Hapi 3);
- Opsionet e tjera të disponueshme, të cilat nuk janë ndërmarrë brenda kësaj strategjie (Hapi 3);
- Çfarëdo ndërlikimesh të strategjisë me pasoja për (Hapi 4):
 - Të dhëna ose kritere TI;
 - Aktiviteti i departamentit të komunikimit të AMF-së;
 - Proceset e AMF-së;
 - Trajnimi/kapacitetet ndërtuese të personelit të AMF-së; dhe
 - Aktiviteti i zbatimit.

HAPI 1: Identifikimi i rreziqeve në tregun e fondeve të pensionit

- 2.6 Vlerësimi i rrezikut varet nga përkufizimi i rreziqeve në tregun e fondeve të pensionit. Përkufizimi i saktë për secilin rrezik është thelbësor, nëse duhen marrë masat e duhura zbutëse dhe të kryhen vlerësimet e duhura.
- 2.7 Ka një numër të madh rreziqesh potenciale dhe, në shkallë globale, përdoren disa qasje të ndryshme për ta kategorizuar rrezikun⁶. Qasja për identifikimin dhe përcaktimin e rrezikut që rekomandohet në këtë manual është të procedohet me veprimtaritë në ciklin e pensioneve, nga vendimi për të marrë pjesë në një fond vullnetar pensionesh, deri te pagesa e produktit të pensionit pas daljes nga puna, me një kategori përfundimtare që mbulon vijimësinë e shoqërive administruese. Avantazhi i kategorizimit të rreziqeve me faza përgjatë ciklit të ekzistencës është se ato përkojnë me proceset e shoqërive administruese (ose depozitarët). Kjo nënkupton se vlerësimi i cilësisë të atyre proceseve mund të kontribuojë drejtpërdrejt për vlerësimin e probabilitetit të materializimit të rrezikut. Për të thjeshtuar procesin e vlerësimit të rrezikut, rreziqet e identifikuara në këtë mënyrë janë kombinuar në 13 kategori rreziku me tipare të ngjashme (Figura 9).

⁶Alternativat ndaj qasjes së rekomanduar në këtë Udhëzim fillojnë me llojet e zbutjes së rrezikut (si qeverisja, menaxhimi i rrezikut, korniza e kontrollit të brendshëm, etj.) ose me ndikimet e padëshirueshme (si rreziku i tregut, rreziku i kreditimit, rreziku i nënfinancimit, etj.). Qasja e parë sjell vështirësi në vlerësimin e mirëfilltë të ndikimit, ndërkohë që e fundit është më e përshtatshme për pensionet (dhe sigurimet) me përfitime të përcaktuara, në të cilën mund të përdoret një masë e vetme (mjafatueshmëria e kapitalit) për të matur ndikimin.

Figura 9: Hapat në ciklin e jetës së fondeve të pensionit tregojnë kategoritë e rrezikut të përdorura në këtë Manual



2.8 Kategoritë e rrezikut deri në Maj 2016, të cilat mund të përditësohen në vijmësi, janë:

- Mungesa e pjesëmarrjes:** punëdhënësit ose punëmarrësit nuk marrin pjesë në fondet e pensioneve vullnetare/profesionale, për shkak të mungesës së njohurisë, besimit ose stimulit, duke sjellë për pasojë pamjaftueshmëri në mbulim apo në rezervat e mjaftueshme të duhura të pensionit. (Vini re se çdo efekt mbi pjesëmarrjen nga fitimet e ulëta neto nga investimet mbulohet në kuadrin e rrezikut të investimit strategjik).
- Shitje me mashtrim:** personeli i shoqërisë administruese, shoqëritë mëmë apo agentët e shitjes iu shtrembërojnë paraqitjen e tipareve, përfitimeve apo performancës së fondit të pensioneve anëtarëve të mundshëm apo punëmarrësve sponsorizues, me gojë ose me shkrim ose ua shesin personave të papërshtatshëm, duke sjellë si pasojë që anëtarët të përfundojnë me një produkt të papërshtatshëm dhe, nëse anëtarët në vijim zbulojnë mashtrimin, kjo dëmton imazhin e tregut të fondeve të pensionit. Këtu mund të përfshihet edhe ofrimi i stimuljve me vlerë për punëdhënësit që t'iu ofrojnë fondin e pensioneve punëmarrësve të tyre. Nëse kjo paraqitje e shtrembëruar sjell si rezultat një situatë ku shoqëritë administruese ndihen të detyruara të përqendrohen në performancën afatshkurtër ose atë bruto në vend të asaj neto, kjo mund të çojë në marrjen e vendimeve për investime nën optimale.
- Kontributet:** punëdhënësit ndalojnë ose vonojnë zbritjen ose pagesën e kontributeve për llogari të punëmarrësve në fondet profesionale, duke sjellë si pasojë mundësinë që anëtarët të humbasin kontributet e tyre, të kenë vonesa në marrjen e kthimeve nga investimet mbi kontributet e tyre apo të humbasin besimin te sistemi. Ekziston edhe

rreziku që kontributet hidhen në fonde pensioni për qëllime të pastrimit të parave, duke sjellë pasoja të dëmshme të reputacionit.

4. **Siguria e aseteve— depozitarët:** kontrolli i pamjaftueshëm i depozitarëve iu jep mundësi atyre, ndërmarrjeve financiare, shoqërive administruese ose personelit të secilës prej tyre të transferojë asete jashtë llogarive të anëtarëve, në mënyrë të parregullt ose të parakohshme, përfshi në rastin kur depozitari falimenton, duke sjellë për pasojë humbjen e aseteve të pensionit nga anëtarët dhe dëmtimin e besimit në sistemin e pensioneve.
5. **Siguria e aseteve— shoqëritë administruese:** moskryerja apo anashkalimi i kontrolleve iu jep mundësi drejtuesve ose personelit të shoqërisë të devijojë asetet nga llogaritë e mbajtësve ose asetet humbasin në një farë mënyrë kur shoqëria administruese përballet me probleme financiare, duke sjellë për pasojë një situatë ku anëtarët humbasin para dhe shkaktohet një dëm i rëndë imazhi. Mungesa e besimit të publikut ndaj sigurisë së aseteve është një rrezik i lidhur që mbulohet nga kategoria e pjesëmarrjes, ku edhe e ka ndikimin. Rreziku i humbjes së aseteve si pasojë ose shkak i moskryerjes së kontrolleve efektive nga depozitarët ka strategjinë e vet të veçantë, por është me rëndësi kur vlerësohet zbutja e këtij rreziku.
6. **Investimi – strategjik:** strategjitë e investimeve mbi fondet e pensionit nuk i optimizojnë fitimet me rrezik të korrigjuar për të realizuar të ardhura më të mira pensioni. Në situatën aktuale ky është efektivisht rrezik mbipërqendrimi, për shkak se shumica e investimeve janë në obligacione të qeverisë të RSH-së, shoqëruar me mungesën e mundësive alternative për investim në Shqipëri, mungesën e ekspertizës së shoqërive administruese në investime dhe rreziku i këmbimit valutor për investimet e huaja. Kjo mund të sjellë si pasojë uljen e konsiderueshme të pensioneve dhe të rezultojë në perceptimin nga ana e anëtarit apo punëdhënësit se fitimet nga investimi janë të pamjaftueshme, sidomos nëse ka fitime negative neto që lidhen me llogaritë e depozitave bankare. Rreziku i kreditimit i qeverisë dhe shkalla e pamjaftueshme kontribuojnë gjithashtu te ky rrezik.
7. **Kostot dhe detyrimet:** tarifat për përfituesit e fondeve të pensionit për shërbimet që lidhen me fondin e tyre të pensionit janë shumë të larta krahasimisht me përfitimet nga pensioni ose, kostot e shoqërive administruese janë më të larta sesa është e nevojshme për administrimin efikas të fondeve të pensionit. Rreziku mbulon, gjithashtu, tarifat që bankat iu vendosin anëtarëve të fondit të pensionit për transfertat brenda dhe jashtë llogarive të tyre. Pasojat e mundshme janë pensione më të ulëta dhe humbje e besimit në tregun e fondeve të pensionit.
8. **Menaxhimi i rrezikut të investimeve:** administrimi i përditshëm i portofoleve mund të rezultojë në shmangien e humbjeve për anëtarët.
9. **Operative – mbajtja e regjistrimeve dhe administrimi e mbrojtja e të dhënave:** Përditësimi dhe mbajtja e të dhënave të anëtarëve dhe llogarive të tyre është e pasaktë, e paplotë ose rezulton në nxjerrjen e paligjshme të të dhënave, duke sjellë për pasojë bilance më të ulëta të përfituesve sesa duhet të jenë, në këtë rast vijimësia e shoqërisë administruese kërcënohet nga kostot e pastrimit të të dhënave ose nga dëmtimi i imazhit të tregut. Po kështu, rreziku lidhet edhe me faktin që pajisjet dhe sistemet informatike të shoqërisë administruese të mos jenë kontrolluar mjaftueshëm, duke sjellë kompromentimin e integritetit ose fshehtësisë së të dhënave, që çon në pasoja të ngjashme të dështimit në ruajtjen e të dhënave.
10. **TI dhe vazhdimësia e biznesit:** Rreziku që një shoqëri administruese të mos mundet të ruajë vazhdimësinë e operacioneve pas dështimit të TI-së apo ngjarjeve të tjera katastrofike. Si pasojë, vijimësia e shoqërisë administruese mund të cenohej ose shërbimet e pensioneve të ndërpriteshin dhe, në të dyja rastet, të dëmtohej imazhi i tregut ose të dhënat e përfituesve të mos mund të rikuperoheshin, duke i ekspozuar ata ndaj humbjes.

11. **Pagesat/likuiditeti:** shoqëritë administruese nuk arrijnë të bëjnë pagesa të sakta ose në kohë nga fondet e pensionit kur anëtarët e transferojnë bilancet e tyre, duke sjellë si pasojë vonesën e transferimit të përfitimeve, pagesat e gabuara ose dëmtim të imazhit të tregut.
12. **Zgjedhja e produkteve të paguara:** mbajtësve të fondit të pensionit mund t’iu shiten produkte të pagesës së pensionit me tarifa shumë të larta ose tërheqja me para e një sasive që duhej mbajtur në sistem për të ofruar të ardhura të vazhdueshme gjatë pensionit, largimit nga sistemi i pensioneve herët, në vend të grumbullimit të pensionit ose nuk kuptojnë çfarë duhet të presin në pension. Pasoja mund të jetë përfitime më të ulëta të pensionit nga ato që duhet të jenë, paratë përfundojnë përpara vdekjes ose dëmtohet imazhi i tregut.
13. **Vijimësia e shoqërisë administruese:** vështirësitë financiare ose falimenti në shoqërinë administruese sjell si rezultat ndërprerje të zgjatur të shërbimit ose dëmtim të imazhit të tregut. Kjo përfshin, gjithashtu, rastin kur shoqëria mëmë e shoqërisë administruese mbyll qëllimisht biznesin, për shkak të trysnisë financiare.

2.9 Mbikëqyrja duhet të jetë elastike për t’u përballur me rrethanat në ndryshim dhe, kështu, këto kategori e përkufizime rreziku mund të ndryshojnë me kalimin e kohës.

2.10 Ashtu siç përcaktohet në paragrafin 1.20 më lart, përkufizimi i secilit prej rreziqeve lidhet me ngjarjen që shkakton problemin, ndjekur nga ndikimi i materializimit të ngjarjes. Është e qartë se ndikimi i materializimit të rrezikut mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme, por, në këtë metodologji, përkufizimet përfshijnë ndikimin më të rëndë. Nëse rreziku ndodh, por është më pak i rëndë nga çfarë parashikohet në përkufizimin e rrezikut, kjo pasojë mund të mendohet si informuese për probabilitetin e konkretizimit të rastit më të keq. Se si bëhet kjo, trajtohet nga Kapitulli 3.

HAPI 2: Vlerësimi i rrezikut në tregun e fondeve të pensionit

2.11 Krijimi i një ideje lidhur me sistemin e pensioneve dhe fondet e pensionit dhe rreziqet e tyre unike është thelbësor për zinxhirin e vlerës të mbikëqyrjes me bazë rrezikun dhe ofron informacion për qasjen ndaj veprimtarisë së mbikëqyrjes. Matricat e tablosë së rrezikut në treg duhen rishikuar çdo vit nga Komiteti i Rrezikut për Fondet e Pensionit, me këshillimin e Drejtorisë së Fondeve të Pensionit dhe Investimit, duke ndjekur një proces, që dokumentohet më poshtë.

Kontributet për vlerësimin

2.12 Kontributet për vlerësimin e rrezikut në treg përfaqësojnë një nëngrup të rëndësishëm informacioni që i duhet ekipit të mbikëqyrjes së pensioneve dhe që përfshin:

- **Inspektimin në vend dhe analizën dokumentare:** të dhëna të grumbulluara nga këto burime lidhur me mbizotërimin dhe seriozitetin e rreziqeve të vlerësuara, së bashku me cilësinë e masave për zbutjen e rrezikut, mbi bazën e inspektimit në vend, përdoren për të përfutur vlerësimin e rrezikut të mbetur të subjektit individual –shih Rubrikën 3. Këto duhet të shoqërojnë vlerësimet e rrezikut të mbetur në treg, duke i vendosur në matricën e rrezikut të mbetur.
- **Kontrollin e mjedisit:** informacione të rëndësishme për rreziqet nga të dhënat e vlefshme publikisht dhe mbikëqyrës të tjerë mund të shfrytëzohen për të ndihmuar me

identifikimin e rreziqeve të tjera në treg, ndryshimin e përkufizimeve ekzistuese të rrezikut ose për të ushqyer me informacion vlerësimin e rrezikut të pranishëm. Ekipi i mbikëqyrjes së pensioneve duhet t'i marrë disa prej këtyre informacioneve si pjesë e rutinës. Burimet përfshijnë raportet e INSTAT-it, median, Bankën e Shqipërisë dhe mbikëqyrës të tjerë brenda AMF-së. Një anëtar i ekipit të mbikëqyrjes së pensioneve duhet t'i caktohet roli për të siguruar që të gjitha informacionet përkatëse të kësaj natyre të vihen në dispozicion për vlerësimin e rrezikut (dhe inspektimin në vend).

- **Kërkimin:** mund të jetë kontribut i rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut (si dhe për hartimin e alternativave të zbutjes së rrezikut). Kur ekipi i mbikëqyrjes së pensioneve identifikon një hendek të madh në bazën e tij të informacionit, Komiteti i Rrezikut të Fondeve të Pensionit mund të nxisë për kërkime (zakonisht, bazuar në sondazhe) drejtorinë e kërkimit. Kërkimi bazuar në sondazh ka më shumë gjasa të lidhet me besimin e përfituesve ose vetëdijen për tregun, ndërgjegjësimin publik ose qëndrimet e punëmarrësve ndaj pensioneve. Kërkime të tjera mund të përfshijnë shqyrtime të përvojës ndërkombëtare ose analizave të tregjeve financiare.
- **Rishikimin e efektivitetit mbikëqyrës:** Me zbatimin e strategjive mbikëqyrëse, efektiviteti i tyre duhet monitoruar dhe rishikuar, duke përdorur kriteret e suksesit të përcaktuara në strategjinë përkatëse të rrezikut. Këto matje ofrojnë një hapësirë për reagim, duke identifikuar se ku mund të ndryshojë strategjia e mbikëqyrjes.

2.13 Mbi bazën e këtij informacioni, ekipi i mbikëqyrjes së pensioneve duhet të rishikojë, le të themi çdo muaj tetor, tablonë e rrezikut në sistem si pjesë e veprimtarisë së saj dhe ky rishikim, nga ana tjetër, duhet përsëritur nga Komiteti i Rrezikut të Fondeve të Pensionit. Rishikimi ka këto faza:

- i. Rishikimi i përkufizimeve të kategorisë së rrezikut, për t'u siguruar që ende pasqyrojnë objektivat e AMF-së. Mund të ndodhë që të shtohet një kategori e re apo që një kategori të ndahet, pasi rreziqet brenda saj nuk janë homogjene mjaftueshëm. Për të gjitha kategoritë e rrezikut, mund të duhet saktësi e mëtejshme për të përkufizuar ngjarjen që shkakton rrezikun ose pasojat negative bazuar në përvojën e shfaqur të asaj çka mund të shkojë keq;
- ii. Vlerësimi i ndikimit të pranishëm të secilës kategori rreziku – seksioni tjetër;
- iii. Vlerësimi i probabilitetit të pranishëm të secilës kategori rreziku – seksioni tjetër;
- iv. Përcaktimi nëse rreziku i pranishëm i vlerësuar ndryshon me kohën apo midis subjekteve – seksioni tjetër;
- v. Konfigurimi i rrezikut të pranishëm në matricën e tablosë së rrezikut;
- vi. Dokumentimi i vlerësimeve të rrezikut të pranishëm, së bashku me vlerësimet e rrezikut të mbetur nga vlerësimi i inspektimit të mëparshëm, në strategjitë e zbutjes së rrezikut për secilën kategori rreziku (Hapi 3);
- vii. Rishikimi i alternativave për zbutjen e rrezikut në strategji në nivelin e pranueshëm dhe renditja e tyre sipas vlerës së shtuar dhe efektivitetit të kostos (Hapi 3), duke pasur parasysh se vlerësimi i nivelit të rrezikut të mbetur përmes inspektimit apo mjeteve të tjera mund të përbëjë vetë një mënyrë për uljen e rrezikut të vlerësuar në nivel të pranueshëm; dhe
- viii. Zgjedhja e alternativave që mund të përballohen dhe justifikohen gjatë tre vjetëve dhe dokumentimi i këtyre zgjedhjeve e ndikimeve të tyre në planet e veprimit, në përfundim të secilës strategji dhe në planin trevjeçar për mbikëqyrjen e pensioneve (Hapi 4).

- 2.14 Procesi mund të jetë i përsëritur. Për shembull, në qoftë se nuk mund të justifikohet asnjë opsion i zbutjes për një kategori të veçantë të rrezikut, e cila është vlerësuar se është mbi nivelin e tolerueshëm të rrezikut, a është përkufizuar ose vlerësuar gabim rreziku, a janë burimet të pamjaftueshme apo nuk është gjetur një alternativë me kosto më efektive? Vetë strategjitë e zbutjes së rrezikut ofrojnë shembuj se si vlerësohet rreziku i pranishëm.

Ndikimi i pranishëm

- 2.15 Ashtu siç përshkruhet në Kapitullin 1, vlerësimi i rrezikut të pranishëm ndihmon për të informuar sesa përpjekje i duhet AMF-së për të zbutur rreziqet e identifikuar. Po kështu ai siguron një pikë fillestare për vlerësimin e rrezikut të mbetur, bazuar në:

$\text{Rrezik i mbetur} = \text{rrezik i pranishëm} - \text{zbutjen e rrezikut}$

- 2.16 Në praktikë, zbutjet e rrezikut zakonisht nuk kanë efekt në ndikimin e rrezikut, vetëm në probabilitet, megjithëse ndikimi mund të zvogëlohet nga ndryshimet në legjislacion ose në strukturën e tregut. Për këtë arsye, pjesa më e madhe e mbetur e këtij Manuali e adreson vlerësimin e probabilitetit të mbetur. Dy lloje të ndryshme të ndikimit janë më të përshtatshme në shkallë të ndryshme:

- **Dhënia e përfitimeve (siguria dhe efikasiteti):** Shkalla e mbulimit dhe niveli i kontributeve nga pjesëmarrësit përcaktojnë sesa efektiv është sistemi në dhënien e përfitimeve të pensionit, që plotësojnë ato që financohen nga shpenzimet qeveritare. Mënyra se si administrohen fondet e pensione mund të ndikojë negativisht përfitimet që grumbullohen për përfituesit, duke e bërë sistemin më pak efikas apo të sigurt sesa duhet të jetë. Për shembull, moszgjerimi i pjesëmarrjes do të ulte të ardhurat e pensionit, humbja e aseteve, investimet nën optimalen ose tarifa të tepruara mund të ulin fondet në dispozicion në kohën e pensionit. Vonesat në pagesa apo vendimet nën optimale në pension mund të ndikojnë kur ose sa para janë në dispozicion për pensionin.
- **Imazhi (besimi politik/publik):** Besimi në sistem është jetik për të ruajtur pjesëmarrjen në sistemin vullnetar, kështu besimi është shqetësim kryesor për AMF-në. Ngjarjet që shkaktojnë humbjen e besimit nga publiku, si vështirësitë financiare ose mosofrimi i një shërbimi të mirë apo administrimi jo efikas i fondeve mund të sillte si rezultat zhgënjimin publik ose politik, që mund të çënojë, nga ana tjetër, besueshmërinë e sistemit të pensioneve. Për shembull, pjesëmarrja e ulët ose vazhdimësia e saj, fitimet e ulëta, tarifat e larta humbja e aseteve ose kontributeve mund të minojnë, që të gjitha, emrin e sistemit të pensioneve dhe të kërcënojnë qëndrueshmërinë e tij afatgjatë.

- 2.17 Ka edhe ndikime të tjera që mund të jenë të rëndësishme në disa rrethana:

- **Sisteme:** kur veprimet e subjektit të mbikëqyrur kanë ndikim negativ në stabilitetin apo emrin e tregjeve të tjera financiare apo ekonomisë në përgjithësi. Për shembull, ndryshimet në portfolet e investimeve pa analizë të pasojave në treg mund të krijojnë çrregullime në tregjet financiare shqiptare ose të valutës së huaj, ndërkohë që përqendrimi më shumë seç duhet te bonot qeveritare mundet, po ashtu, të shtrembërojë tregun dhe një problem me një depozitar mund të ndikojë në sektorin bankar.
- **Përvoja e pjesëmarrësit:** veprime operative të pa përshtatshme (ose shitjet me mashttrim) ndikojnë në shërbimin e ofruar nga shoqëritë administruese për përfituesit e tyre, në një

mënyrë të tillë që mund të ulë besimin ose angazhimin e përfituesve ose punëmarrësve në sistem. Kjo nuk mbulon performancën e investimeve të fondit (që trajtohet te 'dhënia e përfitimeve'), por mund të mbulojë punën e dobët operative, shërbimin e klientit apo shitjen me mashtrim.

- 2.18 Vlerësimi i ndikimit të pranishëm ka një rol domethënës në përparësinë që i jepet një kategorie rreziku dhe forcës së reagimit kur nuk arrihet zbutja e rrezikut në praktikë. Për rrjedhojë, është e rëndësishme që të tilla vendime të merren kolektivisht dhe të dokumentohen në mënyrë transparente si pjesë e një procesi rigoroz. Kjo duhet konsideruar formalisht edhe në Komitetin të Rrezikut të Fondeve të Pensionit, edhe pse Ekipi i Mbikëqyrjes së Pensioneve duhet të paraqesë propozime për atë çka mund të vendosë Komiteti.

Probabiliteti i pranishëm

- 2.19 Probabiliteti i pranishëm vlerësohet duke marrë në konsideratë probabilitetin se rreziku mund të materializohet pa marrë siguri konkrete mbikëqyrëse nga sa mirë e menaxhojnë subjektet rrezikun. Edhe kjo është në mënyrë të pashmangshme subjektive, duke qenë se konsideron një fakt të kundërt me atë që ndodh – në të vërtetë, AMF ndërmerr mbikëqyrje dhe merr një lloj sigurie. Pika fillestare mund të jetë të supozosh se probabiliteti është i lartë dhe, më pas, të marrësh në konsideratë faktorët që mund të ulin këtë vlerësim dhe nëse është në interesin e subjektit të zbusë rrezikun, pavarësisht nëse ka kontroll të jashtëm. Kjo do të përfshinte:

- **Legjislacioni përkatës:** nëse ligji parashikon veprime ose struktura që e zbusin rrezikun e pranishëm dhe besohet se legjislacioni ka zbatim të gjerë, atëherë probabiliteti i pranishëm mund të marrë vlerësim më të ulët sesa të lartë. Për shembull, ligji kërkon ndarjen midis administrimit të fondit dhe kujdestarisë dhe kjo ndarje ekziston, faktikisht. Një gjë e tillë ul rrezikun e pranishëm që asetet e kontribuesve të vidhen apo sekuestrohen dhe mundëson një vlerësim me probabilitet më të ulët.
- **Qeverisja dhe menaxhimi i rrezikut:** në veçanti, duke qenë se legjislacioni parashikon një strukturë të fortë bazë të qeverisjes dhe menaxhimit të rrezikut, është e arsyeshme të supozojmë se brenda subjekteve do të ketë një nivel bazë organizimi, edhe pse kjo nuk mund të shërbejë për t'u mbështetur për të parandaluar të gjitha problemet.
- **Lehtësimi i përputhshmërisë:** në rast se ekziston tashmë një marrëveshje e dokumentuar në botën tregtare lidhur me si duhet të zbutet rreziku dhe procedurat e përfshira janë të njohura dhe të gatshme për të zbatuar, atëherë mund të jetë e arsyeshme që të japim një vlerësim me probabilitet të ulët. Për shembull, ka procedura të ngritura për të kontrolluar rrezikun e defekteve katastrofike të TI-së, në mënyrë që këto të jenë mjaft të rralla në praktikë. Në rast se procedurat janë të konsoliduara, ka më shumë gjasë të funksionojnë efektivisht, sesa kur janë të reja ose shumë të rishta.
- **Stimujt financiarë** që ekzistojnë tashmë për të vepruar ose jo në përputhje: duke qenë se shoqëritë administruese nuk mund t'iu ngarkojnë kontribuesve kosto shtesë, ata kanë një stimul të fortë për t'i menaxhuar veprimet e tyre në mënyrë të tillë, që të shmangin dështime në kontroll që mund të jenë me kosto. Nga ana tjetër, ka një stimul të dukshëm për shoqëritë që t'i mbajnë tarifatat sa më lart të jetë e mundur, kështu që nuk ka asnjë stimul për të zbutur rrezikun që tarifatat janë shumë të larta. Ato kanë pak stimul material për të përmirësuar mënyrën se si investojnë, sidomos kur përmirësimi i menaxhimit sjell kosto.

- **Struktura e shoqërisë:** kur shoqëritë janë pjesë e një grupi të madh, është e arsyeshme të mendohet se grupi do të krijojë procese efektive kontrolli për të mbrojtur aksionet e tij financiare dhe emrin e vet dhe, po kështu, financat do të jenë më të forta, duke sjellë ulje të rrezikut të dështimit të shoqërisë. Pjekuria e vetë shoqërisë mund të jetë me rëndësi, gjithashtu. Shoqëritë që janë krijuar për një kohë të gjatë, me menaxhim të qëndrueshëm, duhet të paraqesin rrezik më të ulët, të paktën kur kanë stimul financiar për ta administruar atë.
- **Synimi për ekspozim domethënës ndaj rrezikut (madhësia e tregut):** kur rreziqet përkufizohen në kuptimin e materializimit të ngjarjeve të konsiderueshme negative, probabiliteti i materializimit të këtij rreziku mund të ulët, thjesht për shkak se madhësia e tregut është relativisht e vogël. Për shembull, nëse asetet janë mjaft të vogla, synimi për të vjedhur një shumë të madhe parash reduktohet në mënyrë të qenësishme dhe, për rrjedhojë, tërheqja e krimit financiar është më e pakët ose, në rast se strategjia e investimit me kosto efektive optimale është e kufizuar nga niveli i fondit, është më e vështirë të zbatosh një strategji investimi që është dukshëm nën optimalen. Në të tilla raste, duhet pritur që probabiliteti i pranishëm të rritet, duke u rritur tregu dhe, kështu, mund të jetë e nevojshme të konstatohet se, edhe pse probabiliteti i pranishëm nuk është i lartë, kjo mund të ndryshojë.

2.20 Shpeshtësia me të cilën rreziku në fjalë është materializuar në të kaluarën mund të shërbejë si informacion për vlerësimin e probabilitetit të pranishëm. Nëse rreziku nuk është materializuar asnjëherë, nuk mund të vlerësohet me probabilitet të lartë. Nëse njihet si endemik, vlerësimi duhet të jetë, pa dyshim, i lartë. Duke qenë se rreziku i pranishëm mund të pasqyrojë performancën në të kaluarën dhe bën supozime mbi nivelin bazë të qeverisjes, menaxhimit e rrezikut dhe përmbushjen ligjore dhe këto supozime mund të ofrojnë një orientim shumë optimist për të ardhmen, **duhet pranuar se, në rrethana rastësore, është e mundur që probabiliteti i mbetur për materializimin e rrezikut (dhe që sjell një ndikim të pranishëm) të jetë më i lartë sesa vlerësimi i probabilitetit të pranishëm, megjithëse në të tilla rrethana duhet të merret në konsideratë ndryshimi i vlerësimit të probabilitetit të pranishëm.**

Vlerësimi i rrezikut të pranishëm – faktorë të tjerë për t'u marrë në konsideratë

2.21 Nga konsideratat e mësipërme, është mjaft e mundur që, të paktën, për disa kategori rreziku, rreziku i pranishëm të ndryshojë midis subjekteve. Arsyeja më e dukshme do të ishte shkalla e aseteve të menaxhuara nga subjektet. Edhe emri i shoqërisë mëmë mund të ketë efekt në disa rreziqe. Menaxhimi jo i mirë i një subjekti mund të sjellë si rezultat që probabiliteti i pranishëm për kategoritë e përfshira të rrezikut të jetë më i lartë sesa për subjektet e tjera. Aktualisht, asnjë prej këtyre dallimeve nuk konsiderohet si i mjaftueshëm për të justifikuar një vlerësim të ndryshëm të rrezikut të pranishëm.

2.22 Vlerësimet e rrezikut të pranishëm për secilën kategori rreziku (dhe, nëse është rasti, subjekt) duhen dokumentuar në formularin e strategjisë së zbatjes së rrezikut për atë rrezik, së bashku me arsyet përkatëse. Janë dhënë formularët për përmbledhjen e rrezikut dhe për matjen e performancës (Materiali 2.15-2.16) për të ndihmuar komunikimin. Ato duhet të rishikohen nga drejtuesit e lartë si pjesë e procesit të shqyrtimit të strategjisë për mbikëqyrjen e pensioneve dhe planifikimit. Më pas, mund të hartohet një matricë e rrezikut të pranishëm. Matrica aktuale e rrezikut të pranishëm gjendet në Figurën 10, më poshtë—**kjo duhet zëvendësuar, sa herë që vlerësimeve në matricë iu bëhen ndryshime.**

Figura 10: Matrica e rrezikut të pranishëm të AMF-së për pensionet (2016)

Impakti ↑				
I lartë	Rreziku i kreditit (Strategjia e diversifikimit të investimeve)	Siguria e aseteve të depozitarët Siguria e aseteve të SHAFP		Pjesëmarrja/ besueshmëria në sistem
I mesëm- I lartë	Ti-ja dhe vazhdimësia e biznesit	Ndalja e kontributeve Tarifat e SHAFP-ve Qëndrueshmëria e SHAFP-ve Shitje me mashtrim	Mungesa e kontributeve Strategjia e investimeve Nuk ka depozitar Ndarja nga depozitari	
I mesëm- I ulët	Pastrimi i parave	Kontrolli i rrezikut të investimeve Depository Q of S	Mbajtja/ruajtja e të dhënave/ të dhënave/ TI-ja Konfidencialiteti i të dhënave Pagesat/likuiditeti	Kontribute të vonuara Komisione bankare mbi transfertat
I ulët				Produktet e pagesave përfshirë edhe kuptimin mbi pagesat
	I ulët	I mesëm-I ulët	I mesëm-I lartë	I lartë Probabiliteti →

2.23 Disa vlerësime të kategorive të rrezikut ndryshojnë me kalimin e kohës. Për shembull, ndërkohë që pagesat nga sistemi bëhen më të zakonshme, ndikimi i pranishëm i rrezikut shoqërues do të rritet. Nga ana tjetër, nëse në asnjë prej subjekteve nuk gjenden probleme lidhur me një kategori të caktuar rreziku për disa vjet me rradhë, mund të jetë e arsyeshme që probabiliteti i pranishëm të ulët. Kur ndikimi ose probabiliteti pritet të ndryshojë në të ardhmen, një shigjetë orientuese duhet vendosur krahas rrezikut.

2.24 Po kështu, matrica mund të përdoret për të treguar kur ndryshon rreziku i pranishëm midis subjekteve (siç përmendet në paragrafin 2.21 më lart) ose kur parashikohen nivele të ndryshme ndikimi, ku niveli me ndikim më të ulët ka probabilitet më të lartë. Në këtë rast, rreziqet e ndara brenda kategorisë së rrezikut duhen konfiguruar, ashtu siç ndodh në Figurën 10⁷. Matrica është vetëm një instrument dhe duhet përdorur në mënyrë elastike për të kapur çdo gjë që konsiderohet e rëndësishme për të kuptuar tablonë e rrezikut.

Procesi i vlerësimit të rrezikut të pranishëm

⁷ Këtu tregohen katër vlerësime të ndryshme të rrezikut të depozitarët, katër prej të cilave lidhen me kontributet (duke përfshirë pastrimin e parave) dhe dy lidhen me strategjinë e investimit.

2.25 Procesi që mund të përdoret nga Komiteti i Koordinimit të Rrezikut të Pensioneve shpjegohet në paragrafët në vijim. Pika e fillimit shërben për të kujtuar të gjithë aktualitetin e rreziqeve tashmë të identifikuara, mundësisht duke përdorur një diagram si në Figurën 9 më sipër. Më tej, për çdo rrezik që rishikohet, merrni në konsideratë pasojën negative të vendosur në përkufizimin e rrezikut dhe kategorizojeni atë brenda njërit nga katër nivelet e mëposhtme të ndikimit, si vijon:

- **I lartë:** dështim madhor në arritjen e objektivave të sistemit (dhe AMF-së), që ka sjellë humbjen e besimit publik ose politik në sistem ose që ka lënë shumë persona të kualifikuar pa marrë të ardhurat e pensionit nga sistemi ose ka shkaktuar për shumë pjesëmarrës humbjen e një pjese të konsiderueshme të pensionit të tyre të grumbulluar, të themi, të paktën 20%.
- **I mesëm-i lartë:** shumë kontribues marrin më pak të ardhura nga pensioni, nëse do t'i kishin mbajtur paratë në depozita bankare, ose njerëzit nuk marrin pjesë apo qëndrojnë në sistem për shkak të cilësisë së ulët të shërbimit, rezultateve të arritura apo nga dëmtimi i emrit të sistemit si dhe kur ofruesit e shërbimit përfitojnë në mënyrë të padrejtë prej sistemit.
- **I mesëm-i ulët:** shumë kontribues marrin në fraksion më pak të ardhura nga pensioni, sesa do të merrnin nëse sistemi do të realizonte objektivat e veta ose disa kontribues pësojnë humbje më domethënëse të të ardhurave, apo disa dëme kalimtare në perceptimin e sistemit në përgjithësi ose nga kontribuesit, për shembull, për shkak të problemeve me shërbimet e ofruara, teknikat e shitjes, spekulimet e perceptuara ose krizës në shoqërinë administruese.
- **I ulët:** asnjë ndikim i menjëhershëm mbi rezultatet ose emrin e sistemit, edhe pse disa kontribues vihen në situata të paleverdishme ose një shoqërie administruese i duhet të ndërmarrë veprime korrigjuese për të shmangur ndikime më të mëdha apo për të qenë në përputhje me ligjin.

2.26 Kujtoni se pasojat kryesore të shqetësimit për kontribuesit janë financiare dhe të imazhit. Humbjet financiare të pësura nga subjektet e mbikëqyrura sjellin si rezultat një ndikim mbi atë “të ulët” vetëm deri në shkallën në të cilën ato ndikojnë në fondet e kontribuesve ose imazhin e sistemit. Fokusimi për ndikimin (dhe probabilitetin gjithashtu) është i përqendruar tek situata aktuale. Në qoftë se pritët që ai të bëhet më i lartë (ose më i ulët) për shkak të ndryshimeve në demografi ose në përmasat e tregut, kjo duhet të regjistrohet.

2.27 Më pas, për secilin rrezik të identifikuar, merret në konsideratë probabiliteti i ngjarjes shkakësore, së cilës i referohet në përcaktimin e rrezikut dhe kategorizohet në një prej katër niveleve të probabilitetit, cili mund të vlerësohet nga pikëpamja cilësore si vijon:

- **I lartë:** rreziku është materializuar tanimë dhe ose duket sikur do të qëndrojë ashtu, ose ka gjasë të përsëritet së shpejti ose duket se do të ndodhë shpejt, nëse AMF-ja nuk ndërmerr veprime parandaluese. Pa masë zbutëse, kjo është gati e pashmangshme.
- **I mesëm-i lartë:** rreziku është materializuar, edhe pse jo për shumë gjatë ose ka gjasë të materializohet në një pikë të caktuar gjatë viteve në vijim. Pa masa zbutëse, ka gjasë që dikur të ndodhë.

- **I mesëm-i ulët:** ekzistojnë mundësi të arsyeshme që rreziku të materializohet, edhe pse nuk është materializuar për një kohë të caktuar ose asnjëherë dhe nuk ka shumë gjasë të ndodhë. Pa masa zbutëse, ka ende gjasë të mos ndodhë, por rreziku ekziston.
- **I ulët:** rreziku nuk është materializuar dhe do të materializohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Pa masa zbutëse nuk mund të përjashtohet plotësisht. Nëse do të ishte kështu, nuk do të konsiderohej rrezik.

2.28 Këto vlerësime janë në mënyrë të pashmangshme me burimet e provave duke qenë dukuri të kaluara në sistem dhe gjykime në lidhje me atë që mund të bëhet gabim. Kjo është e pranueshme për këtë qëllim, sepse të gjitha, me përjashtim të kategorive më të ulëta të rrezikut do të inspektohen dhe/ose analizohen herë pas here, gjë që do të sigurojë një evidencë më të fuqishme për faktin nëse probabiliteti është vendosur në mënyrën e duhur. Në fakt, kjo është një arsye se përse të gjitha kategorive të rrezikut duhet t'u jepet njëfarë vëmendje në vitet e para të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik.

2.29 Arsyet për vlerësimin e rrezikut të pranishëm duhet të dokumentohen të përmbledhura në Tabelën 2.2 – përmbledhje për rrezikun e pranishëm të fondeve të pensionit. Atëhere rreziqet duhet të hidhen në diagramën e matricës së rrezikut. Mund të ketë edhe ndikime të tjera më të vogla që janë të ndryshme mjaftueshëm dhe probabilitete më të larta që meritojnë konsideratë të veçantë. Kështu, nëse ka manifestim të rrezikut që ka ndikim ose probabilitet më të lartë sesa manifestimi i përgjithshëm i rrezikut, merrni në konsideratë nëse rreziku duhet të ndahet në dy, çka do të kërkonte ekzistencën e një dallimi domethënës midis dy llojeve të rrezikut. Ky mund të jetë rasti sidomos nëse manifestimi i ndikimit më të lartë është probabilitet më i ulët sesa pjesa tjetër ose e kundërta.

2.30 Më pas, Komiteti i Koordinimit të Rrezikut të Pensioneve duhet të marrë në shqyrtim kategorizimin e propozuar për çdo kategori të rrezikut dhe paraqitjen e përgjithshme të siguruar nga matrica e rrezikut, duke sfiduar kategorizimin e tyre aty ku nuk u jepet vëmendje e veçantë pozicioneve përkatëse midis rreziqeve që duken në mënyrë intuitive të diskutueshme. Arsyet e këtyre ndryshimeve duhen përcaktuar dhe të shqyrtohet nëse këto ndryshime janë paraqitur më shumë (ose më pak) seç duhet. Ata mund ta përqendrojnë vëmendjen te pyetjet në vijim:

- Nëse dy rreziqe me përcaktime mjaft të ngjashme janë kategorizuar në mënyrë identike, a do të ishte më mirë që ato të kombinoheshin?
- A duket i përshtatshëm kodimi me ngjyra, duke pasur parasysh përkufizimet në paragrafin 2.34 dhe Figurën 11? Rreziqet me të kuqe kërkojnë vëmendje të konsiderueshme dhe rreziqet me portokalli duhen kontrolluar çdo vit, përveçse kur në dispozicion ka analiza të forta paralajmëruese të dokumenteve, është e rëndësishme për caktimin e burimeve të kufizuara që, në këto segmente të ketë vetëm pak rreziqe. Nëse ekziston ndjesia se ka shumë, duhet të shihet nëse vlerësimi ka qenë më pesimist seç duhet ose nëse ngjarjet që shkaktojnë rrezikun duhen ndarë në dy, me qëllim që një pjesë e rreziqeve të ketë ngjyrim më të lehtë. Rreziqet e pranishëm me të gjelbër mund të marrin vëmendje shumë rrallë dhe duhet të ketë kontrolle që të ndihet se është e sigurt. Edhe njëherë, ndarja e rrezikut mund të ndihmojë për trajtimin e çdo shqetësimi.
- Së fundi, në rast se rreziqet janë të grumbulluara dhe shumë prej kutive lihen bosh, është e mundur që të bëhen dallime më të qarta midis rreziqeve që mund të rrisin shpërndarjen e rrezikut përgjatë matricës.

- 2.31 Matrica e rrezikut të pranishëm dhe formulari i Përmbledhjes së Rrezikut të Pranishëm të Pensioneve duhet të përditësohen duke marrë parasysh vendimet e Komitetit.

Marrja në konsideratë e vlerësimit të rrezikut të mbetur

- 2.32 Vlerësimi dhe shqyrtimi i rrezikut të mbetur për çdo subjekt është trajtuar në Kapitullin 3 të këtij manuali. Këto vlerësime duhen mbledhur në strategji të zbutjes së rrezikut, për të dhënë një vështrim të përgjithshëm mbi ndikimin dhe probabilitetin e mbetur. Vlerësimet e shoqërisë administruese duhen konfiguruar për secilin rrezik në matricën e rrezikut të mbetur të sistemit. Kur probabiliteti dhe ndikimi i vlerësuar ndryshon midis shoqërive administruese, vlerësimet e shoqërisë duhen shfaqur veçmas ose vlerësimi më i keq duhet përfshirë në matricën e rrezikut të mbetur. Ky vlerësim mund të ndihmojë për të informuar marrjen në konsideratë të rrezikut të pranishëm nga grupi i mbikëqyrjes dhe komiteti i rrezikut.

- 2.33 Strategjitë fillestare të zbutjes të rrezikut, të përgatitura përpara gjithë inspektimeve të bazuara në rrezik, në disa raste kanë përdorur një vlerësim subjektiv të pozicionit aktual të rrezikut të mbetur. Këto vlerësime përditësohen sapo bëhen të disponueshme prova më të mira.

Efektet e vlerësimit të rrezikut në strategjitë e zbutjes së rrezikut

- 2.34 Vlerësimi i rrezikut të pranishëm dhe të mbetur është një e dhënë për formulimin e strategjive të zbutjes së rrezikut dhe planit të mbikëqyrjes. Kodimi me ngjyra i qelizave në matricë, ndikon në faktin se sa përpjekje duhet të bëhet për përputhshmërinë e monitorimit me pritshmërinë e praktikave të mira (rreziku i pranishëm) dhe se sa më shumë (nëse ka) nevojitet të bëhet për të siguruar ndryshimin (rreziku i mbetur). Si rregull i nxjerrë nga përvoja, kodimi me ngjyra ka ndikimet e mëposhtme, të përmbledhura në Figurën 11 më poshtë:

- **E kuqe:** në qoftë se rreziku i mbetur është i kuq, ai duhet të ketë një përparësi kryesore për zbutje, pasi aty ka një ekspozim të papranueshëm ndaj objektivave të AMF-së. Hartimi i një plani për të ndërmarrë masa zbutëse ndaj rrezikut, mund të jetë i përshtatshëm dhe gjithashtu kur është e përshtatshme duhet të ndërmerren sanksione ose ndërhyrje në subjektet përkatëse (paragrafet 5.69 e në vazhdim japin më shumë detaje). Aty ku rreziku i pranishëm është i kuq por rreziku i mbetur është vlerësuar të jetë më i ulët, verifikohet që ky rast është me përparësi të lartë, me inspektime vjetore derisa të vendoset mbështetja thelbësore në qeverisje dhe menaxhimi i rrezikut në subjektet përkatëse mbikëqyrëse dhe ka tregues paralajmërues të hershëm efektiv të jashtëm. Këto tregues duhet të identifikohen në strategjinë përkatëse të zbutjes së rrezikut. Ato që janë aktualisht të identifikuar duke qenë se ka mundësi të jenë të nevojshëm, janë përfshirë në Kapitullin 4 të këtij Manuali. Në qoftë se janë identifikuar dhe projektuar të tjerë, ata duhet të shtohen në Kapitullin 4.
- **Portokalli:** në rast se rreziku i mbetur është portokalli, ka një ekspozim të papranueshëm ndaj rrezikut për një periudhë më afatgjatë. Duhet ndërmarrë veprime për uljen e këtij rreziku për një periudhë afatmesme, në rastin më të mirë, sa më shpejt të jetë e mundur brenda kufizimit të burimeve. Kur rreziku i pranishëm është portokalli,

por rreziku i mbetur vlerësohet si më i ulët, i duhet kushtuar vëmendje verifikimit të vlerësimit të rrezikut, së paku çdo vit, qoftë përmes analizave dokumentare ose përmes inspektimit në vend. Ky i fundit duhet zhvilluar të paktën çdo tre vjet (preferohet dy) edhe kur ka analiza të vazhdueshme dokumentare që ofrojnë nivel të mirë sigurie. Në nivelin e subjektit, mund të jenë të përshtatshme sanksionet dhe ndërhyrjet (paragrafët 5.69 e në vazhdim japin më shumë detaje).

- **E verdhë:** në qoftë se rreziku i mbetur është i verdhë, ekspozimi ndaj rrezikut është mjaft i pranueshëm, megjithëse mund të jetë e rëndësishme që të zbatohet zbutje e mëtejshme, nëse kjo mund të bëhet me një kosto të pranueshme shtesë. Duhet të ketë monitorim për t'u siguruar që vlerësimet nuk përkeqësohen, sipas vlerësimit të rrezikut të pranishëm. Nëse rreziku i pranishëm është me të verdhë, monitorimi njëherë në tre vjet i përputhshmërisë duhet të jetë i mjaftueshëm.
- **E gjelbër e çelur:** nëse rreziku i mbetur është me të gjelbër të çelur, ai do të ishte i pranueshëm, edhe pse nuk do e pengonte AMF-në t'iu sugjeronte subjekteve përmirësime të mundshme. Shpeshtësia e monitorimit duhet të jetë, së pari, pasojë e rrezikut të pranishëm, por nëse burimet janë të kufizuara, inspektimi në vend mund të jetë më pak nga sa do të tregonte rreziku i pranishëm. Nëse rreziku i pranishëm është e gjelbër e hapur, është e mundur që ky rrezik të mos kontrollohet gjithnjë çdo tre vjet.
- **E gjelbër e errët:** Nëse rreziku i mbetur është me ngjyrë të gjelbër të errët, propozimi i përmirësimeve nuk do të ishte me kosto efektive normalisht, ndërkohë që, nëse rreziku i pranishëm është me të gjelbër të errët, nuk ekziston nevoja për monitorim me shkak rrezikun (por mund të kërkohet për arsye të tjera).

Figura 11: Interpretimi i ngjyrave të rrezikut

	I pranishëm	I mbetur
E kuqe	Inspektohet çdo vit (kur është e nevojshme), përveçse kur mundësohen prova të forta të zbutjes së rreziqeve dhe tregues paralajmërimi (çdo dy vjet)	Krizë-nevojë për fushatë të madhe
Portokalli	I përvitshëm, derisa të jetë i disponueshëm sigurim i jashtëm dhe i fortë i qeverisjes çdo 2-3 vjet	Duhen më shumë masa zbutëse si përparësi
E verdhë	Të paktën çdo 3-4 vjet	Më shumë masa zbutëse janë të dëshirueshme aq kohë sa janë me kosto efektive
E gjelbër e çelët	Monitorohet periodikisht për të kontrolluar që nuk ka përkeqësim, si on-site ashtu edhe off-site	Edukim dhe orientim sipas rastit

E gjelbër e errët	Mos bëj asgjë (për aq sa është e mundur)	Mos bëj asgjë të re
----------------------	---	---------------------

2.35 Në përgjithësi, AMF mund t'i tolerojë rreziqet me të gjelbër, por duhet të ketë kujdes që nivelet më të larta të rrezikut të mbetur t'iu nënshtrohen përmirësimeve të masave zbutëse dhe duhet të kontrollohet herë pas here që rreziqet jeshile janë vërtet jeshile.

Përditësimi i profileve specifike të shoqërive

2.36 Disponueshmëria e gatshme e informacionit në çdo shoqëri administruese është thelbësore për vlerësimin dhe zbutjen e rrezikut. Cilësia e këtij informacioni në fund të fundit është përgjegjësi e çdo anëtarit të Komitetit të Koordinimit të Rrezikut të Pensioneve, secili prej tyre duhet të sigurojë që të gjitha njohuritë përkatëse që ata kanë në lidhje me çdo shoqëri administruese duhet t'i komunikohen ekipit të mbikëqyrjes së pensione. Profili i shoqërisë administruese duhet të mbahet për çdo shoqëri, duke përfshirë:

- Hartën e rrezikut të mbetur të shoqërisë administruese, e cila përdor matricën e rrezikut standard dhe shpërndan vlerësimin e rrezikut të mbetur në shoqërinë administruese të derivuar nga aktiviteti mbikëqyrës;
- Informacion të përgjithshëm për shoqërinë administruese, përfshi emrin, adresën dhe hollësi të shoqërisë mëmë;
- Informacion për numrin e personelit dhe hollësi për zyrtarët kryesorë, të përcaktuar si anëtarë të këshillit mbikëqyrës, Administratori, drejtues të tjerë, audituesi i brendshëm dhe menaxheri i rrezikut, së bashku me zyrtarë të shoqërisë mëmë që ka ndikim në qeverisjen e shoqërisë;
- Informacion për komitetet e këshillit mbikëqyrës, konkretisht, për komitetin e investimeve;
- Organigramë të shoqërisë;
- Informacion lidhur me ata që kryejnë funksionet e jashtëkontraktuara, përfshi depozitarin dhe funksionet e të cilëve kryhen nga shoqëria mëmë ose një prej degëve të saj të tjera;
- Të dhëna për punëmarrësit me fonde profesionale pensioni të administruara nga shoqëria;
- Informacion për numrin e kontribuesve, me numrin e kontribuesve për secilin fond profesional, aktualisht dhe për vitet e kaluara, si dhe krahasim me performancën për rritjen e kontribuesve të fondeve të shoqërive të tjera;

- Çdo informacion të vlefshëm për profilin moshor të kontribuesve, që, në rastin ideal, përfshin edhe masën e kontributit;
- Informacion për vlerën e përgjithshme të aseteve, përbërjen e secilit fond pensioni, sipas klasës së aseteve, së bashku me vlerën e njësive të kontributit aktualisht dhe gjatë viteve të kaluara dhe një krahasim me portofolin dhe performancën e fondeve të shoqërive të tjera;
- Përshkrime të proceseve dhe kontrolleve përkatëse, në formën e një diagrame treguese, për të gjitha funksionet që përcaktohen si kryesore për zbutjen e rreziqeve parësore, të nxjerra nga dokumentet e vetë shoqërisë ose të marra nga AMF;
- Çdo dokument strategjik i marrë nga shoqëria;
- Pasqyrat e fundit financiare, së bashku me raportet e auditorit të jashtëm e të brendshëm dhe përgjigjet e drejtuesve;
- Raporte për inspektimet e mëparshme në vend të shoqërisë;
- Raportet e AMF-së që i janë dërguar shoqërisë administruese;
- Përmbledhje të vlerësimit aktual dhe të kaluar të rrezikut të shoqërisë nga AMF;
- Përmbledhje të rezultateve të analizave të dokumenteve të shoqërisë, duke treguar fushat specifike të problemeve;
- Informacioni për aplikimet e licencimit në lidhje me shoqërinë ose fondin(et) nga Departamenti i Licencimit; dhe
- Ngjarje materiale që ndikojnë te siguruesi, që prej inspektimit më të fundit në vend.

2.37 Një anëtar i ekipit të mbikëqyrjes së pensioneve duhet t'i caktohet përgjegjësia për të përditësuar profilet dhe siguruar që informacioni përkatës nga profilet është i disponueshëm për t'u përdorur në vlerësimin e gjithë sistemit dhe në inspektimet në vend.

HAPI 3: Përgatitja/rishikimi i strategjisë së zbutjes së rrezikut të pensioneve

2.38 Strategjia për zbutjen e secilës nga kategoritë e rrezikut dokumentohet duke përdorur një paketë prej katër modelesh, si vijon:

- Dokumenti model për strategjitë e zbutjes së rreziqeve të ndarë sipas kategorive [Tabela 2.1] – një për çdo kategori të rrezikut – e cila kap strategjitë e disponueshme, të cilat mund të miratohen për të reduktuar rrezikun e mbetur të vlerësuar deri në një nivel të tolerueshëm, sipas përshkrimit në pjesën e mbetur të Hapit 3.
- Përmbledhje e rrezikut të pranishëm për fondet e pensionit [Tabela 2.2] – e cila, siç tregohet në paragrafin 2.30 më lart, regjistron përshkrimin e rrezikut dhe vlerësimin e rrezikut të pranishëm për çdo rrezik sipas vlerësimit nga Komiteti i Koordinimit të Rrezikut të Pensioneve.
- Skeduli i matjeve të performancës [Tabela 2.3] – e cila përmbledh se si rreziku i mbetur dhe rrjedhimisht shtrirja e zbutjes së rrezikut, mund të maten për çdo rrezik. Kjo bën një përmbledhje të procedurave në vend dhe analizave dokumentare, të cilat mund të ndihmojnë në dhënien e sigurimit që çdo rrezik është zbutur, aty ku është e

përshtatshme. Kolona e fundit në formular mund të përdoret për të përmbledhur rezultatet e matjeve për të treguar shtrirjen në të cilën rreziku i mbetur është zvogëluar më poshtë se niveli i rrezikut të pranishëm. Në të vërtetë ky formular është përdorur për të siguruar që janë zbatuar aq prova të mjaftueshme sa është e mundur në mënyrë të pranueshme për vlerësimin e rrezikut.

- Skeduli i strategjisë së mbikëqyrjes së fondeve të pensionit [Tabela 2.4] – e cila dokumenton për çdo kategori të rrezikut opsionet për veprimet mbikëqyrëse të synuara për të zvogëluar rrezikun e mbetur përtej nivelit të tij aktual. Skedula është e organizuar në përputhje me nivelin (ngjyrën) e rrezikut të pranishëm. Për rreziqet me të njëjtën ngjyrë, ajo fillon me ndikimin më të madh. Volumi i sigurimit të dhënë duhet të pasqyrojë shpeshtësinë e sigurimit të pritshëm në përputhje me ngjyrën e kodit të çdo rreziku të pranishëm, siç tregohet në Figurën 11 më sipër. Nevoja për opsionet e zbutjes të rrezikut varet nga thellësia e ngjyrës së vlerësimit të rrezikut të mbetur. Ajo mund të jetë e përshtatshme për disa rreziqe, për të treguar se cilat opsione janë thelbësore si minimum i nevojshëm për të ulur rrezikun e mbetur në ngjyrën e verdhë dhe cilat mund të ndërmerren me vonë në kohë nëse burimet janë të pamjaftueshme (sepse ato synojnë të ulin rrezikun në ngjyrën jeshile). Për shembull, kohëzgjatja e një inspektimi mund të lihet derisa lejon burimi. Për arsye se qeverisja e mirë mund të japë siguri në shumë rreziqe, kjo duhet të tregohet si një linjë e veçantë e përparësisë së lartë.

2.39 Në thelb, arsyetimi prapa gjithë strategjisë për mbikëqyrjen e pensioneve mund të dokumentohet në Tabelat 2.2-2.4. Megjithatë, Tabela 2.1 është një mjet i dobishëm për të sjellë së bashku analizat e ndryshme për çdo kategori të rrezikut dhe rrjedhimisht procesi për grumbullimin e informacionit në këtë formular jep udhëzime të mjaftueshme për përgatitjen e të gjithë paketës së planifikimit.

2.40 Etapa e parë do të transkriptojë informacionin në vlerësimin e rrezikut të pranishëm, nga rreziku në Përmbledhjen e Rrezikut të Pranishëm të Fondeve të Pensionit. Vlerësimi i rrezikut të mbetur, i përgatitur gjithashtu për të mbështetur shqyrtimin e vlerësimit të rrezikut të pranishëm (paragrafi 2.32 më sipër), duhet gjithashtu të regjistrohet në formularin e strategjisë. Ky vlerësim është informuar nëpërmjet matjeve të performancës [Tabela 2.3] e hartuar për të dhënë informacion mbi faktin nëse rreziku materializohet apo menaxhohet në mënyrë efektive. Këto masa mund të përfshijnë:

- Vlerësimin në vend të cilësisë së menaxhimit të rrezikut në subjektet e mbikëqyrura. Në praktikë, ky vlerësim mund të përmirësohet nga vlerësimi i qeverisjes, siç shpjegohet në Kapitullin 3.
- Analizat dokumentare nga grupi i mbikëqyrjes, të cilat japin tregues nëse rreziku është i mirëmenaxhuar, siç tregohet në Kapitullin 4. Këto mund të përfshijnë analizën e të dhënave sasiore ose mund të regjistrojnë numrin, nëse gjendet ndonjë gabim.
- Procedura të tjera jashtë vendit, nga grupet jashtë AMF-së, të cilat japin informacion për ndodhjen e materializimit të rreziqeve; për shembull kontrolle të materialeve të marketingut ose investigimin e ankesave të pjesëmarrësve.
- Të dhënat statistikore ose vrojtimit, të cilat janë të një rëndësie të veçantë për rreziqet e nivelit të lartë si mungesa e pjesëmarrjes.

- 2.41 Në këtë rast, linden nevojat për të patur të paktën një matës për t'i mundësuar AMF-së që të masë rrezikun e mbetur dhe nëse strategjitë e saj janë vërtetuar si efektive. Për rreziqet më të larta, të paktën, në këtë rast duhet të ketë disa të tillë. Megjithatë, mund të mos jetë e justifikueshme që të kërkohej siguri nga masa të shumëfishta kur rreziqet janë më të ulëta. Për shembull, në qoftë se në analizat dokumentare ka disa matës të mirë të rrezikut, inspektimi në vend mund të mos jetë i nevojshëm. Ose, inspektimi në vend mund të heqë nevojën për të kërkuar matës për analizat dokumentare. Masat e miratuara duhet të jenë të detajuara për strategjinë e zbutjes të rrezikut dhe të regjistrohen për të gjitha kategoritë e rrezikut në Tabelën 2.3.
- 2.42 Aty ku proceset dhe kontrollet në subjektet mbikëqyrëse duhet të provohet se janë të pamjaftueshme për të zbutur rrezikun në një nivel të tolerueshëm, strategjia e zbutjes së rrezikut është e nevojshme që të tregojë masat që do të ndërmerren për të nxitur ndryshimin. Kjo përfshin marrjen në konsideratë se çfarë dhe cilat sjellje duhet të ndryshojnë për rrezikun që të zbutet, në mënyrë që vlerësimi i rrezikut të mbetur të mund të ulet në një nivel (jeshil) të tolerueshëm. Mbikëqyrja e pensioneve e arrin objektivin e vet duke sjellë në të njëjtën linjë sjelljet e subjekteve të mbikëqyrura dhe, në disa raste të të tjerëve, me objektivin e AMF-së. Nëse e dinë se cilat janë veprimet e duhura për t'u ndërmarrë për përmbushjen e objektivit të AMF-së dhe i orientojnë veprimet e tyre që të jenë në një linjë me këto akte të duhura, rreziku ndaj objektivit të AMF-së duhet të ulet në minimum.
- 2.43 Ky proces mendimi është një hap i parë thelbësor për të vendosur se cilat janë veprimet që duhet dhe mund të ndërmarrë AMF për të verifikuar dhe siguruar që rreziku është zbutur në nivel të pranueshëm. Në thelb, është përshkrimi i problemit që duhet zgjidhur, në mënyrë që AMF të ketë siguri të mjaftueshme lidhur me zbutjen e rrezikut.
- 2.44 Faza tjetër që duhet të merret në konsideratë, dokumentohet në strategjinë e zbutjes së rrezikut, opsionet e disponueshme për të përfutur ose përmirësuar sigurimin që AMF-ja merr në lidhje me zbutjen e rrezikut. Një vendim mbi opsionet që do të përpunohen me nevojat që duhet të merren më pas, dokumentohet në dokumentin e strategjisë së zbutjes së rrezikut në Tabelën 2.4.

Strategjitë që përfshijnë analizën dhe inspektimin në vend, përfshi qeverisjen e shoqërisë

- 2.45 Disa prej alternativave për zbutjen e rreziqeve të identifikuar janë të posaçme për atë rrezik. Për të tjera ka të përbashkëta të konsiderueshme. Për shumë rreziqe, marrja e sigurisë dhe zbutja e rrezikut në mënyrë që të ulet rreziku i mbetur në një nivel të tolerueshëm përfshin mbështetjen në qeverisjen me menaxhim të fortë të shoqërisë, të mbështetur nga menaxhim efektiv i rrezikut dhe kontroll i brendshëm. Supozimi është se këshilli mbikëqyrës i shoqërisë administruese, si pjesë e detyrave të veta të mirëbesimit, duhet të bashkëndajë me AMF-në të njëjtin objektiv për minimizimin e rrezikut në sistem. Për rrjedhojë, detyra e AMF-së është të sigurohet që këshilli mbikëqyrës dhe drejtuesit e çdo shoqërie të kuptojnë rreziqet dhe si t'i minimizojnë ato. Për këtë qëllim:
- AMF përcakton parimet e mbikëqyrjes të praktikave më të mira për qeverisjen dhe çdo kategori përkatëse të rrezikut. Këto parashtrojnë ato çka AMF-ja i konsideron si kritere themelore në bazë të të cilave mund të vlerësohen shoqëritë administruese – në

kohën e duhur (këto duhet të përfshihen në rregullore). Këto parime janë pranuar nga shoqëritë administruese dhe çdo shtim ose ndryshim pasardhës duhet të miratohet njësoj.

- Pika më të hollësishme lidhur me mënyrën si mund të arrihet përputhshmëria me parimet përfshihen si sugjerime në formularët (FMPV-të) e shpjeguar në Kapitullin 3. Ky orientim do të ishte shumë i detajuar për t'u përfshirë në rregullore (përveçse kur ka një problem serioz mospërputhjeje me njërin prej pikave). Mungesa e këtyre tipareve mund të mos ketë rëndësi, në rast se shoqëria mund të tregojë se ka atë që duhet për të zbatuar me sukses parimet ("në përputhje ose të shpjegojë").
- Meqenëse AMF ka miratuar parimet e mbikëqyrjes me shoqëritë administruese, ekziston një pikë fillestare e miratuar për të vlerësuar qeverisjen dhe zbutjen e rrezikut. Kjo nënkupton se ka një pikënisje të gjithëpranuar për vlerësimin e qeverisjes dhe zbutjes së rrezikut. Çdo argument i mëtejshëm me drejtuesit e shoqërisë nuk do të përqendrohet, për pasojë, rreth përcaktimit të praktikës më të mirë, por vetëm nëse subjekti e ka respektuar ose jo atë.
- AMF teston nëse shoqëritë po i zbatojnë në praktikë parimet dhe praktikat më të mira, kryesisht përmes inspektimeve në vend, mbështetur aty ku është e mundur me analiza të të dhënave dokumentare (p.sh.,për portofolet e investimeve).
- Kur gjenden mangësi, AMF duhet të këshillojë shoqërinë se detyra e saj e mirëbesimit kërkon të zbatoj masa korrigjuese ose, kur është rasti, të urdhërojë marrjen e këtyre masave dhe të ekzekutojë përputhshmërinë, kur është e nevojshme.

2.46 E njëjta filozofi lidhet me depozitarët, me përjashtim që mbikëqyrja e përgjithshme e qeverisjes i lihet mbikëqyrësit bankar dhe duhet të konfirmohet në takime të rregullta koordinuese me personelin përkatës të atij mbikëqyrësi, të rregullohet nga Drejtori i Mbikëqyrjes. Disa aspekte të qeverisjes së depozitarëve lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me menaxhimin e rrezikut të depozitarëve dhe përfshihen brenda parimeve të mbikëqyrjes.

2.47 Promovimi dhe verifikimi i qeverisjes së shoqërive administruese është pjesë thelbësore e strategjisë kryesore dhe bën pjesë në pothuajse të gjitha strategjitë e zbutjes së rrezikut. Ajo përpiket të sigurojë një zbutje efektive të rrezikut përmes edukimit të menaxherëve dhe ofrimit të orientimit se si ata mund të përmirësohen. Përmirësimi i qeverisjes vetë mund të zbusë rreziqet, për shembull, duke u siguruar që janë hartuar politikat e duhura. Më tej, mirëqeverisja është e nevojshme për t'u siguruar se çdo kontroll a proces tek i cili mbështetet AMF-ja do të vazhdojë të ruhet në të ardhmen dhe, si rrjedhojë, iu jep një dimension largpamës vlerësimeve të saj.

2.48 Në të vërtetë, një proces që verifikon se qeverisja është e mjaftueshme duhet, po ashtu, të arrijë të verifikojë se rreziqet brenda shoqërisë administruese po zbuten në mënyrë efektive. Një përgjegjësi kryesore e qeverisjes së shoqërisë është që ajo të vërtetojë se politikat e saj janë në interesin më të mirë të kontribuesve dhe se sistemi i saj i kontrolleve funksionon efektivisht. Kështu, këshilli mbikëqyrës duhet të ketë procese vendimmarrjeje dhe monitorimi funksionale, çka nënkupton se shumë prej rreziqeve të objektivit të AMF-së janë zbutur efektivisht. Të verifikosh këtë, është e mjaftueshme për të realizuar një pjesë të mirë të objektivit të AMF-së.

2.49 Përjasja e verifikimit rrjedhimisht do të vendoset nëpërmjet intervistave dhe analizave mbështetëse dhe testimit që qeverisja bën zbutje të mjaftueshme, veçanërisht në lidhje

me rreziqet që janë identifikuar si përparësi për inspektimin, por gjithashtu edhe në lidhje me rreziqet e tjera. Duke qenë se qeverisja mund të testohet efektivisht në terren, kjo nënkupton se inspektimet sistematike në vend të shoqërive administruese janë thelbësore për qasjen me bazë rreziku të AMF-së.

Alternativa të tjera strategjike dhe pasojat

2.50 Vëmendja te qeverisja e subjektit dhe menaxhimi i rrezikut nuk mund të zbusin çdo rrezik apo të gjitha rreziqet serioze në mënyrë të mjaftueshme. Është e qartë se kjo nuk është efektive për rreziqet jashtë kontrollit të subjektit. Nga ana tjetër, as strategjia nuk gjen zbatim për rreziqe si komisionet shumë të larta, ku rreziku i agjencisë nënkupton se interesat e këshillit mbikëqyrës shkojnë ndesh me ato të AMF-së. Disa rreziqe, si ato që kanë të bëjnë me mashtrimin dhe korrigjimin e llogarive, mund të mos jenë të dukshme për bordet e subjekteve dhe/ose duhen zbuluar shumë më shpejt, sesa do të zbuloheshin po të bazoheshin vetëm te kontrollet vjetore. Kështu, AMF-ja duhet të zbatojë alternativa të tjera strategjike, të cilat mund të përfshijnë:

- **Analizë e dokumenteve (off-site)**, për të dhënë paralajmërime të hershme kur rreziqe me ndikim të lartë, si mashtrimi ose parregullsi të tjera financiare, duhen zbuluar e zgjidhur shpejt, përpara sesa të ndodhë ndonjë dëm i konsiderueshëm ose kur pasojat e mundshme të politikave ose veprimeve të shoqërisë janë të paqarta, për shembull, investimi. (Kjo është përveç analizës së dokumenteve, gjë që ndërmerret vetëm për të mbështetur inspektimin në vend).
- **Veprim i synuar zbatueshmërie**, kur AMF-ja nuk ka ndikim të mjaftueshëm për ta arritur ndryshimin përmes edukimit apo krijimit të mundësive dhe kur vetëm efekti frenues i zbatimit konsiderohet si i mundur për të kryer ndryshimin ose mbrojtur kontribuesit, për shembull, në raport me punëdhënësit.
- **Ndryshimi rregullator**, kur nuk mund thjesht të mbështetesh te subjektet e mbikëqyrura që ato të ndjekin praktikën më të mirë ose kur rregullat sjellin si rrjedhojë rezultate të gabuara.
- **Fushatat e komunikimit**, për shembull me punëdhënësit, punëmarrësit dhe publikun e përgjithshëm, për të rritur kuptimin dhe ndërgjegjësimin dhe, kështu, për të përmirësuar sjelljet që ulin rrezikun ndaj objektivit të AMF-së.
- **Kërkimi**, për plotësimin e hendeqeve në njohuritë e AMF-së dhe për të ndihmuar për hartimin apo përpunimin e strategjive të tjera.
- **Ndërlidhje me mbikëqyrës të tjerë dhe organizata qeveritare**, më konkretisht, mbikëqyrësit nga Banka e Shqipërisë.
- **Projekte tematike/shqyrtime**⁸, për shembull, për rritjen e pjesëmarrjes në sistemin vullnetar të pensioneve. Kjo mund të kërkojë kombinimin e kërkimit, analizës së dokumenteve, komunikime dhe marrjen në konsideratë të ndryshimeve rregullatore dhe që mund të mbështeten edhe në diskutimet me subjektet e mbikëqyrura gjatë një kontrolli.

⁸ Një shqyrtim tematik zakonisht përmban katër faza. Së pari grumbullohet informacion nëpërmjet kërkimeve, kërkohet informacion nga subjektet e mbikëqyrura ose grumbullimi i informacionit në vend, më pas merret në konsideratë nga AMF-ja shtrirja dhe natyra e rrezikut dhe se si ai mund të zbutet. Në qoftë se AMF-ja identifikon që rreziku nevojitet të zbutet, ajo duhet të publikojë opinionin e vet ose të udhëzojë zbutjen. Përfundimisht, ajo duhet të inspektojë subjektet (nëse rreziku është me bazë nga subjektet) ose nga ana tjetër të ndërmarrë analiza për të kontrolluar nëse zbutja është bërë efektive.

2.51 Në dokumentimin e opsioneve të zbutjes së rrezikut brenda strategjive të zbutjes së rrezikut, është e rëndësishme që të njihen pasojat e plota të miratimit të opsioneve. Figura 12 më poshtë, ilustron gamën e plotë të pasojave të cilat duhet të merren në konsideratë në varësi të opsionit të miratuar. Për të përgatitur strategjinë tre vjeçare të mbikëqyrjes, është e rëndësishme që grupi i mbikëqyrjes të kontrollojë që departamentet e tjera brenda AMF-së me disa përgjegjësi për opsionet e marra në konsideratë do të mund të mbështetin opsionet sipas qëllimit. Aty ku do të duhet ca kohë për veprimet mbështetëse, për shembull në qoftë se janë identifikuar të dhëna të reja ose kritere për trajnimin, kjo vonesë kohore duhet të merret parasysh.

Figura 12: Ndërlikimet e strategjive për zbatimin e zbutjes së rrezikut



HAPI 4: Përgatitja e planit të mbikëqyrjes

2.52 Duke identifikuar opsionet për të marrë sigurinë ose përmirësuar zbutjen e rrezikut, etapa tjetër është përcaktimi se cili prej tyre duhet të përbëjë pjesë të strategjisë së AMF-së për mbikëqyrjen e pensioneve për tre vitet e ardhshëm. Disa alternativa mund të jenë hedhur poshtë ndërkohë si pa vlerë në vetë formularët e strategjisë së zbutjes së rrezikut, por ka të ngjarë që të ketë më shumë alternativa të zbutjes së rrezikut që mund të mbështeten me burime. Në këtë rast, duhet zgjedhur midis alternativave ose, të paktën, për kohën kur do të zbatohen. Për këtë arsye, procesi është, deri diku, përsëritës. Pasojat më të rëndësishme të strategjisë së synuar mund të diskutohen dhe të vlerësohen në një

takim të Komitetit të Koordinimit të Rrezikut të Pensioneve. Për t'i ndihmuar që të marrin në konsideratë strategjinë, Komiteti duhet të pajiset paraprakisht me skedulat përmbledhëse tashmë të përshkruara.

2.53 Ekzistojnë tre etapa për të përgatitur planin:

- Vendosja për analizat dokumentare;
- Përcaktimi i subjekteve të cilët duhet të inspektohen në vend, për cilat rreziqe, me çfarë rendi, duke pranuar që urdhri mund të ndryshojë në vitet në vazhdim nëse perceptimi i AMF-së për rreziqet ka ndryshuar; dhe
- Vendosja se çfarë vendime të tjera duhet të ndërmerren në vijim dhe koha.

2.54 Vendimet për analizat dokumentare (pavarësisht nga ekipi që i kryen ato) duhet të sigurojnë se ka një paralajmërim të hershëm të mjaftueshëm të problemeve për rreziqet e pranishme me ndikim të lartë ose për rreziqet ngjyrë të kuqe dhe portokalli. Çfarëdo analize e rreziqeve ngjyre të kuqe dhe portokalli për të cilët duhet të forcohen kriteret gjatë mbikëqyrjes në vend, duhet të merret gjithashtu në konsideratë të lartë, nëse ndonjë nga këto analiza jep disa siguri në lidhje me rreziqet e tjera, ajo duhet të theksohet. Duhet të identifikohen analizat e tjera që japin siguri të rëndësishme me pak përpjekje nga grupi i mbikëqyrjes. Dhe duhet të përfshihen gjithashtu analiza të cilat janë thelbësore për matjen e performancës. Këto analiza, në përgjithësi duhet të mbahen në një nivel, i cili mund të paraqitet nga burimet ekzistuese, me një përpjekje të bërë për burime shtesë, nëse ka ndonjë rast të mirë.

2.55 Për aq kohë sa qeverisja e shoqërive dhe përputhshmëria me parimet e mbikëqyrjes së depozitarëve është konsideruar se është e mirë (P ose K), atëherë jo të gjithë subjektet duhet të inspektohen në vend çdo vit. Nga ana tjetër, besimi që mund të jepet për çdo vlerësim, dobësohet me kalimin e kohës dhe do të ishte e papërgjegjshme që të krijohej një boshllëk për më shumë se tre vjet. Gjithashtu, në qoftë se ka ndryshim të rëndësishëm, më përpara duhet të realizohet një inspektim në shoqërinë mëmë, në personelin ose në aktivitetet e subjektit. Të gjitha këto duhet të njihen nga Departamenti i Licencimit, i cili duhet që të mbajë të informuar ekipin e mbikëqyrjes. Rradha e përparësive për subjektet që do të inspektohen duhet të jetë si vijon:

- Gjithçka është e barabartë, subjekti i cili nuk është inspektuar për kohëzgjatjen më të madhe duhet të ketë përparësinë më të madhe.
- Por, nëse ka informacion që sugjeron se një subjekt është në rrezik më të madh se të tjerët, ky subjekt duhet të promovohet në radhën e përparësisë. Kjo mund të krijohet nga:
 - Një vlerësim i dobët i qeverisjes në inspektimet e mëparshme në vend;
 - Drejtimi i rrezikut nga inspektimet e mëparshme në vend, që ka të bëjë me faktin nëse qeverisja dhe menaxhimi i rrezikut në subjekt është përmirësuar apo përkeqësuar – në rastin më të fundit, inspektimi më i hershëm është kërkuar për:
 - Rezultatet e pafavorshme të analizave dokumentare që rezultojnë të lidhura me rreziqet e larta të pranishme ose të mbetura;
 - Një ndryshim i rëndësishëm në personel, në shoqërinë mëmë, në ambiente, etj.; ose

- Probleme të evidentuara nga departamente të tjera në AMF, nga subjektet audituese apo nga burime të tjera të jashtme ose të publikuara, duke përfshirë mbikëqyrësit e tjerë.

- 2.56 Duhet të theksohet që një vlerësim i dobët i qeverisjes mund të ketë ndikim serioz në planin e mbikëqyrjes, pasi burimet e kufizuara, nëse ka, mund të vendosen në menaxhimin e rrezikut të subjektit gjatë mbikëqyrjes dhe në këtë mënyrë inspektime vjetore do të jenë të nevojshme në qoftë se rreziqet e mbetura janë portokalli dhe ndoshta nëse ndonjë rrezik i pranishëm është portokalli. Në këto raste, mund të nevojiten më shumë burime për të plotësuar ato të ekipit.
- 2.57 Përbërësi i planit në vend, duhet gjithashtu të tregojë se cilët rreziqe duhet të inspektohen në shoqëritë administruese. Qeverisja dhe rreziqet e pranishme ngjyrë të kuqe dhe portokalli, plus rreziqet e verdha të mbetura duhet të inspektohen çdo herë. Por plani gjithashtu duhet të sigurojë që çdo rrezik i pranishëm i verdhë dhe jeshil i hapur është inspektuar të paktën një herë në shoqëri gjatë periudhës së planit, për të verifikuar që është justifikuar vlerësimi relativisht i ulët i rrezikut të pranishëm. Rreziqet e verdha të pranishme në çdo rast duhet të inspektohen 3-4 vjet në çdo subjekt.
- 2.58 Kur një subjekt nuk është inspektuar për disa kohë dhe janë gjetur probleme të rëndësishme në inspektimet më të fundit në vend, do të ndërmerren ende disa monitorime në bazë të planit të veprimit të miratuar më subjektin. AMF-ja mund të komunikojë në mënyrë elektronike me menaxhimin e subjektit, për të bërë pyetje në lidhje me ecurinë dhe të shqyrtojë veprimet e ndërmarra për mjaftueshmërinë e zvogëlimit të rrezikut. Në qoftë se ky proces është problematik, inspektimi i ardhshëm mund të duhet të vazhdojë.
- 2.59 Veprimet e tjera që do të përfshihen në plan janë të nevojshme që të zvogëlojë nivelin e rrezikut (të pranishëm ose të mbetur) dhe përfshijnë të gjitha ato që identifikohen në strategjitë e zbutjes së rrezikut (Tabela 2.4). Ato duhet të përfshijnë fushata komunikimesh, shqyrtime tematike dhe ndryshime në legjislacion. Këto duhet të programohen për periudha tre vjeçare, duke balancuar nivelin e rrezikut me nivelin e burimeve që mund të supozohen në mënyrë realiste se janë të disponueshme. Nëse nevojitet mbështetje ose burime nga departamentet e tjera brenda AMF-së, ato duhet të përqasen në konstatime nëse mund të jenë të disponueshme dhe kur. Çdo ndryshim i pamjes duhet të përshkallëzohet në Komitetin e Koordinimit të Rrezikut të Pensioneve dhe/ose në menaxhimin e lartë.
- 2.60 Paketa e plotë e dokumentave (të cilat në mënyrë efektive përfshijnë strategjinë e propozuar duhet të diskutohen dhe të miratohen me Drejtorin e Mbikëqyrjes përpara përfundimit të saj. Ai/ajo duhet të shqyrtojë paketën e plotë të dokumentacionit mbështetës për të përcaktuar që ka një përafrim të fuqishëm dhe mbrojtës ndërmjet asaj që është propozuar dhe nivelit të rrezikut të pranishëm dhe të mbetur dhe rrjedhimisht që veprimet janë mundësisht me kosto të justifikuar. Ai/ajo gjithashtu mund të dëshirojë ta paraqesë atë te Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe te Bordi për të dhënat e tyre. Nga ana tjetër, të dhënat mund të kërkojnë si pjesë e procesit të strategjisë Afat Mesme të AMF-së, shiko më poshtë. Në çdo rast, mund të nevojiten rishikime të paketës së

dokumentacionit për të marrë parasysh reagimet e menaxhimit të lartë në lidhje me strategjinë e përgjithshme të rrezikut.

Plani i vitit të parë

2.61 Për vitin e parë të planit, duhet specifikuar në mënyrë më të detajuar programimi dhe personeli i çdo aktiviteti (në lidhje me çdo subjekt), i përshtatshëm me analizën dokumentare rreth inspektimeve në vend (dhe anasjelltas). Plani duhet të bazohet në burimet e njohura dhe duhet të përfshijë një rast biznesi për personelin shtesë, nëse ato që janë të disponueshme janë të pamjaftueshme për të ndërmarrë të gjitha aktivitetet me përparësi të lartë. Për inspektimet në vend duhet të lejohet kohë e mjaftueshme. Për qëllimet e planifikimit, duhet të supozohet se një inspektim i plotë i shoqërisë së menaxhimit do të kërkojë 4-5 javë të personelit për përgatitjen, 8-9 javë të personelit për realizimin dhe 4-5 javë të personelit për raportimin, të themi rreth 18 javë në total. Një inspektim tek depozitari mund të pritët të zhvillohet të paktën në 12 javë të personelit. Këto shifra mund të kenë nevojë për disa ndryshime, sipas eksperiencës. Burimet e mbetura të disponueshme duhet të shpërndahen në analizat dokumentare.

Të dhëna për Strategjinë Afat Mesme të AMF-së

2.62 Ekipi duhet të punojë me Drejtorin e Mbikëqyrjes për të identifikuar projektet kryesore dhe veprimtaritë e tjera të përfshira në planin tre vjeçar duhet të propozohen për t'u përfshirë në Strategjinë Afat Mesme të AMF-së. Kjo duhet të përfshijë:

- Një përmbledhje të panoramës së rrezikut të pensioneve (të pranishëm dhe të mbetur);
- Një përmbledhje të asaj se si synohet që rreziqet më të mëdha (të pranishme) në sistemin e pensioneve të adresohen dhe të zbuten;
- Projekte ndër-departamentare për zbutjen brenda AMF-së, duke përfshirë rishikimet në legjislacionin e propozuar; dhe
- Çdo zhvillim brenda grupit të mbikëqyrjes me ndërlikime të rëndësishme të burimeve, duke përfshirë nevojat për trajnim.

2.63 Këto të dhëna duhet të jenë të disponueshme nga strategjia e dokumentacionit ku tashmë janë referuar.

HAPI 5: Përfundimi i ciklit të strategjisë për zbutjen e rrezikut

Zbatimi

2.64 Pasi të jetë rënë dakord për strategjinë e mbikëqyrjes së pensionit, ekipi duhet të ndërmarrë hapat e nevojshme që ajo të zbatohet. Ato janë:

- Finalizimi dhe programi i detajuar i veprimeve mbikëqyrëse të kërkuara për grupin e mbikëqyrjes së fondeve të pensionit dhe investimeve, që tregojnë me saktësi më të

madhe se kur do të vendosen veprimet e identifikuar në vitin aktual të strategjisë tre vjeçare.

- Njoftimi i subjekteve të mbikëqyrura për afatet e pritshme dhe përmbajtjen në gjerësi të inspektimeve dhe ndryshimet në të dhënat që duhet t'i paraqesin AMF-së gjatë vitit. Subjektet që do t'i nënshtrohen inspektimit në vend duhen njoftuar menjëherë. Nëse datat e propozuara nuk janë praktike, ato duhet të ricaktohen në këtë pikë.
- Ofrimi i shpjegimeve për ekipin e mbikëqyrjes së pensionit lidhur me atë që duhet ndërmarrë gjatë vitit që vjen dhe pse.
- Rënia dakord me Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median se çfarë do të komunikohet, kujt dhe kur.
- Rënia dakord me Drejtorinë Kërkimeve dhe Zhvillimeve Strategjike lidhur me kërkimet që do të ndërmarrin dhe kur.
- Organizimi i trajnimeve të identifikuar si të nevojshme, për t'i dhënë mundësi personelit të ekipit të mbikëqyrjes t'i kryejë veprimtaritë e planifikuara në mënyrë kompetente.
- Bërja e ndryshimeve në këtë Udhëzues ose dokumenteve të tjera të mbikëqyrjes ose TI-së mbështetëse, që vijnë si rezultat i rishikimit të strategjisë.
- Kryerja e analizës së dokumentave dhe inspektimit në vend të shoqërive administruese dhe depozitarëve (përkatësisht, Kapitulli 4 dhe 5 Udhëzuesit), në përputhje me planin trevjeçar të mbikëqyrjes.

Raportimi gjatë vitit

2.65 Drejtori i Drejtorisë së Fondeve të Pensionit dhe Investimeve duhet të raportojë çdo tremujor te Drejtori i Mbikëqyrjes për faktin nëse plani 3 vjeçar është zbatuar sipas synimit, duke tërhequr vëmendjen për çdo problem ose kufizim të hasur të burimeve. Ai ose ajo, gjithashtu duhet t'i bëjnë një përmbledhje çdo gjashtë muaj Komitetit të Koordinimit të Rrezikut të Pensioneve për çdo zhvillim që nga takimi i kaluar i cili mund të ndikojë në vlerësimin e rrezikut të pranishëm. Informacioni lidhur me problemet e konstatuara gjatë inspektimit në vend nuk duhet t'i jepen Komitetit derisa Bordi dhe Drejtori Ekzekutiv të kenë rënë dakord për përgjigjen ndaj këtyre problemeve.

Shqyrtimi i fundvitit

2.66 Drejt fundit të çdo viti (ndoshta në tetor) Drejtori i Drejtorisë së Fondeve të Pensionit dhe Investimeve do të raportojë te Drejtori i Mbikëqyrjes për dorëzimin e programit për vitin dhe ndërlikimet për vitin e ardhshëm. Ashtu si me raportet tremujore, ai/ajo duhet të konfirmojë që plani për vitin është realizuar, duke dhënë arsyet për çdo shmangie nga ky plan. Një analizë më e hollësishme e efekteve për vlerësimin e rrezikut duhet përgatitur për të informuar analizën vjetore në Komitetin e Rrezikut të Fondeve të Pensionit lidhur me rrezikun e pranishëm dhe rrezikun e mbetur, që do të përdoret në planin e vitit të ardhshëm. Kjo mund të bëhet nëpërmjet përdorimit të kolonës së fundit në Skedulën e Matjeve të Performancës (Tabela 2.3) dhe një matrice të rrezikut të mbetur. Aty ku vlerësimi i rrezikut ndryshon midis shoqërive administruese ose depozitarëve, kjo duhet të tregohet në matricë.

2.67 Aty ku niveli i rrezikut është i papranueshëm vetëm në disa subjekte, duhet të ndërmerren veprime që janë specifike vetëm për atë subjekt. Në qoftë se ka më shumë

gabime të përgjithshme, mund të nevojiten më shumë mjete të përgjithshme, si dhe këto duhet të konsiderohen në planifikimin e ardhshëm të radhës.

Kapitulli 3. Përcaktimi dhe vlerësimi i rezultateve të veprimtarisë së inspektimit në vend dhe analizës

3.1 Ky kapitull i Udhëzuesit shpjegon parimet e mbikëqyrjes dhe përdorimin e tyre për të përcaktuar se sa mirë zbuten rreziqet dhe se si kryhen këto vlerësime në terma të përgjithshme dhe, më tej, ofron një orientim të detajuar lidhur me vlerësimin e qeverisjes dhe zbutjen e rrezikut. Procesi mbështetet veçanërisht te të dhënat e përfuara nga shqyrtimi i dokumentave (Kapitulli 4) dhe përmes inspektimit në vend (Kapitulli 5).

Parimet mbikëqyrëse të zbutjes së rrezikut (përfshi qeverisjen)

3.2 Qëllimi i vlerësimit të rreziqeve në subjektet e mbikëqyrura është që të arrihet në masën që të ketë përputhshmëri me zbutjen e rrezikut që AMF-ja pret nga subjekti për të ulur rrezikun në nivel të pranueshëm. Kjo do t'i japë mundësi AMF-së të bëjë rekomandime për përmirësime, të përcaktojë rëndësinë e këtyre rekomandimeve dhe të përcaktojë, me anë të vlerësimit të nivelit të rrezikut të mbetur, nëse rreziku është ulur në nivele të pranueshme. Supozimi bazë që qëndron në themel të vlerësimit të rrezikut është se proceset e zbutjes së rrezikut, përfshi qeverisjen, në subjektet e mbikëqyrura do të ulin, për aq kohë sa janë efektive, probabilitetin që shumë prej kategorive të rrezikut të AMF-së të materializohen dhe, mundësisht, ndikimin që do kenë, në rast se materializohen. Nëse subjektet ndjekin praktikën e mirë të qeverisjes dhe menaxhimit të rrezikut, ka më pak të ngjarë që rreziqet të materializohen. Prej kësaj, rrjedhin tre elemente domosdoshmërie:

- AMF duhet të kuptojë çfarë përbëjnë praktikat e mira në menaxhimin e rrezikut dhe qeverisje dhe të bjerë dakord për to me subjektet e mbikëqyrura, në mënyrë që gjithkush prej tyre të punojë për objektiva të përbashkëta. Për praktikat e mira duhet rënë dakord në mënyrë të tillë që të shmangët perceptimi se AMF po iu dikton subjekteve se si të drejtojnë biznesin e tyre – janë vetë subjektet ato që duhet të jenë gjykatësit më të mirë për këtë. Kështu, praktikat e mira shprehen si parime të nivelit të lartë, duke ia lënë zbatimin me detaje drejtuesve të subjektit;

- Si AMF, ashtu edhe drejtuesit e lartë të subjekteve duhet të kenë siguri se parimet po respektohen. Përpjekjet që AMF-ja bën për vlerësimin duhet të jenë në raport të drejtë me rrezikun (probabilitetin dhe ndikimin) e mosrespektimit të parimeve dhe me vlerësimin e tyre për sigurimin e cilësisë që iu bëhet drejtuesve të lartë të subjektit;
 - AMF-ja duhet të pranojë në praktikë se disa aspekte të menaxhimit të rrezikut dhe qeverisjes ka të ngjarë të luajnë më shumë rol sesa disa të tjera për të zbutur rreziqet dhe për të përshtatur si duhet vlerësimin e saj të rrezikut.
- 3.3 Parimet mbikëqyrëse të menaxhimit të mirë të rrezikut dhe qeverisjes janë, rrjedhimisht, thelbësore për mbikëqyrjen me bazë rrezikun. Ato mund të kuptohen dhe paraqiten si pritshmëri të AMF-së se si duhet të sillet subjekti dhe, si të tilla, duhet të jenë të shprehura qartë dhe të jetë rënë dakord për to me subjektet.
- 3.4 Vlerësimi i punës kundrejt parimeve është baza e qasjes së vlerësimit. Më poshtë, në këtë seksion, ofrohet orientim mbi arsyetimin, interpretimin dhe përbërjen e parimeve dhe personeli mund të dojë ta përdorë këtë udhëzim për të vlerësuar parimet. Megjithatë, gjykimi kryesor mbikëqyrës është shkalla në të cilën përmbushet secili prej parimeve. Në këtë kuptim, parimet mund të shihen si kritere vlerësuese.
- 3.5 Parimet e shoqërisë administruese pasqyrojnë katër lloje të zbutjes së rrezikut në shoqëri:
- **Qeverisja:** mbulon aspekte të praktikës së mirë në qeverisjen e fondit.
 - **Investimi:** mbulon proceset e nevojshme për zbutjen e rreziqeve që lidhen me strategjinë e investimit të fondit dhe zbutjen e rreziqeve që lindin gjatë veprimtarive së përditshme të investimeve.
 - **Zbutja e rrezikut operativ:** mbulon zbutjen për gjashtë kategori rreziku që lidhen me rreziqet operative në kuadrin e AMF-së.
 - **Zbutja e rrezikut të biznesit:** mbulon katër kategori rreziku që lidhen me drejtimin e shoqërisë administruese në një mënyrë që nuk e respekton kërkesën për t'i trajtuar klientët në mënyrë të drejtë apo me vijimësinë afatgjatë të biznesit.
- Përveç kësaj, ka parime për zbutjen e rrezikut në një depozitar.
- 3.6 Parimet që përdoren aktualisht përmbledhen në Kutinë 2, më poshtë, ku titujt me shkronja të pjerrëta tregojnë kategoritë e rreziqeve të cilave iu referohen. Artikulimi i plotë i parimeve është dhënë në Shtojcën 1 të këtij Manuali. Parimet mund të rishikohen si pjesë e procesit të rishikimit në fund të ciklit mbikëqyrës, me qëllim që të përqendrohen më shumë në aspekte të zbutjes së rrezikut.

Kutia 2: Parimet e vlerësimit të zbutjes së rrezikut	
Qeverisja	Investimet
1. Përshtatshmëria e strukturës organizative	<i>Strategjia e investimeve</i>
2. Mjaftueshmëria e ekspertizës dhe njohurisë	1. Përgjegjësia
3. Mjaftueshmëria e rolit të mirëbesimit të Këshillit Mbikëqyrës	2. Ekspertiza
4. Përshtatshmëria e planifikimit	3. Analiza
	4. Objektivi
	5. Strategjia e investimit
	6. Burimet e investimeve

strategjik dhe marrjes së vendimeve 5. Vendosi dhe testimi i objektivave 6. Kuadër i përshtatshëm i menaxhimit të riskut dhe kontrollit të brendshëm	7. Vlerësimi i punës <i>Kontrolli i rrezikut të investimeve</i> 8. Organizimi i funksionit të investimeve 9. Kontrolli i vendimeve për investime 10. Menaxhimi i rrezikut 11. Vlerësimi 12. Transparenca dhe raportimi
Zbutja e rrezikut operativ <i>Kontributet e marra</i> 1. Kalendari i kontributeve 2. Kontabilitet i saktë <i>Mbajtja e të dhënave</i> 3. Vlerësimi i njësive kontabël 4. Të dhënat e kontribuesit <i>TI dhe siguria e të dhënave</i> 5. Akses në TI i personelit ose mjediseve të shoqërisë 6. Ndryshime në pajisjet dhe programet e (hardware dhe software) 7. Politika e mbrojtjes së të dhënave 8. Marrëveshjet e shërbimit 9. Masa sigurie <i>Vazhdimësia e biznesit</i> 10. Vazhdimësia e biznesit <i>Siguria e aseteve (në shoqëritë administruese)</i> 11. Transferta financiare në dalje 12. Problemet e rakordimit 13. Ndërgjegjësimi mbi mashtrimin <i>Pagesa nga fondet</i> 14. Vlefshmëria e kërkesave për kryerjen e pagesave 15. Menaxhimi i likuiditetit të fondit⁹	Zbutja e rrezikut të biznesit <i>Sjellja e biznesit (shitja)</i> 1. Politikat 2. Përputhja me politikat 3. Personeli/agentët e shitjes 4. Regjistrimi <i>Zgjedhja e pagesës</i> 5. Informacioni për kontribuesit 6. Produktet në rënie <i>Vijueshmëria e shoqërisë administruese</i> 7. Plani i biznesit 8. Mjaftueshmëria e kapitalit 9. Rreziqet për vijueshmërinë <i>Kostot dhe tarifat</i> 10. Kostot e shkaktuara dhe që iu ngarkohen kontribuesve
	Depozitari 1. Detyrat e mirëbesimit 2. Sistem efektiv për regjistrim dhe përpunim 3. Rakordimet e përditshme 4. Ekzekutimi i veprimeve tregtare 5. Personel i mjaftueshëm dhe i mirëtrajnuar 6. <i>Hardware</i> dhe <i>software</i> i përshtatshëm informatik 7. Kontroll i brendshëm 8. Rimëkëmbja nga Fatkeqësitë ose plani i vazhdimësisë së biznesit 9. Transferimi i aseteve të fondeve, regjistrimeve dhe regjistrave

Qasja e përgjithshme ndaj vlerësimit të rrezikut

3.7 Pasi është vlerësuar përputhja me parimet e mbikëqyrjes, hapi tjetër është përcaktimi i pasojave të vlerësimit në lidhje me shkallën në të cilën janë zbutur rreziqet. Metodologjia e vlerësimit bazohet në supozimet bazë si në vijim:

- Çdo kategori rreziku duhet vlerësuar në mënyrë të pavarur dhe vlerësimet e rrezikut nuk duhet të bashkohen. Fakti që një njësi është mirë në menaxhimin e një kategorie rreziku nuk jep garanci për një tjetër kategori rreziku;

⁹ Theksohet që parimi 15 i rrezikut operacional është ende për t'u miratuar me shoqëritë administruese.

- Përrjashtim bën vlerësimi i qeverisjes, i cili mund të japë garanci për një gamë kategorish të rrezikut, në varësi të sa besohet se qeverisja e mirë kontribuon në zbutjen efikase të rrezikut (apo se qeverisja e keqe i përkeqëson disa rreziqe). Për këtë arsye, vlerësimi për qeverisjen, ose disa pjesë të tij, duhet të faktorizohen në vlerësimin e kategorive të rrezikut;
- Garancia për cilësinë e menaxhimit të rrezikut, përfshi qeverisjen, ndikon kryesisht në mundësinë e materializimit të rrezikut. Gjithashtu, mund edhe të dilet në përfundimin se zbutja e rrezikut ka ndikim të zvogëluar, por ky është një supozim që duhet trajtuar me kujdes rast pas rasti. Për shembull, masat për parandalimin e mashtrimit mund t'i zvogëlojnë përmasat e çdo mashtrimi që ndodh, ashtu si dhe gjasat që të ndodhë, por komponenti i dëmit të reputacionit të ndikimit të një mashtrimi mund të mos zvogëlohet në proporcion me shkallën e mashtrimit;
- Nëse një rrezik që materializohet ka ndikim konkret, kjo kërkon vëmendje të veçantë, duke qenë se mund të shtojë vlerësimin e rrezikut të mbetur.

Vlerësimi i parimeve të mbikëqyrjes

3.8 Çdo parim i menaxhimit të rrezikut për kategoritë e rrezikut që mbulohen nga inspektimi si dhe çdo parim i qeverisjes duhet të vlerësohet më vete, kurse rezultatet të kombinuara, siç tregohet në sesionin që pason. Për të vlerësuar përputhjen me secilin parim të mbikëqyrjes përdoret një shkallë prej katër pikësh, si në vijim:

- Në përputhje të plotë (P) – parimi është ndjekur plotësisht në çdo aspekt material – kjo mund të quhet edhe përputhje e fortë;
- Kryesisht në përputhje (K) – parimi është ndjekur në pjesën më të madhe por jo të gjitha aspektet – kjo mund të quhet edhe përputhje mjaftueshmërisht e fortë;
- Në përputhje të pjesshme (Pj) – parimi është ndjekur vetëm në disa aspekte – kjo mund të quhet edhe përputhje mjaft e dobët;
- Në mospërputhje (M) – parimi nuk është ndjekur në asnjë aspekt – kjo mund të quhet edhe përputhje e dobët.

3.9 Në praktikë, mund të jetë shumë e vështirë të provohet përputhje e plotë. Mbikëqyrësi nuk është gjithmonë i pranishëm dhe nuk di gjithçka, edhe pse prania e qeverisjes së mirë mund të ofrojë disa garanci për çfarë ndodh kur mbikëqyrësi nuk është duke parë. Ndërkohë, mbikëqyrësi kërkon për prova të mospërputhjes (dhe të qeverisjes së mirë) dhe ndikimin që shembuj të tillë mund të kenë mbi materializimin e rrezikut. Kjo, në çdo rast, pasqyron sesi punon mbikëqyrësi me njësitë e mbikëqyrura. Ato janë përgjegjëse për të arritur përputhje të plotë. Roli i mbikëqyrësit është t'u mundësojë atyre ta arrijnë këtë qëllim, duke u treguar se ku nuk ka dalë mirë njësia dhe çfarë mund të bëjë menaxhimi për të riparuar situata të tilla. Për ta bërë këtë në mënyrë bindëse, AMF duhet të ketë prova ku të mbështesë përfundimet dhe rekomandimet e saj. Sa më të këqija të jenë gjetjet, ndaj dhe aq më shumë rezistente mund të jetë njësia për t'i pranuar, prandaj aq më të mira duhet të jenë provat. Për këtë arsye, kur bëhen vlerësime të rrezikut stafi duhet të jetë realist për atë që mund të justifikojnë provat dhe mund t'i nevojitet të priret drejt një vlerësimi më të mirë aty ku provat nuk e mbështesin dot një vlerësim më të dobët.

3.10 Për shembull, nëse mbikëqyrësit janë të bindur prej procesit të intervistimit, të pambështetur nga të dhëna të analizës dokumentare, se ka përputhje me një parim, kjo

mund të mjaftojë të japin një vlerësim në përputhje të plotë (ose kryesisht në përputhje nëse i intervistuari pranon dështimin e rastësishëm). Por, nëse intervistat ose të dhënat dokumentare sugjerojnë se të dhënat nga intervista nuk janë tërësisht të besueshme, ose se rreziku i pranishëm është kaq i madh sa mbikëqyrësit nuk mund të mbështeten vetëm në dhënat e intervistës, mbikëqyrësit duhet të ndërmarrin disa testime të veçanta në terren për të kërkuar prova të tjera për të mbështetur përfundimet e tyre.

3.11 Një tjetër mënyrë për të përshkruar nivelet e përputhjes që po vlerësohet është që ato të konsiderohen si në vijim:

- Në përputhje të plotë: mbikëqyrësi nuk ka gjetur asgjë që nuk shkon;
- Kryesisht në përputhje: mbikëqyrësi ka konstatuar shembuj të izoluar të pa përputhshmërisë, por këto nuk kanë pasur pasoja negative të provuara nga rreziku(qet) përkatëse të materializuara në praktikë dhe shumicën e kohës ose në shumicën e tyre duket se kanë qenë në përputhje;
- Në përputhje të pjesshme: mbikëqyrësi ka konstatuar disa prova të përputhshmërisë, por përjashtimet janë thelbësore dhe e lënë rrezikun të pa zbutur, mundësisht me disa materializime të rrezikut të konstatuar; dhe
- Në mospërputhje: mbikëqyrësi ka gjetur prova se nuk ka përputhje me parimin në asnjë mënyrë kuptimplotë.

3.12 Mund të shihet nga përkufizimet e mësipërme se është e rëndësishme që të merret prova për nivelin e materializimit të rrezikut që është i dukshëm, edhe aty ku është i mundur përdorimi i treguesve sasiore. Dokumentimi i vlerësimit të parimeve ndërmerret në formularin e planifikimit të mbikëqyrjes dhe vlerësimit (FPMV), të përshkruar në detaje në paragrafin 5.12 dhe në vijim. Për çdo parim, formularët ofrojnë një sërë replikash për intervistën dhe pyetjesh për vlerësimin. Kur përputhja vlerësohet prej përgjigjeve të këtyre pyetjeve, vlerësuesit nuk duhet të përdorin qasje matematikore që gjenden të mesmen, për më tepër sepse jo domosdoshmërisht janë marrë përgjigje për çdo replikë dhe rëndësia e tyre ndryshon sipas replikave. Në vend të kësaj ata duhet të përdorin gjykimin, duke zbatuar udhëzimet në vijim:

- Në qoftë se të gjitha përgjigjet e marra janë të kënaqshme, atëherë ka pasur përputhje të plotë (P);
- Nëse shumica e përgjigjeve janë të kënaqshme dhe nuk ka pasur pasoja negative domethënëse, parimet mund të vlerësohen si kryesisht në përputhje (K);
- Nga ana tjetër, nëse përgjigjet janë të tilla që thelbësisht nuk kanë përputhje, parimet mund të vlerësohen si në mospërputhje (M);
- Nëse përgjigjet ofrojnë një pamje të përzier, parimi mund të vlerësohet si në përputhje të pjesshme (Pj);
- Nëse ka pasur pasoja negative domethënëse që mund t'i atribuohen dështimit të këtij parimi, vlerësimi duhet të jetë ose në përputhje të pjesshme (P) ose në mospërputhje (M), në varësi të numrit të përgjigjeve të kënaqshme.

3.13 Për këtë arsye, kur merr në konsideratë shkallën e përputhjes me secilin parim, vlerësuesi duhet të konsiderojë edhe pasojat e dështimit. Kjo duhet të dokumentohet sepse është e vlefshme edhe për të kombinuar parimet në një vlerësim të përgjithshëm të rrezikut (shih më poshtë). Vlerësimi i asaj çka përbën P, Pj, K dhe M për çdo parim jepet në sesionet e mëtejshme të këtij kapitulli në lidhje me qeverisjen dhe çdo kategori rreziku.

- 3.14 Sigurisht që fakti që mbikëqyrësi nuk ka gjetur ose ka gjetur shumë pak gabime nuk është detyruesisht tregues i realitetit. Kjo është edhe arsyeja se pse qeverisja është kaq e rëndësishme. Nëse qeverisja është e fortë (në përputhje të plotë), menaxhimi i njësisë do ta dijë vetë sesa mirë përputhet me parimet e zbutjes së rrezikut dhe do të ketë mjetet dhe vullnetin për të dalluar dhe për të riparuar mangësitë. Për këtë arsye, në raste të tilla, AMF-ja mund të jetë shumë herë më e sigurt se mungesa e provave për dështimet e përputhshmërisë pasqyron realitetin e vërtetë dhe se përputhshmëria e gjetur gjatë inspektimit do të jetë e qëndrueshme. Në sesionet në vijim, ky Manual tregon sesi vlerësimet e zbutjes së rrezikut dhe të qeverisjes mund të kombinohen për ta pasqyruar këtë fakt.
- 3.15 Parimet e qeverisjes, përkojnë deri në njëfarë shkalle me parimet e zbutjes së rrezikut, siç paraqitet në tabelën 13 më poshtë. Kur vendoset për vlerësimin e çdo parimi të menaxhimit të rrezikut, këshillohet që të kontrollohet vlerësimi i çdo parimi të qeverisjes dhe anasjelltas, si pjesë e procesit për të rënë dakord për vlerësimet me ekipin e inspektimit. Prandaj, për shembull, duhet të ketë një arsye të fortë që vlerësimi i parimit të investimit 5 (strategjia) të devijojë nga parimi i qeverisjes (4), i rëndësishëm për formulimin e strategjisë. Duhet të ketë një arsye të fortë sepse asnjë nga parimet nuk është identik, por grupi duhet të kuptoj se pse ka dallime.

Tabela 13: Lidhjet ndërmjet parimeve të qeverisjes dhe parimeve të tjera të zbutjes së rrezikut

Parimet e qeverisjes	1	2	3	4	5	6
Parimet e rrezikut të investimeve	1, 8	2	1, 6, (8)	3, 4, 5	7, (12)	5, 8-12
Parimet e rrezikut të biznesit	3	6	1, 6, 10	1, 7-9	6-8	2, 4, 9-10
Parimet e rrezikut operativ	1-15	1-15		8	7-8	1-15

Kutitë e ngjyrosura në rreshtin e fundit tregojnë se të gjitha parimet e rreziqeve operative duhet të jenë të lidhura me parimin e qeverisjes 6 dhe me disa parime të tjera, edhe pse lidhja me parimet e tjera përveç 6-s mund të jetë relativisht e dobët.

- 3.16 Siç shpjegohet më tej në Kapitullin e 5-të, (në hapin e 5-të), reagimi i mbikëqyrësit ndikohet edhe nga drejtimi i rrezikut dhe mosarritja për të përmbushur rekomandimet e AMF-së në të shkuarën. Si rregull kryesor, aty ku menaxhimi i rrezikut i një njësie është duke u përmirësuar dukshëm, atëherë ka gjasa që një reagim më pak serioz nga

ç'tregohet të jetë i përshtatshëm – nëse është duke u përkeqësuar, mund të jetë një më i lartë.

Kombinimi i vlerësimeve të parimeve në vlerësimin e rrezikut të mbetur

3.17 Për pothuaj çdo rrezik ka më shumë se një parim dhe vlerësimet e çdo parimi nevojitet të kombinohen për të ofruar një vlerësim të rrezikut të mbetur për çdo rrezik. Vlerësimi i parimeve të menaxhimit të rrezikut duhet gjithashtu të marrë në konsideratë zbutjen e ofruar nga qeverisja. Përfundimi më i rëndësishëm i procesit të vlerësimit është ngjyra e rrezikut e jo pozicioni i tij i saktë në matricë. Vlerësimi i përgjithshëm i qeverisjes dhe i zbutjes së rrezikut duhet të ndërmerret si një aktivitet grupi, duke i konsideruar çështjet secili me radhë. Pavarësisht se çfarë ka arritur vlerësimi, duhet të jepet një shpjegim se pse u arrit. Formulari në Materialin 3.1 duhet të përdoret për të kombinuar vlerësimin e parimeve nga provat e dokumentuara në FPMV-të.

3.18 Siç tregon tabela 10 në Kapitullin e 2-të, është ngjyra ajo që informon reagimin e ardhshëm ndaj rrezikut. Ky vështrim ofron një farë elasticiteti për të vlerësuar rrezikun e mbetur nga perspektiva të ndryshme aty ku është me vend, siç shpjegohet më poshtë. Kjo nënkupton se mund të ndërmerren dy qasje të ndryshme vlerësimi:

- Probabiliteti dhe ndikimi i materializimit të rrezikut pavarësisht kontrolleve që janë konstatuar se zbatohen, **ku nuk ka pasur pasoja domethënëse nga rreziku që materializohet** – në këtë rast ndikimi i mbetur konsiderohet të jetë i njëjtë me ndikimin e pranishëm, por probabiliteti mund shumë mirë të jetë më i vogël se probabiliteti i pranishëm. Zvogëlimi i probabilitetit është llogaritur duke përdorur rregullin në lidhje me vlerësimin PKPjM të çdo parimi – shih paragrafët në vijim; dhe
- Ky lloj vlerësimi duhet të bëhet edhe **aty ku rreziku është materializuar me pasoja domethënëse**. Por, përveç kësaj, mund t'ia vlejë të vlerësohet edhe ndikimi i vërtetë (i mbetur) i mangësive shkakësore të kontrollit – i cili mund të jetë më i pakët se ndikimi i pranishëm¹⁰. Këtij ndikimi, me gjasë më i ulët se ai i pranishëm, duhet t'i caktohet një probabilitet, i cili duhet të jetë normalisht ose i mesëm-i lartë për ngjarjet që ndodhin vetëm njëherë ose me probabilitet të lartë aty ku problemet janë të vazhdueshme ose të shpeshta. Të njëjtat kritere janë përdorur për të vlerësuar ndikimin e mbetur si ndikimin e pranishëm (paragrafi 1.22). Duhet të përdoret më i dobëti nga dy vlerësimet e marra nga dy rrugë të ndryshme.

3.19 Duke nisur me qasjen e parë, qasja e kombinimit të pikëve PKPjM për secilin parim në një pikë PKPjM për gjithë rrezikun ose gjithë qeverisjen varet nga gjykimi, duke qenë se rëndësia e parimeve ndryshon, por mund të shihet si e ngjashme me të për të kombinuar vlerësimin e replikave në vlerësimin e parimit, siç sugjerohet në paragrafin 3.12. Prandaj:

- Nëse të gjitha parimet janë vlerësuar si P, ka pasur përputhje të plotë për këtë rrezik (P);
- Nëse të gjithë parimet përveç njërit janë vlerësuar si P dhe një parim është vlerësuar si K, përsëri mund të jepet një vlerësim P nëse konsiderohet se efekti i mangësive që kanë shkaktuar K-në janë të papërfillshme për rrezikun e përgjithshëm;

¹⁰ Në rastin kur rreziku materializohet dhe ndikimi është një nivel më lart nga ç'pretendohet në llogaritjen e rrezikut të pranishëm, vlerësimi i rrezikut të pranishëm do duhet të ndryshohet në përputhje me gjetjet.

- Nëse shumica e parimeve janë vlerësuar si P, ose të gjitha janë vlerësuar si P ose K (por jo të gjitha P), zbutja e rrezikut mund të vlerësohet si kryesisht në përputhje (K);
- Nëse ka një parim të vlerësuar si Pj, rreziku përsëri mund të vlerësohet si K për sa kohë pjesa tjetër janë vlerësuar si të paktën K, përveç rasteve kur ka pasoja negative domethënëse që tregojnë se rreziku duhet të vlerësohet si Pj;
- Nëse shumica e parimeve janë vlerësuar si Pj ose më sipër, atëherë rreziku duhet të vlerësohet si Pj (ose më sipër nëse plotësohen kriteret në pikat e mëparshme);
- Nëse të paktën gjysma e parimeve janë vlerësuar si M, atëherë rreziku duhet të vlerësohet si M.

3.20 Marrja e një vlerësimi të rrezikut të mbetur nga pikët PKPjM zbaton një parim kyç të mbikëqyrjes të bazuar në rrezik, që një cilësi e mirë e zbutjes së rrezikut mund ta zvogëlojë vlerësimin e probabilitetit të mbetur të rreziqeve që materializohen. Nëse zbutja funksionon ashtu si pret AMF-ja, zhvendosja në të majtë të vlerësimit të probabilitetit të pranishëm në matricën e rrezikut duhet të jetë e mundur – prandaj probabiliteti i mbetur është më i vogël se ai i pranishëm. Nga ana tjetër, kontrolli vërtet i keq është më keq se një nga supozimet e bëra ku probabiliteti i pranishëm vlerësohet si më pak se ‘i lartë’, prandaj dhe është gjithashtu e mundur zhvendosja në të djathtë, duke i dhënë një probabilitet të mbetur më të lartë se ai i pranishëm. Kjo mund të rezultojë në ndryshimin e probabilitetit të pranishëm gjatë rishikimit në vitin e ardhshëm të rrezikut të pranishëm, të paktën për njësinë në fjalë.

3.21 Për këtë arsye, vlerësimi i zbutjes mundëson një lëvizje horizontale përgjatë aksit të probabilitetit në nivelin e ndikimit të vlerësuar, i cili parashikohet se nuk mund të ndryshohet nga zbutja¹¹. Efekti i qeverisjes duhet gjithashtu të faktorizohet. Qeverisja nuk është vendosur në matricë sepse nuk është një rrezik por një element i rëndësishëm në zbutjen e tij. Ndërkohë, vlerësimi i qeverisjes mund të përmirësojë ose të përkeqësojë vlerësimin e përgjithshëm të secilit rrezik. Kjo bëhet duke përdorur matricën transformuese në tabelën 14 më poshtë. Vlerësimi i zbutjes së rrezikut dhe vlerësimi i qeverisjes kombinohen si një kuti në matricë, duke dhënë një numër transformimi. Për shembull, një P për qeverisjen dhe Pj për zbutjen e riskut japin ‘1’. Ky numër ofron pikët e probabilitetit në matricën e rrezikut të mbetur, duke treguar sa kuti është probabiliteti i mbetur në të majtë të probabilitetit të pranishëm të gjithë sistemit. ‘1’ do ta zhvendoste probabilitetin një kuti në të majtë të vlerësimit të probabilitetit në matricën e rrezikut të pranishëm. ‘2’ do të rezultonte në një lëvizje prej dy kutish në të majtë, etj. Aty ku ka vlerësim minus, zhvendosja është në të djathtë – për shembull probabiliteti vlerësohet si më i dobët se ai në matricën e riskut të pranishëm.

Tabela 14: Tabela e transformimit për të shndërruar vlerësimet e qeverisjes dhe të zbutjes së rrezikut të veçantë në probabilitet të zvogëluar (ose të zmadhuar) të materializimit të rrezikut

Vlerësimi i qeverisjes	Vlerësimi i zbutjes së rrezikut
------------------------	---------------------------------

¹¹ Në rrethana të veçanta grupi i mbikëqyrjes mund të arrijë në përfundimin se ndikimi i pranishëm është zvogëluar. Është e qartë se, një rritje e konsiderueshme e diversifikimit të një portofoli pensioni mund të ulë ndikimin e mospagesës së bonove të qeverisë shqiptare.

	M	Pj	K	P
P	0	1	2	3
K	0	0	1	2
Pj	-1	0	0	1
M	-1	-1	0	0

3.22 Vlerësimi i qeverisjes, i përdorur me qëllim për të zbutur rreziku, mund të ndryshojë sipas llojeve të ndryshme të rrezikut. Kur kryhet një vlerësim i qeverisjes, siç është shpjeguar në paragrafin 3.19, grupi duhet të marrë në konsideratë se cilat parime të qeverisjes janë të rëndësishme për cilat rreziqe, të udhëzuar nga matrica në tabelën 13 më sipër. Vlerësimi i parimeve që konsiderohen si të parëndësishme mund të injorohen. Prandaj:

- Të gjitha parimet e qeverisjes duhet të kombinohen për të ndihmuar vlerësimin e rrezikut **të strategjisë së investimit**;
- Parimet e qeverisjes 1 dhe 6 duhet të kombinohen për të ndihmuar vlerësimin e rrezikut të **kontrollit të riskut të rrezikut**, edhe pse një vlerësim negativ për parimet 3 ose 5 mund të ketë gjithashtu ndikim;
- Parimet e qeverisjes 3, 4 dhe 6 janë më të rëndësishmet për rrezikun e **sjelljes së biznesit** (shitje me mashtrim);
- Parimet e qeverisjes 2-5 janë më të rëndësishmet për rrezikun e **pagesës**;
- Parimet e qeverisjes 4-6 janë më të rëndësishmet për rrezikun e **qëndrueshmërisë së shoqërisë**;
- Parimi kryesor i qeverisjes, i rëndësishëm për **rreziqet operative**, është parimi 6, por një vlerësim i parimeve 1 ose 2 mund gjithashtu të merren në konsideratë, kurse parimet 4-5 ka shumë mundësi të jenë të rëndësishme për rrezikun e **Ti-së dhe sigurisë së të dhënave**.


3.23 Kuptimi i disa prej transformimeve në tabelën 14 mund të artikulohen si në vijim:

- Nëse ka përputhje të plotë me parimet e zbutjes së rrezikut për një kategori të caktuar rrezikut, por qeverisja është e dobët (M), nuk mund të ketë mbështetje të kontrollet, sepse ato mund të ndalin së funksionuari dhe drejtuesit nuk i vënë re, nuk u japin rëndësi ose nuk reagojnë. Nëse qeverisja është e pjesshme (Pj) atëherë, mund të ketë një masë mbështetjeje të kontrollet – ka disa garanci të kufizuara që mund të merren për vazhdimësinë e kontrolleve – dhe probabiliteti i mbetur bie me një kuti. Nëse është kryesisht në përputhje (K), mund të rritet mbështetja, e barazvlefshme me 2 kuti, dhe nëse qeverisja është e shkëlqyer (P) atëherë mund të justifikohen 3 kuti zbritjeje, duke qenë se ky rrezik nuk ka pothuaj asnjë mundësi të materializohet.
- Nëse ka përputhje të pjesshme me parimet e zbutjes së rrezikut për një kategori të caktuar rreziku, por qeverisja është e dobët (M), është e mundur që supozimet që përbëjnë bazën për efektin e rregullave dhe strukturën e tregut mbi rrezikun janë vënë gabim dhe probabiliteti i rrezikut është më i dobët nga ç'është parashikuar si rrezik i pranishëm. Nëse qeverisja është e pjesshme ose kryesisht në përputhje, kjo duhet të jetë e mjaftueshme për të justifikuar nivelin e rrezikut të pranishëm, por jo më tepër. Por qeverisje vërtet e mirë (P) është më mirë se kaq, kur mundëson një nivel të caktuar mbështetjeje të zbutja e subjektit.

- Së fundmi, nëse nuk ka zbutje rreziku efikase (M), është e pamundur të thuhet se rreziku është zvogëluar nën nivelin e pranishëm. Në fakt, nëse qeverisja është M ose Pj, edhe vlerësimi i rrezikut të pranishëm e nënvlerëson probabilitetin. Prej padijes ose keqdashjes, menaxhimi i lartë mund të jetë duke ndërmarrë veprime që i përkeqësojnë gjërat.

3.24 Nëse nuk është e mundur të zhvendoset numri i kutive në të majtë, siç u tregua në këtë analizë, ka dy mundësi. E para, duhet marrë në konsideratë mundësia se ndikimi i mbetur është më i vogël se ndikimi i pranishëm me një kuti. Kur bën këtë, grupi duhet të mendohet nëse ka justifikim për të besuar se ndikimi maksimal është zvogëluar në mënyrë domethënëse nga zbutja e rrezikut dhe qeverisja në lidhje me rrezikun në fjalë. Përndryshe, mund të shtohen shtylla të tjera në të majtë të shtyllës së probabilitetit më të ulët, të përdorur për rrezikun e pranishëm, aq sa duhen për të mundësuar që probabiliteti të zvogëlohet në një nivel të pranueshëm (minimal), siç paraqitet në tabelën 15 më poshtë. Duhet gjykuar më parë se t'u jepet kategorive të rrezikut me ndikim të lartë një vlerësim probabiliteti më të ulët sesa ka në dispozicion në matricën e rrezikut të pranishëm, duke qenë se kjo është kutia ku rrinë 'mjellmat e zeza' (ngjarje që devijojnë përtej asaj që është e pritshme dhe tejet të vështira për t'u parashikuar, shën. i përkthyesit), rreziqet e rralla por shkatërrimtare. Vetëm ngaqë probabiliteti i mbetur është shumë i ulët nuk do të thotë se kategoria e rrezikut mund të injorohet. Rreziku i pranishëm nuk mund të zvogëlohet në një nivel poshtë 'të verdhës', ndaj dhe gjithmonë duhet të programohet pak monitorim.

Tabela 15: Matrica e rrezikut të mbetur që tregon deri në dy nivele të probabilitetit nën probabilitetin e ulët të përdorur në matricën e rrezikut të pranishëm



Faktorizimi i pasojave negative në vlerësimin e rrezikut të mbetur

- 3.25 Në shumë raste, mospërputhja e plotë nuk do të ketë pasoja negative domethënëse. Për këtë arsye rreziku, sipas përkufizimit, nuk është materializuar, ndaj dhe është e arsyeshme të dalim në përfundimin se probabiliteti i mbetur është i mesëm-i ulët ose i ulët. Aty ku ka pasoja negative domethënëse, qasja alternative i vlerëson rreziqet në bazë të pasojave të materializimit të rreziqeve.
- 3.26 Në çdo rast, është e rëndësishme që AMF të regjistrojë dhe të marrë në konsideratë pasojat negative të mospërputhjes së plotë. Kur u paraqet përfundimet njësive të mbikëqyrura, AMF-ja duhet të lidhë mospërputhjet me pasojat negative, në mënyrë që njësitë të kuptojnë se pse duhet të përmirësojnë qeverisjen apo mënyrën sesi e menaxhojnë rrezikun. Për këtë arsye, AMF duhet të shqyrtojë pasojat negative të mospërputhjes/ve së plotë dhe sesa serioze janë ato. Për secilin parim që nuk përputhet plotësisht, duhet marrë në konsideratë pasoja konkrete e dështimit dhe duhet dokumentuar në FPMV, të paktën në nivelin e parimit. (Ia vlen të regjistrohet çdo pasojë e pafavorshme dështimesh kundrejt secilës pyetje që ka të bëjë me secilin parim, por pa ndonjë detyrim për të gjetur një pasojë për secilën pyetje).
- 3.27 Nëse ka pasoja domethënëse, duhet dalë në përfundimin se rreziku është materializuar deri në njëfarë mase, probabiliteti i ndikimit është i mesëm-i lartë nëse ka ndodhur vetëm një herë, ose i lartë nëse është i shpeshtë dhe i vazhdueshëm. Nëse ka ndodhur ndikim i plotë, ashtu siç përshkruhet në përshkrimin e rrezikut, atëherë rreziku duhet shënuar me atë nivel probabiliteti dhe me nivelin e pranishëm të ndikimit. Por ndikimi mund të jetë më i paktë se ai në përkufizimin e rrezikut. Për shembull, një proces i dobët strategjie investimi mund të përfundojë në fitime me një shumë më të vogël nga ç'duhej të ishte, duke pasur më pak ndikim të mbetur sesa rreziku i pranishëm, i cili merret me humbje më të mëdha. Ngjyra e ngjarjes me ndikim më të ulët mund të krahasohet pastaj me atë të matjes të bërë krejtësisht në bazë të qeverisjes dhe të zbutjes së rrezikut.
- 3.28 Për këtë arsye, për procesin e vlerësimit duhet që grupi i inspektimit të nxjerrë përfundime bazuar në ekzistencën e provave për materializimin e rrezikut apo për ndikimin e mospërputhjes mbi gjasat e materializimit të rrezikut. Sa më e rëndë mospërputhja, aq më shumë përpjekje duhen bërë në këtë drejtim. Në praktikë, shumë prej parimeve janë hartuar duke pasur parasysh rëndësinë, duke lejuar të vlerësohen si jo në përputhje të plotë ose ndonjëherë në përputhje të pjesshme vetëm atëherë kur ka prova se mospërputhja ka pasur lidhje me rrezikun. Kështu, një vlerësim i dobët duhet të reflektojë njëfarë ndikimi negativ. Në këto raste, ka më pak gjasa që shqyrtimi i ndikimit të mbetur të japë një ngjyrë më të keqe sesa përqendrimi te probabiliteti.
- 3.29 Në tabelën 3 më poshtë jepen shembuj se si mund të ndërmerren vlerësime duke përdorur njëkohësisht perspektivën e probabilitetit dhe të ndikimit.

Tabela 3: Shembuj të llogaritjes së rrezikut të mbetur**ShAFP Siguria e aseteve**

- Ndikimi i pranishëm për këtë rrezik vlerësohet i lartë, për arsye reputacioni. Probabiliteti i pranishëm i një humbjeje që do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm reputacioni vlerësohet si i mesëm-i ulët. Për këtë arsye, pikënisja e vlerësimit është se ky është një

rrezik i pranishëm ngjyrë portokalli.

- Për shembull, inspektimi i AMF-së së një ShAFP-je tregoi se shifrat e siguruara nga depozitari nuk janë kontrolluar prej disa muajsh përkundrejt regjistrimeve të ShFAP-së. Gjatë kësaj periudhe, llogaritë e përfituesve janë zmadhuar me deri në 0.01% dhe disa individë janë mbipaguar me mijëra Lekë me anë transfertash. Këto ose janë marrë nga fonde pensioni të tjera, ose janë faturuar si shpenzime të ShFAP-së, prandaj askush nuk humbi para dhe problemi nuk u bë publik. ShAFP bëri përpjekje të konsiderueshme për ta zgjidhur këtë ngatërresë.
- Kjo është një mospërputhje kaq e madhe sa rreziku nuk mund të vlerësohet më mirë sesa Pj. Nëse mospërputhja nuk do të ishte identifikuar nga menaxhimi i rrezikut dhe struktura e kontrollit, as qeverisja nuk do të mund të vlerësohej më mirë se Pj (që do të ishte kategorizimi i parimit të 6-të). Por, nëse qeverisja e mirë do të kishte ndërhyrë për ta identifikuar dhe për ta korrigjuar problemin para se të ishin kryer transfertat, qeverisja mund të ishte vlerësuar si K. Megjithatë, në secilin rast, rreziku i mbetur mbetet ngjyrë portokalli, ose mund të vlerësohet edhe si i kuq nëse vlerësimet nën Pj janë dhënë për shkak të dështimeve të tjera.
- Nga perspektiva e ndikimit, kjo mund të konsiderohet si një ngjarje me ndikim të mesëm-të ulët (pa dëm të reputacionit, pa humbje për përfituesit, por me kosto për ShAFP-në) dhe probabilitet të lartë (ndodhi për disa muaj). Edhe kjo është ngjyrë portokalli. Për këtë arsye, kjo nuk e ndryshon matjen e rrezikut sepse bazohet në rezultatin më të keq nga të dyja perspektivat. Efekt nuk do të kishte pasur as sikur të ishin parandaluar transfertat dhe ndikimi i mbetur të ishte konsideruar si 'i ulët', duke e bërë rrezikun të verdhë.

Strategjia e investimit

- Ky rrezik vlerësohet si me ndikim të pranishëm të mesëm-të lartë (jo të lartë për shkak të alternativave të kufizuara) dhe probabilitet të mesëm-të lartë (jo të lartë sepse kërkohet me ligj dhe jo aq i vështirë në kushtet e alternativave të kufizuara). Për këtë arsye, pikënisja e vlerësimit është se ky është një rrezik i pranishëm ngjyrë portokalli.
- Në këtë shembull një ShAFP ka një alokim më të madh në CASH se konkurrentët e tij sepse kërkesat për likuiditet nuk janë të vlerësuara si duhet, duke sjellë fitime 0,3% më të ulëta gjatë vitit. Procesi i strategjisë përgjithësisht kufizohet dhe vlerësohet si M, kurse qeverisja po ashtu vlerësohet për lënien e probabilitetit të mbetur në të mesme-të lartë dhe rrezikun ngjyrë portokalli.
- 3% humbje nga fitimet vjetore është ndikim i mbetur i mesëm-i ulët por probabiliteti është i lartë (ka ndodhur për një periudhë të konsiderueshme). Ky rrezik është ngjyrë portokalli dhe përputhet me perspektivat e tjera. Por, nëse humbja do të kishte qenë 3%, do të ishte rrezik i mbetur i kuq, ndaj dhe më keq se vlerësimet e tjera. Ky vlerësim i kuq, përveçse do të nxiste veprim të menjëhershëm, do të ngrinte edhe pyetje mbi vlerësimin e rrezikut të pranishëm.

Përdorimi i matjeve të rrezikut të mbetur

3.30 Pasi ka vlerësuar çdo rrezik në një njësi, duke marrë parasysh zbutjen që ofron qeverisja, AMF më pas duhet të vendosë reagimin e saj të menjëhershëm (hapësira më afatgjatë për komente në planifikim është mbuluar tashmë në kapitullin 2). Kjo merr parasysh:

- **Kodimin me ngjyrë të rrezikut të mbetur:** siç është rivlerësuar nga analiza e dokumentave (nëse vendimi po merret pasi problemet janë gjetur nga off-site) ose nga inspektimi në vend;

- **Drejtimin e rrezikut:** Nëse mospërputhja sugjeron se probabiliteti i mbetur i një apo më shumë rreziqeve përkatës që materializohen në njësi është më i lartë sesa probabiliteti i mbetur i vlerësuar më parë;
- **Kundërvajtje ligjore:** Nëse duket se ka prova të mjaftueshme për të marrë masa kundrejt një kundërvajtje ligjore të caktuar. Nëse rreziku është i madh sa duhet; dhe
- **Nëse ekziston një rrezik i drejtpërdrejtë për balancat e përfituesve** që kërkon veprim të vendosur, pavarësisht pozicionit ligjor.

3.31 Pikënisja është kodimi me ngjyrë në matricën e rrezikut të mbetur. Kjo duhet të kombinohet me drejtimin e lëvizjes së rrezikut. Një rrezik që është zvogëluar që nga inspektimi i mëparshëm mund të trajtohet si më pak i rëndësishëm sesa një që nuk është zvogëluar dhe, aty ku vlerësimi i rrezikut është përkeqësuar, mund të nevojitet veprim i prerë. Veprimet që duhen ndërmarrë janë mbuluar për analizën e jashtme në paragrafët 4.16-18 kurse për atë të brendshme në fund të “Analiza e brendshme, Hapi i 5-të”. Duke qenë se drejtimi i lëvizjes është një kriter vlerësimi i rëndësishëm, duhet të regjistrohet gjatë vlerësimit të secilit rrezik të mbetur dhe parimi qeverisjeje.

3.32 Pjesa e mbetur e këtij kapitulli jep disa udhëzime të përgjithshme për qeverisjen dhe zbutjen e rrezikut që AMF-ja duhet të presë për të gjetur. Shtojca 2 e këtij Manuali jep më pas udhëzime specifike për mënyrën se si mund të vlerësohet qeverisja dhe zbutja e rrezikut. Duhet të theksohet se megjithëse çdo rrezik është mbuluar, AMF-ja në praktikë nuk do të vlerësojë çdo rrezik çdo vit. Kapitulli i 2-të tregon sesi përzgjidhet nëngrupi i rreziqeve që duhet kontrolluar. Ndërkohë që metodologjia e vlerësimit përqendrohet te rreziqet dhe parimet për zbutjen ose për qeverisjen e mirë, stafi duhet të jetë vazhdimisht vigjilent për informacion që ka të bëjë me rreziqe të tjera përveç atyre që po kontrollohen. Për shembull, shqyrtimi i menaxhimit të rrezikut të depozitarët ka zbuluar faturime të tepërta nga bankat për kryerjen e transfertave nga paratë e pensione.

Matja dhe vlerësimi i qeverisjes së shoqërisë administruese

Konsiderata të përgjithshme

3.33 Për shoqëritë administruese, zakonisht qeverisja duhet të jetë pika e fillimit për vlerësimet e inspektimeve në vend të shoqërive. Kjo sepse gjetjet që kanë të bëjnë me qeverisjen mund të ndihmojnë edhe në vlerësimin sesi po kontrollohen rreziqe të caktuara, si dhe sepse vlerësimi i qeverisjes ndikon në vlerësimin e rrezikut, siç u përshkrua në sesionin e mëparshëm. Për këto arsye, vlerësimi i qeverisjes ndërmerret kryesisht si faza e parë e një inspektimi në vend (më shumë detaje i gjeni në Kapitullin e 5-të). I vetmi aktivitet off-site është mbledhja e informacionit për të ndihmuar bërjen e pyetjeve gjatë inspektimit, gjë që dokumentohet si pjesë e planifikimit të inspektimit në “Formularin e Vlerësimit dhe të Planifikimit të Mbikëqyrjes” (FPMV).

3.34 Qeverisja është një formë e zbutjes së rrezikut që i kapërcen të gjitha kategoritë e kontrollit, ndaj dhe mund të ketë ndikim te të gjitha rreziqeve aty ku një njësi e mirëqeverisur do të përpiqet të zvogëlojë rrezikun. Qeverisja e një shoqërie administruese duhet vlerësuar rregullisht gjatë çdo inspektimi në vend. Vlerësimi i qeverisjes kontribuon

në vlerësimin e zbutjes së rrezikut për çdo kategori kontrolli. Qeverisja brenda një shoqërie administruese përkufizohet si në vijim:

‘Shkalla në të cilën menaxhimi është aq kompetent sa duhet për të drejtuar Shoqërinë Administruese dhe shkalla në të cilën menaxhimi është aq aktiv dhe i përfshirë sa duhet në menaxhimin operativ dhe rezultatet, si dhe efikasiteti me të cilin pushteti i delegohet organizmave vendimmarrës.’

3.35 Qeverisja mund të ndikojë në menaxhimin e rreziqeve në dy mënyra të ndryshme:

- Ka tregues ndërkombëtare (*inter alia* nga analiza të bazës së të dhënave CEM) se qeverisja e mirë e përqendruar te anëtarët mund t’i përmirësojë të ardhurat neto nga investimet. Kjo ndodh si pasojë e **drejtimit** strategjik të trupit drejtues dhe të drejtuesve të lartë. Është e mundur që një drejtim i tillë të ndikojë edhe në rreziqe të tjera për arritjen e të ardhurave të mira nga kuotambajtësit, të cilat lindin prej strategjive të shoqërisë administruese, si marketimi, kontrolli i kostove dhe ruajtja e qëndrueshmërisë së shoqërisë.
- Qeverisja gjithashtu përfshin **mbikëqyrje** efikase nga ana e Këshillit Mbikëqyrës dhe e drejtuesve të gjithë kornizës së kontrollit të shoqërisë, duke kërkuar garanci të besueshme se kontrollet janë efikase dhe funksionojnë ashtu si duhet.

3.36 Për të ofruar drejtimin e duhur dhe për të mbajtur mbikëqyrje efikase, organizimit të shoqërisë i duhet **kapacitet** i mjaftueshëm. E thënë ndryshe, qeverisja e fortë mund të ndihmojë në zbutjen e rrezikut duke ndihmuar të sigurojë se njësia e mbikëqyrur i menaxhon rreziqet me efikasitet dhe shpejtësi, madje dhe mund të kompensojë për mungesa në kornizën e kontrollit – kështu zbut nivelin e vlerësuar të rrezikut të mbetur. Nga ana tjetër, në një shoqëri mund të dalin probleme serioze, të cilat përfundojnë në injorimin ose anashkalimin e sistemeve, të politikave dhe të kontrolleve, dhe për pasojë rritet rreziku i mbetur nëse, për shembull:

- Ka një individ tejet dominues;
- Këshilli është i manipuluar/dominuar nga stafi (i cili nuk ka të njëjtën përgjegjësi të shprehur besimi);
- Këshilli nuk është në dijeni të çdo gjëje me rëndësi që po ndodh në shoqërinë e pensioneve;
- Vendimet e Këshillit ndikohen nga konfliktet e interesave;
- Këshilli nuk i merr vendimet që duhet të marrë;
- Këshilli merr vendime që nuk bazohen në tregues objektivë.

3.37 Në vlerësimin e qeverisjes, ndihmon kur grupi mbikëqyrës është vigjilent ndaj treguesve se këto probleme mund të ndodhin. Ai duhet gjithashtu të marrë në konsideratë nëse ndonjë nga problemet e gjetura kanë përfunduar apo kanë kontribuar në dështime të menaxhimit efikas të rreziqeve të caktuara, sepse një përfundim i tillë mund t’i hapë udhë një vlerësimi më të dobët të qeverisjes ose të identifikojë punë të nevojshme për t’u kryer më tej për të verifikuar efikasitetin e menaxhimit të rreziqeve të caktuara.

Parimet e mbikëqyrjes së qeverisjes

3.38 Për të ndihmuar në vlerësimin nëse qeverisja e forcon apo e rrezikon njësinë e mbikëqyrur, qeverisja duhet të vlerësohet sipas gjashtë parimeve të specifikuara në Kutinë e 4-t më poshtë. Pjesa në vijim e këtij sesi ofron më shumë udhëzime sesi mund të matet e të vlerësohet qeverisja duke përdorur gjashtë parimet. Në Formularin e Vlerësimit dhe të Planifikimit të Mbikëqyrjes (FPMV) janë përfshirë shembuj të llojeve të pyetjeve që duhet të nxjerrin përgjigje që mundësojnë vlerësimin e rrezikut. Ky FPMV duhet të përdoret edhe për të dokumentuar vlerësimin.

Kutia 4: Gjashtë parimet e qeverisjes

1.	Organizimi dhe struktura: organizmi i Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë duhet të strukturohet në mënyrë të tillë që vendimet të mund të merren me efikasitet e në kohë, duke përfshirë gjithë brenda organizatës të gjithë që duhet të përfshihen, duke i përdorur komitetet si duhet. Duhet të merren masa për të gjitha funksionet dhe degët e nevojshme që i duhen shoqërisë. Përgjegjësitë përkatëse të anëtarëve, të drejtuesit të Këshillit Mbikëqyrës dhe të menaxherëve të tjerë të shoqërisë duhet të bëhen të qarta dhe të kuptohen drejt, ashtu si dhe ato të çdo komiteti që është ngritur dhe çdo kontraktuesi që është përdorur. Ndërmjet Këshillit dhe menaxhimit të lartë duhet të ketë drejtpeshim, në mënyrë që vendimet të mos dominohen nga një individ, një klikë apo një mendësi e vetme, si dhe të ketë një ndarje të qartë mes përgjegjësive mbikëqyrëse dhe atyre operacionale.
2.	Njohuritë, të kuptuarit dhe aftësitë: çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës duhet të përdorë njohuritë, të kuptuarit dhe aftësitë bazë që të mund ta administrojë shoqërinë si duhet dhe në interesin më të lartë të përfituesve. Këshilli, në tërësinë e tij, duhet të sigurohet se ka në dispozicion ekspertizën dhe njohuritë e plota për të menaxhuar si duhet shoqërinë. Ata duhet të sigurohen se marrin këshilla të besueshme nga ekspertët atëherë kur u duhet të mundësojnë marrjen e vendimeve të duhura. Po ashtu, ata duhet të sigurohen se i gjithë stafi dhe kontraktuesit përdorin njohuritë, të kuptuarit dhe ekspertizën e nevojshme.
3.	Përgjegjësia e mirëbesimit: anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës kanë përgjegjësi mirëbesimi ndaj mbajtësve të kuotave dhe tregojnë kujdes të veçantë ndaj interesit më të mirë të tyre. Ata duhet të marrin vendime që fokusohen në këto interesa më të mira, përtej çdo ndikimi, të vërtetë apo të perceptuar, të konfliktit të interesave. Në praktikë, kjo nënkupton se ata duhet të jenë persona të besueshëm, me integritet, dhe se proceset e vendimmarrjes së tyre duhet të jenë transparente. Përgjegjësia menaxheriale duhet ta shmangë konfliktin e interesit dhe, kur është me vend, mund të delegohet, por pa kompromentuar përgjegjësinë e Këshillit.

4.	Planifikimi strategjik dhe vendimmarrja e kujdesshme: Këshilli Mbikëqyrës duhet të miratojë planet strategjike për shoqërinë, si dhe përdorimin dhe investimin e fondit/eve të pensionit që administron. Këto plane duhet të kenë objektiva të qarta dhe të bazohen në analizë të mjaftueshme të kostove, të fitimeve dhe rreziqeve për shoqërinë dhe anëtarët e fondit të pensionit. Këshilli duhet të takohet mjaft shpesh dhe të organizojë programin e tij në mënyrë që të gjitha vendimet që duhet të merren, të merren kur të jetë e nevojshme dhe me rregull. Vendimet duhet të mbështeten nga informacion i plotë, i dhënë në kohë dhe i përshtatshëm. Ky informacion duhet të ofrohet në trajtë lehtësisht të kuptueshme dhe stafi e kontraktuesit duhet të jenë të qartë për informacionin që duhet të ofrojnë. Të gjitha vendimet që merren nga Këshilli duhet të komunikohen me efikasitet brenda njësisë dhe veprimet të ndiqen.
5.	Menaxhimi i performancës: Këshilli Mbikëqyrës duhet të sigurojë caktimin e objektivave specifike të matshme, të arritshme, të përshtatshme dhe me kohë të përcaktuar për ShAFP-në, personelin dhe kontraktuesin e saj. Ai duhet të monitorojë rregullisht performanca bazuar në këto objektiva dhe, kur performanca të mos jetë e kënaqshme, të ndërmarrë në kohë veprime riparuese. Këshilli duhet gjithashtu të vlerësojë rregullisht vetë performancën e vet. Ai duhet të sigurohet se performanca e shoqërisë dhe e fondeve i raportohet saktë dhe në mënyrë të kuptueshme aktorëve përkatës.
6.	Menaxhimi i rreziqeve dhe i kontrollit të brendshëm: Këshilli Mbikëqyrës duhet të ngrejë një strukturë për menaxhimin e rrezikut në gjithë njësinë, për të identifikuar dhe për të mbuluar rreziqet për shoqërinë dhe përfituesit. Duhet të kuptohet qartë se çfarë janë rreziqet dhe çfarë po thotë sistemi i menaxhimit të rrezikut. Struktura duhet të përfshijë një sistem të kontrollit të brendshëm brenda njësisë dhe të gjitha njësive që ndërmarrin mjaftueshëm funksione të jashtëkontraktuara, sa për të pakësuar rreziqet në një nivel të tolerueshëm. Struktura duhet gjithashtu të përfshijë raportime mjaft të shpeshta në Këshill mbi nivelin e rreziqeve kryesore dhe një kuptim të përbashkët brenda KM dhe pjesës tjetër të njësisë mbi cilat janë rreziqet më të rëndësishme dhe si duhet të menaxhohen ato. Të gjithë në njësi, përfshi dhe kontraktuesit e përdorur, duhet ta kuptojnë rolin që kanë në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve, të mbështetur nga një funksion mjaft objektiv i menaxhimit të rrezikut, përgjegjës për mbikëqyrjen e proceseve të menaxhimit të rrezikut. Këshilli duhet të marrë informacion të mjaftueshëm për punën në praktikë të kësaj strukture për ta bërë të mundur që të sigurohet plotësisht se sistemi po funksionon në të gjitha aspektet materiale, duke përdorur si duhet kontrollin e brendshëm dhe atë të jashtëm. Këshilli duhet të sigurohet se shoqëria ka mekanizma efikase për të kontrolluar nëse po kupton dhe po pajtohet me gjithë legjislacionin përkatës.

Vlerësimi i strategjive të investimeve dhe inspektimet në vend në shoqëritë administruese

Parimet e investimit

3.39 Vlerësimi i investimeve të shoqërive administruese nga ana e AMF-së nuk do të jetë asnjëherë i thjeshtë, pasi AMF-ja nuk mund të gjykojë lidhur me portofolin optimal, sepse

në fakt nuk ka masa objektive lidhur me çfarë mund të përfshijë një portofol i tillë. Në këtë kuadër, AMF drejtohet nga parimi i personit të kujdesshëm, i cili fillimisht është përcaktuar si¹²:

“Gjithçka që mund t'i kërkohet një administratori të besuar për të investuar, është që ai të sillet me besim dhe të ushtrojë diskrecion të shëndoshë. Ai duhet të vëzhgojë sesi personat e kujdesshëm, diskret dhe inteligjentë i menaxhojnë punët e tyre, jo lidhur me spekulimin, por lidhur me disponimin e përhershëm të fondeve të tyre, duke marrë parasysh të ardhurat e mundshme si dhe sigurinë e mundur të kapitalit që duhet të investohet.”

Ose, më së fundmi si¹³:

“Administratori i besuar duhet t'i ushtrojë detyrat me kujdes, aftësi, maturi dhe dilijencën që do të përdorte një person i kujdesshëm që vepron në një kapacitet të ngjashëm në drejtimin e një ndërmarrjeje me karakter dhe qëllime të njëjta.”

3.40 Këto deklarata zakonisht interpretohen të përfshijnë elementët e mëposhtëm:

- Ushtrimin nga administratori i besuar i kujdesit së duhur në të gjitha çështjet përkatëse;
- një detyrë të posaçme kujdesi për administratorin e besuar për të ushtruar aftësitë e mjaftueshme për detyrat për të cilat ata janë përgjegjës, përfshirë dhe aftësi të posaçme që ata mund të zotërojnë;
- Kur marrin në punë një këshilltar ekspert, ose një menaxher të deleguar, administratorët e besuar janë përgjegjës për të siguruar se personi i ka aktualisht aftësitë për të cilat ai/ajo mbahet, merr informacionin e nevojshëm korrekt dhe nuk është objekt i konfliktit të interesave;
- Edhe kur delegohen përgjegjësi, administratorët e besuar mbeten përgjegjës për monitorimin dhe analizimin e aktiviteteve të deleguara për t'u siguruar që ato janë realizuar siç duhet dhe me maturi. Kjo duhet të bazohet në politika dhe procedura analizimi të përcaktuara investimesh;
- Portofoli i investimeve të një fondi pensioni duhet të jetë i diversifikuar në mënyrë të përshtatshme; kjo përfshin si diversifikimin ndërmjet klasave të përshtatshme të asetëve dhe brenda çdo klasifikimi asetesh për të shmangur përqendrimin e padëshiruar të investimit;
- Asetet e përzgjedhura duhet t'i përshtaten një skeme të përshtatshme pensioni, e cila mund të interpretohet që është përzgjedhur jo për fitime spekulative afatshkurtra, por për sigurimin e kthimeve të qëndrueshme afatgjata.

3.41 Për pasojë, nën parimin e personit të matur/kujdesshëm, administratorët e besuar nuk gjykojnë nga vlerësimi prapaveprues lidhur me faktin nëse vendimet e marra prej tyre për investimet kanë qenë të suksesshme apo jo, por bazuar në faktin nëse ata kanë ndjekur një proces të arsyeshëm për arritjen e vendimeve përkatëse. AMF-ja punon mbështetur në hipotezën se nëse një shoqëri administruese zbaton proceset e praktikave më të mira për menaxhimin e investimeve të veta, atëherë portofoli pasues nuk do të jetë

¹² Harvard College k.Amory, 1830 USA

¹³Ky përkufizim dhe shumë të tjerë që vijojnë më poshtë janë marrë nga: Standardi i “rregullit të personit të matur” për investimin e asetëve të fondit të pensioneve” Russell Galer, OECD, nëntor 2002

thelbësisht nën-optimal. Thënë ndryshe, shoqëria administruese duhet të ketë bërë çdo gjë që pritet prej saj për ushtrimin e rolit të besimit (personit të matur/kujdesshëm) lidhur me investimet e fondeve. Megjithatë, AMF-ja mund të jetë në gjendje të kapë disa ndërhyrje negative lidhur me zbatimin e "personit të matur/kujdesshëm" që mund të përdoren për të sfiduar shoqëritë administruese në rast se një portofol fondi duket se nuk është mjaftueshmërisht i diversifikuar, ose objekt spekulimesh, duke përdorur analizat që shqyrtohen më tej në Kreun 4.

3.42 Proceset e menaxhimit që pritet të ofrojnë përputhshmëri me parimin e personit të kujdesshëm paraqiten në një grup parimesh mbikëqyrëse që përdoren për proceset e vlerësimit (Kutia 5 më poshtë). Këto vendosen në dy zëra që u korrespondojnë dy kategorive të rrezikut të investimeve në kuadrin e rrezikut të AMF-së, të cilat janë:

- Shoqëria administruese bën një ndarje strategjike asetesh, ose ka një strategji për trajtimin e shpërndarjes së asetëve; që nuk mund të justifikojë duke mbajtur parasysh çfarë dihet rreth rrezikut dhe të ardhurave nga klasat e disponueshme të asetëve–strategjia e rrezikut të investimit;
- Shoqëria administruese e zbaton strategjinë në mënyrë të tillë që ajo devijon në mënyrë të paarsyeshme nga synimi, ose i ekspozon fondet ndaj rrezikut të padëshiruar– investim taktik/ kontrolli i rrezikut.

Kutia 5: Parimet e menaxhimit të rrezikut të investimeve	
	Planifikimi strategjik
1.	Përgjegjësia - Këshilli Mbikëqyrës duhet të dijë se ai ka përgjegjësinë përfundimtare për strategjinë e investimeve të fondit (fondeve) të pensionit që ai menaxhon. Ai duhet të përqendrohet tek interesat afatgjatë të personave që kanë kuotat e fondit të pensionit, në përputhje me atë që do të bënte një person i kujdesshëm lidhur me investimet e parashikuara për të sjellë të ardhura kur del në pension. Ai mund të marrë këshilla për strategjinë dhe portofolin nga një komitet investimesh dhe funksion i menaxhimit të rrezikut, por kjo gjë nuk i heq atij përgjegjëshmërinë përfundimtare.
2.	Ekspertiza – prandaj, të gjithë anëtarët e këshillit duhet të kenë kuptueshmëri të mjaftueshme të investimeve për të mundësuar vendime plotësisht të informuara për t'u ndërmarrë në strategji, me trajnimin e duhur të dhënë sipas nevojës. Në veçanti, ata duhet të jenë në gjendje të kuptojnë karakteristikat e të gjitha klasave të asetëve të përdorura, strategjinë e fondit dhe dokumentet dhe raportet e kontrollit për ecurinë e investimeve dhe rrezikun e tyre; dhe të dinë se kur duhet të merren vendime, kur të kërkohen këshilla për këto vendime, dhe të jenë në gjendje të marrin parasysh në mënyrë kritike këshillat. Personat që marrin vendime për investimet, duke përfshirë çdo komitet investimesh duhet të kenë një nivel të lartë njohurish ose të marrin këshilla të pavarura për të përmbushur boshllëqet në atë ekspertizë. Ata duhet të kuptojnë se çfarë i drejton kostot e strategjisë së investimeve dhe kur këto kosto shtojnë vlerën neto të kthimit nga investimi dhe kur nuk japin vlerën më të mirë për paratë e investuara.
3.	Analiza – strategjia afatgjatë për investimin e asetëve në fondin e pensionit duhet të mbështetet tek analiza e performancës dhe rreziqeve të instrumenteve financiarë në

	portofol, të cilët mund të përfshihen në portofol në mënyrë të arsyeshme. Këtu duhet të përfshihet analiza e opsioneve nën skenarë të ndryshëm të rrezikut dhe të kthimit të një niveli sofistikimi që është i përshtatshëm për portofolin. Qoftë këshilli mbikëqyrës ose komiteti i tij i investimeve duhet të specifikojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike analizat.
4.	Objektivi- Këshilli mbikëqyrës duhet të miratojë një objektiv (të brendshëm) për fondin e pensioneve kundrejt të cilit strategjia e tij mund të optimizohet dhe të vlerësohet performanca e tij. Ai duhet të marrë parasysh natyrën afatgjatë të një fondi pensioni dhe qëllimin e tij për t'iu dhënë të ardhura anëtarëve të vet kur këta të fundit të dalin në pension. Kjo ka implikime të rëndësishme për horizontin e investimeve dhe karakteristikat e tjera të pjesëmarrësve në fond, si dhe karakteristikat e klasave të aseteve ku fondi mund të investohet në mënyrë të arsyeshme. Objektivi duhet të jetë afat gjatë, në varësi të kohëzgjatjes së anëtarëve të fondit dhe i matshëm në varësi të pengesave të tregjeve në të cilët operon fondi. Ai mund të jetë vendosur në lidhje me masat përkatëse ekonomike ose të tregut në mungesë të instrumentave që mundësojnë të synohet kthimi absolut.
5.	Dokumentimi i strategjisë së investimit –strategjia duhet të dokumentohet në një nivel detajesh të përshtatshëm për kompleksitetin e portofolit dhe të mbulojë një periudhë prej të paktën tre vitesh të ardhshëm. Dokumentimi i strategjisë duhet të regjistrojë strategjinë e fondit, menaxhimin e rrezikut dhe përqasjen e kontrollit me analizën mbështetëse. Në thelb, dokumentimi i strategjisë duhet të shprehë në mënyrë të qartë çfarë, si dhe pse. Ai duhet të vendosë (në përputhje me ligjin) shpërndarjen e aseteve strategjike me amplituda të rëndësishme për klasa të ndryshme të aseteve dhe një portofol referues, i cili mund të përcaktojë nëse vendimet e përditshme për investimet e kanë zbatuar strategjinë në mënyrën e duhur. Në qoftë se strategjia do të evoluojë me kalimin e kohës, shpërndarja duhet të tregojë drejtimin e synuar dhe ritmin e tranzicionit. Strategjia e përgjithshme duhet të rishikohet dhe të miratohet të paktën çdo vit nga këshilli mbikëqyrës në kuadrin e shqyrtimit të performancës dhe të analizës së tregut, të raportuar në këshilla formale nga Komiteti i Investimeve, në qoftë se ekziston një i tillë ose menaxheri i investimeve dhe menaxheri i rrezikut. Këshilli Mbikëqyrës në çdo rast duhet të miratojë të gjitha vendimet, të cilat përfshijnë një devijim ose ndryshim në strategji.
6.	Burimet e investimit – aktiviteti investues i shoqërisë administruese nuk duhet të kufizohet padrejtësisht nga shqetësime në lidhje me kostot e transaksioneve, të cilat nuk duhet të parandalojnë ribalancimin ose tregtitë e tjera me kosto efektive, kur është e justifikuar.
7.	Analiza e performancës – Këshilli Mbikëqyrës duhet të verifikojë të paktën çdo vit që investimi është në përputhje me strategjinë. Ata mund të delegojnë rolin e shqyrtimit të performancës së portofolit gjatë vitit në një komitet investimesh, i cili duhet të raportojë për të, të paktën një herë në vit te këshilli mbikëqyrës, i cili përfundimisht mbetet përgjegjës për performancën. Portofoli dhe, nëse është e nevojshme, strategjia, duhet të modifikohen për të reflektuar mësimet e nxjerra nga performanca e fondit.


	Analizat e performancës duhet të mbulojnë kostot e strategjisë dhe të identifikojnë se ku këto kosto shtojnë vlerën neto të kthimit për anëtarët, në këtë mënyrë kanë vlerë, dhe kur kostot nuk janë të justifikuar apo nuk ka gjasa të japin vlerë të shtuar për anëtarët.
	Kontrolli i rrezikut të investimit
8.	Organizimi i funksionit të investimeve – Këshilli Mbikëqyrës ose komiteti i investimeve, në emër të tyre, duhet të sigurojnë që ekziston një ndarje e përshtatshme e funksioneve të zyrës kryesore të kontaktit, zyrës së mesme dhe zyrës mbështetëse në mënyrë që të minimizojnë rrezikun e aktivitetit të paparashikuar apo të pamatur. Mund të ketë delegim vendimmarrjeje të mjaftueshëm në zyrën kryesore të kontaktit (zyrën e përparme) për të mundësuar përdorimin e përditshëm efektiv të ekspertizës së menaxherit të investimeve, por pa hequr llogaridhënien e këshillit mbikëqyrës dhe komitetit të investimeve. Këshilli mbikëqyrës duhet të sigurojë që të gjithë menaxherët e investimeve të jenë emëruar në përputhje me kriteret e duhura, duke përfshirë kërkesat për njohuri dhe përvojë, dhe se vlerësohet performanca dhe veprimet e marra prej tyre, dhe që merren masat e nevojshme për performancë jo të kënaqshme.
9.	Kontrolli i vendimeve të investimit - Komiteti i Investimeve ose menaxheri i investimeve, të këshilluar nga menaxheri i rrezikut, duhet të autorizojnë të gjithë vendimet e investimeve, në përputhje me strategjinë e miratuar, e cila specifikon shkallën e gjykitimit për çdo klasë asetesh (duke përfshirë kohëzgjatjen e bondit). Duhet të ketë monitorim ditor të pavarur nga menaxheri i investimeve, lidhur me përputhshmërinë për çdo delegim dhe shkeljet duhet t'i raportohen menjëherë komitetit të investimeve apo këshillit mbikëqyrës, si dhe mjetet efektive në përputhje me politikat e fondit.
10.	Menaxhimi i rrezikut – rreziqet në portofol dhe rreziqet që përfshihen nga ndryshimet e portofolit, duhet të analizohen duke përdorur mjetet e duhura për rreziqet e natyrshme në çdo klasë asetesh, që i raportohen periodikisht komitetit të investimeve dhe menaxhohen në mënyrë që të shmangin ekspozimin më të madh se sa parashikimi në Deklaratën e Parimeve të Investimeve apo në vendimet e komitetit të investimeve. Rreziqet që mund të kenë nevojë për t'u analizuar, në varësi të përbërjes së portofolit, përfshijnë rrezikun e kredisë, rrezikun e paqëndrueshmërisë së tregut, rrezikun e normës së interesit, rreziku nga inflacioni, rrezikun e likuiditetit dhe rrezikun nga kursi i këmbimit.
11.	Vlerësimi – Investimet duhet të vlerësohen në mënyrë të drejtë. Për këtë qëllim, ato duhet të vlerësohen në përputhje me praktikën më të mira të vlerësimit të aseteve, siç rekomandohet nga AMF-ja ose në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, aplikuar sipas rastit në varësi të strukturës së likuiditetit të fondit. Praktikën e vlerësimit duhet të pasqyrojnë realitetin themelor të aseteve dhe, për aq sa është e mundur, të jenë konsistente në të gjitha fondet e pensionit vullnetar. Në mënyrë të veçantë, kur për qëllime të vlerësimit përdoret një model, praktikën e vlerësimit duhet të projektohen në mënyrë të tillë që minimizojnë mundësitë për arbitrazh që nuk reflektojnë realitetin. Fondi nuk duhet të marrë përsipër veprimtari tregtare, qëllimi kryesor i të cilave është të nxjerrë fitim nga një model apo teknikë vlerësimi.

12.	Transparenca dhe raportimi publik – duhet të verifikohet saktësia e raporteve të brendshme të portofolit dhe performanca e tij. Këshilli mbikëqyrës ose komiteti i investimeve, që veprojnë në emër të tyre, duhet të sigurojnë që komunikimet me anëtarët e fondit, AMF-në dhe palët e tjera përkatëse në lidhje me përbërjen, në lidhje me performancën dhe rreziqet e fondit të pensionit realizohen në përputhje me ligjin, janë të hapura, të ndershme, të drejta dhe sa më shumë të jetë e mundur të kuptueshme nga ana e audiencës së synuar.

3.43 Mënyra në të cilën këto pesë parime përkojnë me njëra-tjetrën ilustrohet në Figurën 16 më poshtë.

Figura 16: Ilustrim i thjeshtësuar i proceseve të investimit

Legjenda: e verdha – strategjike; blu – taktike/kontroll; e gjelbra – të dyja



3.44 Në thelb, Figura 21 tregon se:

- Pika e nisjes për një strategji të mirë investimesh është një analizë e plotë e performancës në të shkuarën dhe e opsioneve alternative, duke marrë parasysh shumë skenarë, rrezikun dhe kthimin/interesin;
- Duhet të bëhet një rishikim i analizës dhe nëse është e nevojshme një rishikim i objektivit afatgjatë të fondit;
- Duhet të ketë një strategji për arritjen e objektivit dhe minimizimin e rrezikut. Procesi i strategjisë kulminon me përgatitjen e një dokumenti, (deklarata e parimeve të investimeve), ose të disa dokumenteve, ku përfshihet një ndarje strategjike fondesh dhe portofoli për treguesit krahasimorë (benchmark portfolio/portofoli i referimit) për qëllime kontrolli;
- Më pas, një dokument më specifik dhe më afatshkurtër (mandat) përdoret për të autorizuar tregtimin, i cili çon në vlerësimin dhe regjistrimin e aseteve;
- Më pas matet dhe analizohet performanca. Bëhet një kontroll nga zyra e ndërmjetme për kontrollin e aktivitetit dhe të performancës përkundrejt portofolit të treguesve krahasimorë (benchmark portfolio) dhe dokumentit të kontrollit;
- Duhet të ketë po ashtu dhe një cikël feedback-u strategjik, në të cilin këshilli mbikëqyrës i mbështetur nga njësia e rishikimit, e rishikon performancën e strategjisë.

3.45 Ka korrespondencë të ngushtë ndërmjet parimeve të investimit dhe parimeve të qeverisjes dhe si rrjedhojë pyetjet e intervistës të lidhura me parimet e investimit duhet të shërbejnë dhe për të testuar parimet përkatëse të qeverisjes dhe anasjelltas. Kjo është veçanërisht e vërtetë për parimet e investimit 1-7, të cilat mbulojnë çështjet më të rëndësishme strategjike për një organizatë menaxhimi fondesh, të tillë si fondi i pensionit.

Kështu, gjatë vlerësimit të rrezikut të strategjisë së investimit, vlerësimi i 7 parimeve duhet të kombinohet me të gjitha 6 parimet e qeverisjes, siç tregohet në paragrafët 3.18-21 dhe Figura 12 më sipër. Jo të gjitha parimet e qeverisjes janë të rëndësishme për rrezikun e kontrollit të investimeve, por Parimi 6 është shumë i rëndësishëm.

Vlerësimi i rreziqeve operacionale në shoqërinë administruese

3.46 Rreziqet operacionale janë trajtuar në një seksion të veçantë të këtij Manuali, sepse duhet të ketë gjithmonë një dëshirë të përbashkët ndërmjet shoqërive administruese dhe AMF-së për të minimizuar rreziqet. Në qoftë se një rrezik materializohet ai ka tendencë të përbëjë një problem më të madh për shoqërinë sesa për AMF-në, pasi shoqëria duhet të paguajë për të korrigjuar problemin. Për këtë arsye, AMF-ja thjesht duhet të kërkojë konfirmimin se shoqëritë administruese e kuptojnë se çfarë janë masat e duhura për të zbutur rreziqet dhe të kontrollojë aplikimin e tyre, me supozimin se edhe shoqëritë janë të etura për të siguruar zbutjen e rreziqeve.

3.47 Qasja standarde për vlerësimin e rreziqeve operacionale është si më poshtë:

- Sigurohuni që sistemi ka për qëllim t'i kontrollojë rreziqet, nëpërmjet intervistave dhe dokumentacionit të shqyrtuar;
- Vlerësoni përshtatshmërinë e sistemit dhe kontrollet e tij për të zbutur rrezikun;
- Testoni sistemin për të parë nëse kontrollet e tij funksionojnë në praktikë.

3.48 Administratori është përgjegjës për të siguruar kontrollin për rreziqet operacionale dhe se ai / ajo dhe stafi i tyre janë në qendër të vëmendjes së vlerësimit. Mbikëqyrja e Këshillit Mbikëqyrës është e rëndësishme si mjet për të kontrolluar se administratori dhe menaxherët e tjerë i kryejnë në mënyrë efektive përgjegjësitë e tyre të kontrollit, por vlerësohet si pjesë e vlerësimit të qeverisjes (parimi 6). Vlerësimi i parimit të qeverisjes 6 është i kombinuar me vlerësimin e secilit prej rreziqeve operacionale për të siguruar një vlerësim të plotë të çdo rreziku operacional, siç shpjegohet në paragrafët 3.17-24 dhe Figurën 13 më sipër.

3.49 Kontrollet që AMF-ja pret t'i shohë të aplikuara lidhur me zbutjen e çdo rreziku operacional janë përmbledhur në parimet mbikëqyrëse në Kutinë 6, më poshtë, të cilat do të përdoren si kritere vlerësuese për pesë kategoritë e identifikuara të rrezikut operacional (por me të dhëna veçmas për IT-në dhe sigurinë e të dhënave për lehtësi referimi).

Kutia 6: Parimet e zbutjes së rrezikut operacional	
	Kontributet për tu marrë
1.	Shoqëria administruese duhet të sigurojë marrëveshjen e punëdhënësve që sponsorizojnë fonde pensioni profesional [pune] për të siguruar një program kontributesh, të përditësuar të paktën çdo muaj, dhe për t'i paguar këto kontribute në fond brenda një kuadri kohor të rënë dakord, në përputhje me ligjin. Ajo duhet të sigurohet po ashtu se këto kërkesa respektohen dhe se merren masat e nevojshme në përpjesëtim me kohëzgjatjen e vonësve të pagesave.

2.	Duhet të ketë procedura efektive për kontabilitet korrekt për të gjitha kontributet e marra në mënyrë që numri i njësive që mban një individ të përditësohet në mënyrë precize dhe të saktë dhe të ndryshohet përkundrejt të ardhurave të kontributeve të marra dhe, për aq sa është e mundur, të arkëtueshme. Këshilli mbikëqyrës dhe Administratori duhet të sigurohen siç duhet që këto procedura po funksionojnë në mënyrë efektive.
	Mbajtja e të dhënave
3.	Duhet të ketë procedura efektive për vlerësimin e përditshëm të njësive të kontabilitetit, duke marrë parasysh të dhënat e shoqërisë administruese lidhur me vlerat e aseteve, zbritjen e tarifave të menaxhimit dhe numrin e njësive të kontabilitetit. Përlllogaritja duhet të bëhet përditë dhe duhet të përkojë me fondin e depozitës dhe papërputhshmëritë duhet të ndiqen sa më shpejt të jetë e mundur, ose në rast se jo, duhet të përshkallëzohen brenda shoqërisë administruese dhe AMFS-së. Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori duhet të sigurohen siç duhet se këto procedura po funksionojnë siç duhet.
4.	Duhet të ketë procedura për përditësimin e të dhënave të mbajtësit të njësive në varësi të informacionit që ata japin, dhe për inkurajimin e mbajtësve të njësive ose të punëdhënësve për ofrimin e përditësimeve, kur ato janë të disponueshme.
	IT-ja dhe siguria e të dhënave
5.	Duhet të ketë kontrolle efektive mbi të gjitha format e aksesit nga stafi, ose në ambientet e kompanisë në sistemin e Informacionit dhe Teknologjisë (IT) që përdoret për fondin e pensioneve. Stafi i shoqërisë duhet të ketë leje për të pasur akses vetëm tek të dhënat ose bazat e të dhënave të cilat u nevojiten për ushtrimin e funksioneve përkatëse dhe duhet të ketë kontrolle për të parandaluar ose për të zbuluar të gjitha akseset e paautorizuara. Strukturat drejtuese të shoqërisë duhet të jenë në gjendje të jenë të sigurta që këto kontrolle janë efektive për parandalimin e korrupsionit me të dhënat ose programin e të dhënave të fondit.
6.	Strukturat drejtuese të shoqërisë duhet të sigurohen se ndryshimet në pjesën e hardware-it dhe software-it të IT-së të përdoren për të ruajtur ose për të testuar të dhënat e fondit, përpara se të përdoren drejtpërdrejt, ose për të parandaluar korrupsionin e të dhënave ose humbjen e shërbimit.
7.	Strukturat drejtuese të shoqërisë duhet të sigurohen se ekzistojnë politika për mbrojtjen e të dhënave të cilat janë në përputhje me dispozitat ligjore, të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, të cilat aplikohen nga çdokush që ka akses në të dhënat e fondit dhe që janë të mjaftueshme për të qartësuar rrethanat në të cilat mund të bëhen të ditura të dhënat, si dhe specifikohet se kush mund t'i japë këto të dhëna dhe me çfarë autoriteti. Ato duhet të marrin masa efektive për t'u siguruar se këto politika kuptohen dhe aplikohen nga i gjithë stafi i shoqërisë dhe nga ofruesit përkatës të shërbimeve.
8.	Strukturat drejtuese të shoqërisë duhet të sigurohen se shërbimi i IT-së që i ofrohet fondit është i mjaftueshëm për të siguruar që funksionet e tij mund të kryhen në kohën e duhur dhe në mënyrë efektive. Në veçanti, ato duhet të sigurohen se ka një marrëveshje në nivel shërbimi me shoqërinë mëmë për të gjitha shërbimet e IT-së dhe të të dhënave që ofrohen prej tyre, duke specifikuar standardet e cilësisë, kontrollet e sigurisë, organizimet për menaxhimin e rrezikut dhe organizimet në rastet kur shkelet

	marrëveshja. Administratori duhet të kontrollojë përputhshmërinë dhe duhet t'i raportojë këshillit mbikëqyrës për rastet e papëputhshmërisë.
9.	Strukturat drejtuese të shoqërisë duhet të sigurohen rregullisht që programi i IT-së dhe çdo shërbim që ofrohet nga shoqëria mëmë janë objekt i organizimeve të sigurisë që janë të mjaftueshme për parandalimin e humbjes apo korrupsionin, ose aksesin e paautorizuar tek të dhënat. Administratori duhet të informohet menjëherë për shkeljet e sigurisë të zbuluara nga auditimet e brendshme ose raporte të tjera që verifikojnë nivelin e sigurisë.
	Vazhdimësia e biznesit dhe e IT-së
10.	Struktura drejtuese e shoqërisë duhet të sigurohet se ekziston një plan për vijimësinë e biznesit që ka dispozita të mjaftueshme për vijimësinë e shërbimeve kritike të biznesit dhe për rimarrjen e shërbimeve të tjera në rast të një incidenti serioz, ose të një fatkeqësie në ambientet e biznesit, ose të IT-së së përdorur nga shoqëria administruese. Organizimet duhet të përfshijnë disponueshmërinë e ambienteve të largëta dhe ruajtje të të dhënave të IT-së në ambiente në distancë. Ajo duhet të testojë që organizimet për vijimësinë testohen në mënyrë të vazhdueshme dhe janë në përputhje me planet për menaxhimin e rrezikut ose funksioneve të tjera pavarësisht nga menaxhimi operativ.
	Sigurimi i asetëve
11.	Struktura drejtuese e shoqërisë duhet të sigurohet se ka sisteme efektive për të siguruar që transfertat financiare jashtë fondit të pensionit autorizohen vetëm atëherë kur ka një arsye të qenësishme për transaksionin dhe kur përfituesi ka të drejtë të marrë përfitime financiare në pikëpamjen kontraktuale dhe ligjore. Ky kontroll duhet të aplikohet për instrumentet e <i>cash</i> -it dhe instrumentet financiare; funksioni i investimit dhe funksioni i pagesave. Depozitari duhet të mbahet i informuar lidhur me personat që mund t'i autorizojnë transaksione të tilla, të cilat janë të paautorizuara ose të paligjshme për këshillin mbikëqyrës dhe auditin e brendshëm.
12.	Administratori duhet të sigurohet që ndiqen problemet e pajtimit që hasen për t'u siguruar se ato nuk përbëjnë kërcënim për sigurinë e asetëve.
13.	Administratori duhet të sigurohet se ka ndërgjegjësim të mjaftueshëm kundër mashtrimit për të gjitha funksionet, qofshin ato të brendshme ose të kontraktuara dhe se kontrollet që janë të rëndësishme për parandalimin ose identifikimin e mashtrimit testohen në mënyrë të rregullt dhe se merren masa ndreqëse të menjëhershme në rast se konstatohen mangësi në kontrole. Kjo siguri duhet të mbështetet dhe të ofrohet nga auditet e brendshme.
	Pagesat nga fondet/likuiditeti
14.	Duhet të ketë procedura efektive për vlerësimin e kërkesave për pagesa ndaj kuota mbajtësve , duke përfshirë shumën e përfshirë dhe të drejtat e palës së paguar, e cila nuk duhet të vonojë ekzekutimin e pagesës në mënyrë domethënëse. Këshilli mbikëqyrës duhet të sigurohet në mënyrë periodike që nuk ka vonesa të paarsyeshme dhe duhet të njoftohet për dështimet e konstatuara për kontroll.

15.	Shoqëria duhet të administrojë likuiditetin e fondit dhe, aty ku është e nevojshme të administrojë datat e pagesave, në mënyrë që të sigurojë se kufizimet e likuiditetit nuk vonojnë pagesat nga fondi më shumë sesa 30 ditë sipas ligjit.
-----	---

3.50 Teksti në Shtojcën 2 të këtij Manuali shtrihet për çështjet specifike lidhur me secilin prej rreziqeve dhe pasohet nga një seksion më i përgjithshëm për rrezikun mbi kontraktimin, i cili del në pah kur ndonjëri nga funksionet e përfshira jepet me kontraktim jashtë, mbase me shumë të ngjarë tek shoqëria mëmë.

Vlerësimi i rreziqeve të biznesit në shoqëritë administruese

3.51 Rreziqet e biznesit quhen të tilla në këtë Manual pasi ato lidhen me mënyrën sesi Këshilli Mbikëqyrës e realizon punën dhe për shkak se ato dalin nga vendime të qëllimshme të bëra për të çuar përpara interesat e shoqërisë administruese, ose të shoqërisë mëmë. Për pasojë, çdo rrezik mund të ndikohet nga politikat dhe strategjitë e shoqërisë, si dhe nga dështimet për t'i kontrolluar ato. Për këtë arsye, vlerësimi i të gjitha parimeve të qeverisjes lidhet me vlerësimin e këtyre rreziqeve dhe nevojën për t'u kombinuar me vlerësimin e parimeve mbikëqyrëse të lidhura me këto rreziqe, siç u shpjegua më parë në këtë kapitull. Parimet mbikëqyrëse për menaxhimin e rreziqeve të biznesit jepen në Kutinë 7 më poshtë. Shtojca 2 jep detaje të mëtejshme për vlerësimin e tyre.

Kutia 7: Parimet e zbatjes së rreziqeve të biznesit	
	Kryerja e biznesit (shitja e keqe)
1.	Politikat – politikat e këshillit mbikëqyrës të lidhura me shitjet dhe aktivitetin e marketingut duhet të kërkojnë që shitjet dhe aktiviteti i marketingut të jenë etike, të vërteta dhe të shmangin vendosjen e ndikimit të papërshtatshëm mbi anëtarët e ardhshëm ose aktualë të fondit, ose punëdhënësve të tyre, për tu kontraktuar në fond, ose për t'i çorientuar ata për të hyrë në një kontratë që nuk është në interesin e tyre më të mirë.
2.	Përputhshmëria me politikat – këshilli mbikëqyrës duhet të sigurojë operimin e sistemeve efektive për të siguruar përputhshmërinë me politikat e veta dhe për të parandaluar dhe zbuluar sjelljen e padenjë në këtë aspekt. Kjo duhet të jetë situata dhe kur shitjet ose aktiviteti i marketingut ndërmerren nga shoqëritë mëmë, ose nga palë të treta, rast në të cilin dispozita për kontroll në emër të shoqërisë administruese mund të bëhet në marrëveshjen në nivel shërbimi, ose në kontratë.
3.	Stafi/agjentët e shitjes – këshilli mbikëqyrës duhet të sigurohet që sistemet funksionojnë dhe se gjatë këtij procesi respektohen kërkesat përkatëse ligjore të lidhur me miratimin, kualifikimin dhe sjelljen e stafit/agjentëve të shitjes dhe se bëhet mbikëqyrja e materialeve të shitjes në përputhje me AMF-në. Në veçanti duhet të ketë organizime efektive rekrutimi, trajnimi dhe organizative për t'u siguruar se stafi/agjentët e shitjes janë të përshtatshëm për punën dhe se e kuptojnë se çfarë kërkohet prej tyre

	dhe të gjitha detajet përkatëse rreth produkteve që ata shesin.
4.	Regjistrimi - Administratori duhet të sigurohet se ka sisteme efektive për regjistrimin korrekt të kontribuesve të rinj, përfshirë dhe një kontroll se të gjitha dokumentet e nevojshme ligjore janë nënshkruar.
	Zgjedhja e pagesës
5.	Informacion për kontribuesit – këshilli i mbikëqyrjes duhet të kontrollojë që mënyra sesi shpjegohen organizimet për pagesën për të dalë nga sistemi i pensionit për kontribuesit është në kohën e duhur, e saktë dhe ofron një vlerësim të balancuar të rreziqeve dhe përfitimeve të secilit opsion. Shpjegimet duhet të paraqiten në mënyrë të tillë që të jetë kuptuar drejt informacioni.
6.	Produktet nga tërheqja e fondeve nga një llogari në një tjetër – këshilli mbikëqyrës duhet të miratojë një politikë për projektimin dhe shitjen e produkteve të tilla nga fondi i pensionit për personat e dalë në pension dhe duhet të sigurojë që këto produkte kanë vlerë të mirë. Kjo politikë do të duhet të rishikohet paralelisht me zhvillimin e tregut me kalimin e kohës dhe të vihen në dispozicion produkte të përmirësuara për ofrimin e të ardhurave nga dalja në pension dhe të lehtësohen përkundrejt rrezikut të jetëgjatësisë. Në rastet kur nuk janë të disponueshme pagesat vjetore, mund të përdoren dhe parimet e kalimeve të rregulluara në faza për nivele të ngjashme interesash dhe eksperiencë për koeficientin e vdekshmërisë; ndërkohë mund të përfshihet një opsion për gjenerimin e të ardhurave si <i>default(periodike)</i> më shumë sesa opsioni i shumës fikse.
	Qëndrueshmëria e shoqërisë administruese
7.	Plani i biznesit – këshilli mbikëqyrës duhet të ketë një plan biznesi, me të paktën tre vite kohëzgjatje, ku identifikohet sesi si do të rritet biznesi i tij dhe sesi do të ruhet ose arrihet një pozicion financiar që është i qëndrueshëm në kuadrin më afatgjatë. Ai duhet të rishikojë në mënyrë periodike progresin përkundrejt objektivave dhe qëllimeve dhe duhet të përgjigjet përkatësisht, duke përfshirë dhe marrjen e masave për të rritur kostot e biznesit ose të kontrollit. Aty ku zhvillimi i fondit është një element i rëndësishëm në plan, duhet të ekzistojë një strategji përvetësimi që tregon se si duhet të përhapet pjesëmarrja, me synime.
8.	Mjaftueshmëria e kapitalit – këshilli mbikëqyrës duhet të sigurohet që shoqëria administruese ka kapital të mjaftueshëm, i mbajtur në formë të mjaftueshme likuiditeti, për t'u përballur me të gjitha angazhimet e pritshme ose të mundshme financiare, të mbështetur nga një sistem efektiv buxhetimi dhe kontabiliteti për të lejuar identifikimin e plotë të këtyre angazhimeve. Në çdo rast kapitali i shoqërisë duhet të përmbushë kërkesat ligjore.
9.	Rreziqet ndaj qëndrueshmërisë – këshilli mbikëqyrës duhet të jetë i ndërgjegjshëm për rreziqet me të cilat haset plani i biznesit dhe qëndrueshmëria financiare, përfshirë dhe çështjet në gjykata, dhe duhet t'i monitorojë ato, si dhe të marrë masat e nevojshme lehtësuese, duke marrë parasysh kapitalin që ka dhe mbështetjen financiare dhe mbështetje të tjera për të cilat ka arsye të mira për të besuar se vijnë nga shoqëria mëmë.

	Kostot dhe tarifat
10.	Kostot që i ngarkohen kontribuesve – Shoqëria administruese duhet të kërkojë që t'i kryejë me efikasitet operacionet e veta dhe pa kosto shtesë nga shoqëria mëmë, në mënyrë që kostot të jenë në kontroll të ngushtë dhe duhet të shqyrtojë mundësinë për ulje të tarifave për kontribuesit kur është e mundur.

Vlerësimi i zbutjes së rrezikut të depozitarëve

3.52 Kërkesa për depozitarët e pavarur është një garanci thelbësore mbi asetet e kontribuesve, duke e ulur ndjeshëm mundësinë që asetet të keqpërvetësohen, ose të investohen keq nga shoqëritë e administrimit. Megjithatë, në mënyrë të pashmangshme, futja e një subjekti tjetër në sistem krijon rreziqe të reja, pavarësisht se mund të ulë rrezikun e përgjithshëm në sistem. Për pasojë, vlerësimi i depozitarëve përqendrohet si tek zbatimi efektiv i kontrolleve mbi shoqërinë e administrimit prej tyre, si dhe tek lehtësimi i rreziqeve specifike depozituese. Në përgjithësi, të gjitha këto rreziqe të marra së bashku përbëjnë një kategori të vetme rreziku. Në kombinimin e parimeve për lehtësimin e rrezikut tek depozitarët (Kutia 9 më poshtë) vëmendje e veçantë i duhet t'i kushtohet shmangies së mesatarizimit mekanik të vlerësimeve. Dështimi përkundrajt një parimi, nëse është mjaftueshëm serioz, mund të shkatërrojë të gjithë vlerën e pasjes së një depozitari.

3.53 Duhet të shënohet se verifikimet në depozitar sigurojnë komoditet të rëndësishëm në lidhje me disa rreziqe operacionale të shoqërisë administruese, të cilat mund të mundësojnë më pak punë për t'u ndërmarrë duke inspektuar ato rreziqe, si vijon:

- **Kontribute të vonuara/munguara:** verifikimet e depozitarit nëse kontributet janë marrë nga punëdhënësit me fonde profesionale në përputhje me skemën e kontributeve, e cila siguron një paraqitje të këtyre proceseve në shoqërinë administruese.
- **Sigurimi i aseteve ShAFP:** rakordimi ditor i depozitarit kur krahasohet me atë të shoqërisë administruese do të nxirrte në dukje lëvizje të parregullta në asete.
- **Kontrolli i rrezikut të investimeve:** verifikimi i tregtimit të titujve nga ana e depozitarit kundër legjislacionit dhe strategjisë së investimeve mund të zbulojë aktivitet të parregullt investimi.
- **Vazhdimësia e Biznesit/IT:** ekzistenca e kontribuesve dhe regjistrimeve që lidhen me asetet në depozitar e bën më pak të mundur që një problem në shoqërinë administruese të rezultojë në humbje serioze të dhënash.

3.54 Prandaj është e rëndësishme që AMF-ja të mbajë një dialog të rregullt me depozitarët, si dhe mbikëqyrësit e tyre bankarë, për të marrë paralajmërim të hershëm për problemet në një shoqëri administrimi dhe për të dhënë siguri ndërmjet inspektimeve. Udhëzime të mëtejshme për vlerësimin janë përfshirë në Shtojcën 2 të këtij Manuali.

Kutia 9: Parimet e zbutjes së rrezikut të depozitarëve	
1.	Menaxhimi i lartë përgjegjës për funksionet depozitare duhet të pranojë se ka detyrën e besuar të kujdesjes ndaj kuotambajtësve dhe duhet të veprojë vetëm në interes të tyre, për të cilët ofron shërbime depozituese.
2.	Depozitari duhet të ketë sisteme efektive për regjistrimin dhe përpunimin e të gjitha transaksioneve financiare të lidhura me fondet e pensionit dhe të investimit. Këto procese duhet të dokumentohen në mënyrë të tillë që mund të konsultohen lehtë nga stafi. Mbi këto procese duhet të ushtrohen kontrolle efektive për të parandaluar ose zbuluar gabimet dhe parregullsitë. Sistemet e tij duhet të mbështeten nga teknologji informacioni dhe komunikimi të mjaftueshme për këtë qëllim. Në thelb, çdo transaksion duhet të jetë subjekt i “parimit katër sy”.
3.	Strukturat e administrimit të depozitarit duhet të sigurojnë rakordimin e përditshëm me shoqëritë e administrimit, në mënyrë të tillë që do të dilnin në pah papërputhshmëritë në regjistrimin e transaksioneve ose vlerësimin e asetëve ose të llogarive të kontribuesve, sepse burimet e të dhënave që përdoren në çdo subjekt janë të pavarura nga njëra-tjetra duke reflektuar vetë flukset e punës së tyre në lidhje me kontribuesin dhe transaksionet e asetëve. Duhet të përcaktohen dhe zbatohen qartë procedurat që sigurojnë që papërputhshmëritë trajtohen në mënyrë urgjente dhe efektive, zgjidhen dhe i njoftohen shoqërisë administruese dhe AMF-së. Gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, strukturat drejtuese duhet të tregohen vigjilente për mundësitë e dështimeve ose mashtrimeve sistematike dhe t'i japin dyshimeve në këtë aspekt përparësinë më të lartë.
4.	Përpara zbatimit të çdo tregtimi asetesh të fondit , depozitari duhet të sigurojë se transaksioni është autorizuar siç duhet nga shoqëria administruese dhe është në përputhje me ligjin. Ai duhet të kontrollojë po ashtu që tregtimi është në përputhje me strategjinë e investimeve të fondit dhe të kontrollojë dokumentimin dhe daljen në pah të papërputhshmërive me këshillin mbikëqyrës të shoqërisë. Çdo transaksion i tillë duhet të regjistrohet.
5.	Strukturat e administrimit të depozitarit duhet të sigurohen se ka staf të mjaftueshëm dhe të trajnuar mirë që është i disponueshëm gjatë të gjithë kohës për të marrë përsipër funksionet e veta në mënyrë eficiente dhe efektive dhe me ndarjen e duhur të funksioneve. Duhet të ketë staf të mjaftueshëm për të mbuluar këto detyra.
6.	Administrimi i depozitarit duhet të sigurojë se ekzistojnë pajisje dhe programe IT të përshtatshme për të marrë përsipër funksione depozitari në një mënyrë të mire-kontrolluar, përfshirë dhe <i>back-up</i> -in dhe mbështetjen dhe se ka investime të mjaftueshme për ruajtjen e infrastrukturës për përpunimin e të dhënave. Programet dhe pajisjet kompjuterike duhet të kenë akses të kufizuar vetëm në stafin e autorizuar të depozitarit.
7.	Shërbimi i kontrollit të brendshëm i bankës mëmë duhet të përfshijë brenda programit të vet (dhe të ndërmarrë) testim të mjaftueshëm për funksionet depozitare për ofrimin e administrimit bankar dhe depozitar dhe AMF-ja se janë

	kontrolluar me efektivitet funksionet depozitare. Auditi i brendshëm duhet t'ia raportojë problemet domethënëse shoqërisë administruese duke përdorur shërbimet, AMF-në si dhe administrimin e duhur brenda bankës.
8.	Banka mëmë e depozitarit duhet të ketë një plan rikuperimi në rast fatkeqësie ose plan për vazhdimësinë e biznesit që mundëson biznesin e depozitarit të vazhdojë funksionimin në rast ndërprerje ose katastrofe biznesi. Plani duhet të parashtrojë përgjegjësi të përcaktuara, veprime dhe procedura për të rikuperuar kompjutera, kounikime dhe mjedise në rrjet në rastin e një ndërprerjeje ose katastrofe të papritur në biznes.
9.	Rregullat ose procedurat e brendshme të depozitarit duhet të përfshijnë marrëveshjet për transferimin e përpiktë, të shpejtë dhe të sigurt të aseteve, të dhënave dhe regjistrave të fondit tek një depozitar tjetër në rast se depozitari mbyll aktivitetin e tij ose shoqëria administruese vendos të transferojë shërbimin e depozitarit tek një depozitar tjetër.


3.55 Nuk duhet të ketë asnjë vlerësim të veçantë nga AMF-ja të qeverisjes së depozitarëve, pasi qeverisja e tyre është e lidhur ngushtë me atë të bankës mëmë, e cila vlerësohet nga Banka e Shqipërisë. AMF duhet të mbajë lidhje periodike me stafin përkatës të mbikëqyrësve bankarë për të identifikuar të gjitha problemet në lidhje me qeverisjen, kontrollin, auditin e brendshëm ose qëndrueshmërinë financiare që mund të ndikojë në rreziqet e administruara në depozitar. Informacioni i marrë nga ky burim duhet të përfshihet në seksionin e vlerësimit të dokumenteve në FPMV. Duke pasur parasysh të gjitha këto, disa aspekte të qeverisjes të përshtatshme për funksionet e depozitarit përfshihen në parime, kryesisht parimet 1 dhe 7, dhe kështu përputhja me vetë parimet tregon se qeverisja mund të jetë e pranueshme.

Kapitulli 4. Analiza dokumentare (off-site)

Procedurat e përgjithshme

4.1 Ky seksion i Manualit shpjegon procedurat e përfshira në realizimin e analizave dokumentare bazuar në rrezik, duke përfshirë planifikimin, ekzekutimin dhe masat pasuese. Shembuj të formularëve dhe raporteve që duhet të përfundohen gjatë këtyre proceseve përfshihen si Prova të këtij Manuali. Procesi i përgjithshëm është ilustruar në Figurën 17 më poshtë.

Figura 17: Procesi gjenerik për analizën dokumentare



Qëllimet e analizës dokumentare (off-site)

4.2 Ndërsa inspektimi në terren është i nevojshëm për të siguruar që shoqëritë administruese dhe depozitarët udhëzohen në mënyrë të tillë që sigurojnë uljen e rrezikut aq sa është e mundur, inspektimi vetëm sa mund të sigurojë një panoramë të asaj çfarë ndodh në një kohë të caktuar. Për të identifikuar dështime të rëndësishme që dalin ndërmjet inspektimeve në terren duhet të ketë një proces të vazhdueshëm mbikëqyrjeje fokusuar në mënyrë të veçantë tek ato rreziqe ku mund të kenë pasoja serioze në qoftë se ka ulje të kontrollit. Këto duhet të identifikohen si pjesë e procesit të zhvillimit të strategjisë dhe të analizës.

4.3 Mund të ketë edhe disa kontrole, ku përfshihen analizimi i të dhënave ose dokumenteve të detajuara, të cilat janë më efikase në qoftë se realizohen në zyrë, larg inspektimeve në

terren, në rastin e dhënies së miratimeve dhe hetimin e ankesave, ku është e nevojshme që përgjigja të jepet sa më shpejt. Dhe, analiza e dokumentacionit mund të jetë mënyra më e përshtatshme për këto rreziqe kur ka përkim minimal ndërmjet objektivave të AMF-së dhe të shoqërive të administrimit, për shembull në lidhje me stabilitetin e sistemit financiar shqiptar apo madhësinë e tarifave.

- 4.4 Qëllimi i analizës dokumentare është i ngjashëm me atë të inspektimit në vend, vlerësimin e rreziqeve për kontribuesit dhe për reputacionin dhe qëndrueshmërinë e sistemit. Megjithatë përgjigja për çdo risk apo dështim të konstatuar të kontrollit mund të jetë e ndryshme, pasi vetëm në rastet më të rënda duhet të merren masa të menjëhershme. Në raste të tjera, çështjet mund të çojnë në planifikimin e inspektimit në vend.
- 4.5 Proceset e analizës së dokumenteve mund të bëhen rreth dokumenteve ose ngjarjeve të veçanta. Ky Manual përfshin proceset që mund të përfshihen për secilin grup. Së pari, Manuali përshkruan proceset e përgjithshme për planifikimin, dokumentimin, vlerësimin, rishikimin, raportimin dhe masat e mëpasshme.

Planifikimi i analizës dokumentare (off-site)

- 4.6 Analiza off-site duhet të planifikohet për t'u siguruar se janë të disponueshme burimet e duhura në kohën e duhur për të ndërmarrë çdo proces. Procesi i planifikimit është një nga hapat e nevojshme për të përgatitur planin e mbikëqyrjes trevjeçare. Plani duhet minimalisht të përfshijë analizën e nevojshme për të mbështetur inspektimin në vend, testimin me prioritet të lartë të nevojshëm për strategjitë për zbutjen e rrezikut dhe analizën që kërkohet nga masat e suksesit në strategjitë e rrezikut. Mund të përfshihen dhe analiza të tjera me përparësi më të ulët nëse i lejojnë burimet. Në varësi të prioritetit të tyre, disa analiza mund të përfshihen vetëm në vit alternativ, ose një herë gjatë trevjeçarit.
- 4.7 Duhet të mblidhen dhe të dhënat e nevojshme për inspektimin në terren. Në përgjithësi këto të dhëna vihen në dispozicion, por kur plani kërkon një analizë të re, duhet të bëhet një kontroll për të parë nëse të dhënat janë marrë tashmë në mënyrë rutinore nga AMF. Nëse nuk është ky rasti, duhet të specifikohen të dhënat precize që kërkohen dhe t'u kërkohet subjekteve përkatëse që t'i japin këto të dhëna. Kur përfshihen organizatat joqeveritare, mundësisht preferohet që ketë një fuqi rregulluese për t'i kërkuar ato, por në mungesë të kësaj fuqie, AMF-ja duhet të kërkojë marrjen e tyre në mënyrë vullnetare. Në çdo rast, ajo mund të mbulohet nga kompetencat e përgjithshme për mbledhjen e informacionit të përgjithshëm.
- 4.8 Në çdo rast, plani duhet të specifikojë se cilat të dhëna duhet të merren nga cilat subjekte, dhe kohën kur duhet të merren këto të dhëna. Nëse ka ndonjë dyshim në lidhje me kohën, përmbajtjen ose formatin e të dhënave, subjektet e interesuara duhet në këtë fazë të njoftohet për formatin dhe kohën e rënë dakord.
- 4.9 Hapi i fundit është krijimi i programit të analizave, ku tregohet se cilët individë brenda ekipit të mbikëqyrjes janë të përfshirë në këtë proces. Analiza e dokumenteve duhet të jetë e organizuar përreth inspektimeve në vend, në mënyrë që burimet të mos jenë të mbingarkuara në çdo kohë gjatë vitit.

Marrja e të dhënave për analizën off-site

- 4.10 Të dhënat që i jepen AMF-së nga shoqëritë e administrimit janë përcaktuar në rregullore të veçantë. Kjo rregullore duhet të shqyrtohet në mënyrë periodike, kur të jetë e nevojshme për të siguruar se të dhënat që i duhen AMF-së janë të përfshira me frekuencën e duhur dhe se nuk përfshijnë të dhëna që nuk janë të nevojshme. Nëse të dhënat nuk janë të nevojshme për qëllime të analizave, është e mundshme që ato të mos kontrollohen, dhe mbase është e rrezikshme për reputacionin e AMF-së që të mbajë të dhëna që nuk kontrollohen dhe që mund të përfshijnë materiale që dëshmojnë për një problem dhe rrezik që nuk ndiqet më tej.
- 4.11 Ekipi i mbikëqyrjes duhet të kontrollojë që të dhënat janë marrë nga subjektet përkatëse në kohën e caktuar dhe të kontaktojë subjektet nëse ka vonesë të konsiderueshme. Nëse vonesat janë të shpeshta ose të vazhdueshme, kjo mund të dëshmojë për disa dobësi në njësinë ekonomike. Subjekti duhet të kontaktohet zyrtarisht për shpjegime dhe garanci në lidhje me pajtueshmërinë në të ardhmen. Nëse nuk ka garanci apo shpjegime të kënaqshme në të ardhmen, duhet të përgatitet një memo për drejtuesin e AMF-së, si dhe duhet të shqyrtohet marrja e masave pas procesit të shpjeguar në paragrafin 4.17 më poshtë. Nëse vonesat janë të pamjaftueshme për të merituar një përgjigje të tillë serioze, rreziku dhe formulari i planifikimit të mbikëqyrjes dhe vlerësimit në lidhje me qeverisjen duhet të shpjegohen në mënyrë që mund të hulumtohen në vend arsyet themelore.
- 4.12 Nëse gjatë analizës janë gjetur gabime në të dhënat e marra, edhe ato mund të jenë tregues për një problem të rëndësishëm themelor. Gabimet duhet të ngrihen në mënyrë informale dhe menjëherë me subjektin në fjalë. Nëse ato nuk korrigjohen shpejt apo ndodhin shpesh, duhet të ndërmerren veprime të ngjashme si në rastin e vonesave.

Dokumentimi i analizës dokumentare (off-site) dhe përfundimet

- 4.13 Rezultatet e secilës analizë off-site duhet të dokumentohen duke përdorur fletat e përshtatshme të punës, siç specifikohet në seksionet e mëposhtme të këtij Manuali. Përfundimet dhe implikimet për inspektimin në terren duhet të regjistrohen në Formularët e Planifikimit të Mbikëqyrjes dhe Vlerësimit (FPMV) të përdorura për analizat, në mënyrë të tillë që të jepet informacion rreth inspektimit pasardhës në terren.

Veprimi(et) në vijim

- 4.14 Hapi tjetër është që të vendoset për veprimet ose masat vijuese që do të merren, nëse ka. Nëse nuk janë zbuluar probleme gjatë analizës, atëherë kjo gjë mund të regjistrohet. Nëse konstatohen dështime, ato dokumentohen dhe bëhet një vlerësim fillestar i ndikimit të tyre. Ato duhet të ngrihen në mënyrë informale me subjektin për të marrë një mendim paraprak të arsyeve të shkaqeve të tyre të mundshme dhe nëse njësia ekonomike është në dijeni të tyre. Nëse çështjet nuk janë shumë serioze apo nuk janë treguese të një situate potencialisht serioze, vlerësimi i detajuar mund të lihet për inspektimin e ardhshme të planifikuar për në terren. Vëmendje e veçantë duhet t'u jepet problemeve të paraqitura nga treguesit e hershëm paralajmërues.

4.15 Pasi është marrë një përgjigje informale nga subjekti, ose kur duket se nuk do të ketë përgjigje prej tij në të ardhmen, nëse çështjet konsiderohen të jenë serioze, duhet të merret parasysh përshkallëzimi deri tek piramida e zbatimit (Figura 5 në Kapitullin 1). Problemet përcaktohen si mjaft serioze, nëse:

- Ka pasur një shkelje të rëndë të një kërkesë të veçantë legislative;
- Rreziku i pranishëm është portokalli apo i kuq dhe analiza tregon për një problem jo të njohur, për të cilën ka arsye për lëvizjen e tij në zonën e rrezikut me ngjyrë portokalli apo të kuq;
- Ekziston një mundësi e pashmangshme për humbjen e fondeve të kontribuesve; ose
- Çështja është tregues i dështimit të rëndë të qeverisjes në një subjekt (e cila, për këtë arsye, mund të ndikojë dhe mbi rreziqe të tjera).

4.16 Në këto rrethana, nëse problemi është i qartë dhe nuk është e qartë se kemi të bëjmë me një shkelje specifike të ligjit, apo rrezik të afërt të lidhur me fondet e kontribuesve, atëherë duhet të merret veprim i menjëhershëm. Përndryshe, çështja duhet t'i njoftohet zyrtarisht subjektit si çështje që do të mbulohet gjatë inspektimit të ardhshëm në vend. Nëse inspektimi tjetër nuk është planifikuar të ndodhë për ca kohë, ai ose duhet të përshpejtohet, ose duhet të organizohet një inspektim i veçantë, i cili do të fokusohet vetëm tek rreziku përkatës dhe çdo çështje përkatëse që lidhen me qeverisjen. Procesi parashikohet më poshtë.

Veprimet në përgjigje të gjetjeve serioze nga analiza e dokumentare (off-site)

4.17 Siç u tha më sipër, shoqëria administruese ose depozitari duhet të marrin masa të menjëhershme vetëm nëse gjetjet e konstatuara janë mjaftueshmërisht të rënda dhe kritike për ndërhyrje përse i përket aspektit kohë, siç u përshkrua më sipër. Në rast se ndodh kështu, drejtuesi i skuadrës së mbikëqyrjes duhet të përgatisë një **memo** ku dokumentohet problemi dhe të marrë këshilla nga Departamenti Ligjor lidhur me implikimet e masave për çdo rast shkelje ligji. Memorandumi duhet të përfshijë:

- Përmbledhje e analizës që çoi tek çështja;
- Provat e marra;
- Vëzhgimet që tregojnë përse gjetja është serioze, duke iu referuar efekteve të shkeljes dhe gjithë pasojave negative të vërejtura ose që mund të jenë kryer;
- Përfundimet e lidhura me shkeljen e legjislacionit ose të parimeve mbikëqyrëse që mund të kenë ndodhur; dhe
- Rekomandime për masa ndreqëse, që kërkojnë të përcaktojnë natyrën e problemit, ose një inspektim të hershëm ose të posaçëm brenda një kohe specifike.

4.18 Nëse Drejtori i AMF-së, mbështetur tek këshillimi i përshtatshëm nga Shefi i Mbikëqyrjes, pranon se çështja është mjaftueshmërisht serioze për t'u ngritur në këtë fazë, ai / ajo duhet t'ia dërgojë shkresën këshillit drejtues mbikëqyrës të shoqërisë së administrimit, ose menaxherit të përgjithshëm të depozitarit, me fletë zyrtare shoqëruese, duke kërkuar konfirmimin e fakteve dhe duke kërkuar një përgjigje lidhur me veprimet korrigjuese që duhet të ndërmerren. Nëse konsiderohen të mundshme dhe të dëshirueshme, atëherë duhet të nisen procedurat për shkelje ligjore. Nëse bihet dakord për

një inspektim më herët ose të veçantë në vend atëherë planifikimi për të duhet të fillojë menjëherë, së bashku me ri-caktimin e aktiviteteve të tjera të nevojshme për ta bërë të mundur atë inspektim.

- 4.19 Në qoftë se çështja është aq urgjente sa kërcënon asetet e kontribuesve, shefi i ekipit mbikëqyrës mund të vijojë me anë të komunikimit telefonik ose elektronik, në mënyrë që të nxisë masa të menjëhershme korrigjuese. Shefi i Mbikëqyrjes duhet ta autorizojë këtë veprim, dhe duhet të informojë në vijimësi Drejtorin e AMF-së. Në një rast të tillë duhet të mbahen gjurmë të plota të miratimeve dhe të komunikimeve përkatëse. Mund të ndodhë që AMF-ja të duhet të marrë kontrollin e subjektit në mënyrë që të largojë rrezikun e menjëhershëm ndaj kontribuesve. Në këtë rast, Departamenti Ligjor duhet të ndihmohet në marrjen e këtij veprimi, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

Sigurimi i cilësisë

- 4.20 Të gjitha planet e punës dhe raportet e prodhuara gjatë analizave në terren duhet të analizohen nga një zyrtar i lartë i AMF-së pas shkrimit të tyre nga një person tjetër. Pas këtij procesi dokumentet duhet të nënshkruhen. Analiza duhet të konfirmojë që verifikuar që:

- Analiza është kryer sipas specifikimeve;
- Janë nxjerrë përfundimet përkatëse nga analiza; dhe
- Janë rekomanduar përgjigjet përkatëse në rastet kur ngrihen çështje nga analiza.

Analizat specifike

- 4.21 Pjesa e mbetur e këtij kapitulli dokumenton proceset analitike që ka të ngjarë të përfshihen në planin trevjeçar. Duhet të zhvillohen analiza të tjera, pasi rrethanat dhe prioritetet ndryshojnë, të cilat duhet t'i shtohen këtij Manuali. Analizat janë të specifikuara nën titujt e mëposhtëm, që përgjithësisht ndjekin rendin në të cilin paraqiten në këtë manual parimet e qeverisjes dhe të zbutjes së rrezikut, të identifikuara nga AMF:

- Shqyrtim i procesverbaleve të këshillit të shoqërisë administruese dhe komisionit të investimeve;
- Analiza e raporteve të auditimit dhe marrëdhënia me audituesit;
- Analiza e deklaratave të parimeve të investimit ose dokumenta të tjerë për strategjinë e investimeve;
- Analiza e portofolit të investimeve;
- Analiza e të dhënave financiare nga shoqëritë administruese dhe depozitarët;
- Testimi i materialit të marketingut;
- Shqyrtimi i transfertave nga fondet e pensionit;
- Analiza e planit të biznesit të shoqërisë administruese;
- Analiza e kapitalit të shoqërisë administruese.

Shqyrtim i procesverbalit të Këshillit të shoqërisë dhe i komitetit të investimeve

4.22 Qëllimi i shqyrtimit të proces-verbalit është dhënia e disa treguesve nëse Këshilli ose komiteti i investimeve po japin çështje të rëndësishme në mënyrë transparente për shkak të gjyqimit dhe funksionimit në mënyrë efikase, si dhe paraqitjes së pyetjeve për t'u drejtuar gjatë një inspektimi në vend. Formulari në shtojcën 4.1 mund të përdoret për të dokumentuar shqyrtimin.

4.23 Nëse këto procesverbale nuk merren në mënyrë rutinore, ato duhet të kërkohej para ndonjë inspektimi në vend. Qëllimi është që ato t'u vijjnë në ndihmë intervistuesve për të përgatitur pyetje për strukturat drejtuese. Në qoftë se ka disa anëtarë të ekipit të ngarkuar me përgatitjen e pyetjeve, ata të gjithë duhet të lexojnë procesverbalet e Këshillit. Intervistuesi (t) përgjegjës për investimet dhe për qeverisje duhet të lexojnë dhe procesverbalet e Komitetit të investimeve. Çështjet me interes duhet të hidhen në kolonën e konkluzioneve të analizës së dokumentacionit lidhur me parimin në fjalë. Parimet mbikëqyrëse për të cilat ato mund të paraqesin interes të veçantë jepen në Kapitullin 3. Në përmbledhje, ato përfshijnë (për aq kohë sa inspektimi mbulon riskun në fjalë):

- Parimin e Qeverisjes 2: dëshmi për kryerjen e trajnimeve dhe kualifikimeve, të cilat justifikojnë nivelin e njohurive;
- Parimi i Qeverisjes 3: vendimet që mund të jenë prekur nga konflikti apo mungesa e interesit;
- Parimi i Qeverisjes 4: vendimet strategjike dhe strategjitë e reja të fundit me vlerë për t'u shqyrtuar për intervista;
- Parimi i Qeverisjes 5 dhe Parimi i Investimit 7: dëshmi se janë marrë raporte mbi performancën e shoqërisë dhe fondit (eve);
- Parimi i Qeverisjes 6: dëshmi që ai ka marrë, ka shqyrtuar, dhe nëse është e nevojshme, dhe veprohet sipas raporteve të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm (dhe pajtueshmërisë ligjore);
- Parimet e Investimit 1 dhe 2: dëshmi se vendimet janë të bazuara në interes të kontribuesve pas informimit nga ekspertizë e mjaftueshme;
- Parimi i Investimit 6: çdo dëshmi që sugjeron, ose e kundërta, se aktiviteti i investimeve ka qenë i kufizuar padrejtësisht nga kufizimet në burime;
- Parimi i Investimit 9: Komisioni i Investimeve: dëshmi të çdo papërputhshmërie të zbatimit të strategjisë së investimit, apo shkeljes së portofolit apo kufijve të rrezikut, apo se kontrolli është efektiv. Këshilli Mbikëqyrës: dëshmi për mënyrën se si po zbatohet strategjia;
- Parimi i Riskut Operacional 7: çdo referencë për politikën e mbrojtjes së të dhënave, ose dështimet në mbrojtjen e të dhënave;
- Parimi i Riskut Operacional 8: të dhëna në lidhje me shërbimin e IT-së që ofrohet dhe në lidhje me ndonjë problem të rëndësishëm, së bashku me shqyrtimin e strategjisë së TI-së;
- Parimi i Riskut Operacional 10: dëshmi e çdo konsiderate për planin, testimin ose problemet për vazhdimësinë e biznesit;
- Parimi i Riskut Operacional 13: dëshmi e shqyrtimit të rrezikut të mashtrimit dhe të vetëdijes së mashtrimit;
- Risku Operacional - të gjitha parimet: çdo dëshmi e problemeve operative;

- Zhvillimi i parimeve të biznesit: dëshmi e shqyrtimit të politikave të marketingut dhe kontroleve brenda saj, së bashku me referencat për keq-shitjen, dhe probleme të tjera;
- Parimet e qëndrueshmërisë së shoqërisë: dëshmi e shqyrtimit nga Këshilli të çështjeve që lidhen me planifikimin e biznesit, menaxhimin financiar, mjaftueshmërinë e kapitalit dhe menaxhimin e rrezikut brenda shoqërisë;
- Kostot dhe tarifat: dëshmi e rëndësisë që i jepet efikasitetit, kostove dhe pagesave.

Analizat e raporteve të auditimit dhe marrëdhënia me audituesit

4.24 Të gjitha raportet e auditimit të brendshëm në shoqërinë administruese duhet t'i dërgohen AMF-së, si një gjë e natyrshme, dhe duhet të rishikohet pas marrjes duke përdorur formularin në shtojcën 4.2, duke iu referuar gjetjeve dhe rekomandimeve për rreziqet dhe parimet mbikëqyrëse. Raportet e depozitarit për auditimin e brendshëm duhet të merren përpara inspektimeve dhe duhet të analizohet në mënyrë të ngjashme. Përfundimet e lidhura me dobësitë potenciale përkundrejt parimeve mbikëqyrëse dhe informacione kyçe lidhur me pyetjet që do të bëhen duhet të përkthehen pastaj në FPMV-të përkatëse, në mënyrë që të japin informacionin e nevojshëm për ekzaminimin në terren dhe për vlerësimin e rrezikut. Në qoftë se një gjetje apo rekomandim në një shoqëri administruese duket se cek disa rreziqe, është më mirë që ato të dokumentohen nën parimin(et) më të afërta që qeverisjes (s). Ndërkohë që qëllimi kryesor është informimi i planifikimit dhe udhëheqja e inspektimeve në vend, raportet mund të paraqesin probleme që kërkojnë vëmendje të menjëhershme, në mënyrë të veçantë nëse konfliktohen me vlerësimin e rrezikut aktual të pranishëm ose të mbetur.

Analiza e deklaratave të parimeve të investimit ose dokumenta të tjerë për strategjinë e investimeve

4.25 Dokumentacioni i strategjisë së investimeve, siç është deklarata e parimeve të investimit paraqet një burim të rëndësishëm evidence për vlerësimin e strategjisë së investimeve, si dhe sigurimin e të dhënave për analizën e portofolit të investimeve. Shoqëritë administruese duhet t'i dërgojnë AMF-së strategjinë e tyre të investimeve për çdo fond që administrojnë, duke përfshirë versionin e ri sa herë që përditësohet. Letra që i dërgohet një shoqërie përpara një inspektimi duhet të sigurojë se AMF pajiset me versionin më të fundit. Çdo herë që rishikohet, deklarata duhet të analizohet në kuadër të parimeve përkatëse të investimeve mbikëqyrëse, të dokumentuara në formularin në shtojcën 4.3, i cili përdoret po ashtu për të dokumentuar përfundimet e nxjerra nga shqyrtimet e tjera të dokumenteve të investimeve. Përfundimet nga kjo analizë më pas duhet të përkthehen në seksionin e analizës së dokumenteve të investimeve të FPMV-së, në mënyrë që të shërbejnë për ofrimin e informacionit për ekzaminimet në terren dhe për vlerësimin e rrezikut.

Analiza e portofolit të investimeve

4.26 Qëllimet e analizës së portofolit të investimeve janë:

- Kontrolli që fondi nuk i ka tejkaluar kufijtë e legjislacionit, ose dokumentin e strategjisë së investimeve; nuk ka shumë probabilitet që të ndodhë kjo pasi depozitari bën një verifikim të ngjashëm dhe me siguri do të përbënte një paralajmërim të hershëm të një problem të madh.
- Merrni në konsideratë nëse shpërndarja e aseteve të fondit po zhvillohet në një mënyrë që është në përputhje me strategjinë në deklaratën e parimeve të investimeve, që mund të paraqesin një paralajmërim të hershëm të rreziqeve të investimeve që materializohen.
- Kontrolli që performanca e investimit e raportuar nga shoqëria është e saktë;
- Shqyrtimi sesi po performon fondi dhe strategjia e tij përkundrejt objektivave dhe treguesve përkatës krahasimorë, në mënyrë që të ofrohet informacion për diskutimin me Këshillin Mbikëqyrës dhe Komisionin e Investimeve;

4.27 Duhet të theksohet se rezultatet e tre qëllimeve të para do të ngrihen në intervistë vetëm nëse rezulton të ketë një problem, ndërsa qëllimi fundor është ofrimi i një linje pyetjesh për intervista. Vetëm fakti që një portofol tjetër e ka tejkaluar në performancë portofolin objekt shqyrtimi nuk do të thotë domosdoshmërisht se ka një problem me portofolin e fondit; për shembull, ai mund të ketë risk afatgjatë më të ulët. Por, pavarësisht të gjithave situata ngre një sërë pyetjesh se pse shoqëria nuk ka e ka menaxhuar ndryshe fondin; për shembull, pse është kohëzgjatja e bonove të saj e ndryshme nga fondet e tjera ", ose pse nuk ka investime të huaja. Përgjigjet duhet ta ndihmojnë AMF-në për të vlerësuar nëse shoqëria administruese e kupton se çfarë po bën dhe nëse i ka kushtuar vëmendje të mjaftueshme sigurimit të një raporti të mirë ndërmjet rrezikut dhe fitimit (kthimit) nga proceset e specifikuar tek parimet mbikëqyrëse të investimeve. Këto çështje duhet të përmblihen në FPMV-të investuese.

4.28 Analiza duhet të bëhet çdo tre muaj duke përdorur të dhënat për çdo fond të ofruara nga shoqëria përkatëse menaxhuese në përbërjen e portofolit dhe kthimit nga klasa e aseteve. Të dhëna të veçanta duhet të merren për çdo kohëzgjatje të obligacioneve qeveritare. Shifra e përgjithshme e fitimit (kthimit) duhet të jepet bruto, duke hequr tarifat dhe inflacionin. Përveç analizimit të të gjitha fondeve të pensioneve të mbikëqyrura, mund të bëhet dhe analiza e:

- portofolit të treguesve krahasimorë që reflektojnë alokimin e aseteve strategjike në deklaratën e parimeve të investimit të secilit fond.
- Një portofol i thjeshtë treguesish krahasimor (benchmark portfolio) i ndërtuar nga AMF-ja për të treguar se si do të bëhej ai i krahasueshëm me një portofol të diversifikuar ndërkombëtar.

4.29 Duhet të përdoret dhe një format në Excel (spreadsheet) që mbulon artikujt e specifikuar në shtojcën 4.4. Të dhënat që do të futen në të vijnë nga ndarjet e aseteve aktuale apo analizat e prezumuara duke reflektuar portofolet e treguesve krahasimorë të dokumentit/deklaratës të parimeve të investimeve dhe AMF-së. Të dhënat duhet më pas të përdoren për të llogaritur kthimin e investimeve, duke pasur parasysh të dhënat nga shoqëritë për blerjen dhe tjetërsimin e aseteve në secilën kategori. Këto kthime duhet më pas të krahasohen me kthimet e raportuara nga shoqëritë, dhe çdo mospërputhshmëri e rëndësishme duhet ndjekur më tej. (Procesi i llogaritjes së kthimit të investimeve ka të

ngjarë të jetë i përafërt në disa raste kështu që mospërputhjet e vogla më mirë të mos merren parasysh).

Analiza e të dhënave financiare nga shoqëritë administruese dhe depozitarët

4.30 Qëllimi i kësaj analize është të kontrollojë se shoqëritë administruese dhe depozitarët po pajtojnë shifrat e duhura, si dhe të japin një pasqyrë se si po zhvillohet sektori, duke identifikuar çdo zhvillim të pazakontë që duhet të ndiqet deri para ose gjatë inspektimit të ardhshëm. Bashkërendimet janë veçanërisht të rëndësishme si mjet për të parandaluar ose zbuluar mashtrimin dhe për të siguruar ndryshe që asetet ruhen të sigurt . Shifrat jepen çdo muaj dhe kështu analiza duhet të bëhet çdo muaj. Duhet të përdoret një format në Excel (Spreadsheet) për të mbuluar artikujt e specifikuar në shtojcën 4.5 (Excel). Ky është një tregues i hershëm paralajmërimi i problemeve të mëdha që lidhen me kategoritë e rrezikut 4,5, 9 ose 11.

4.31 Analiza është gjithashtu e rëndësishme për rreziqet për arkëtimin e kontributeve dhe shtojca 4.5 duhet të përdoret dhe për të analizuar kontributet nga punëdhënësit më të mëdhenj dhe në tërësi, në mënyrë që të identifikohen tendenca të pazakontë, për shembull mungesën e kontributeve ose kontribute shumë të reduktuara nga një punëdhënës në një muaj të caktuar . Çdo lëvizje e papritur në nivelin e kontributeve duhet të theksohet në FPMV-në për rrezikun e kontributeve dhe duhet të ndiqet më pas. Kjo analizë është e mundur vetëm në qoftë se të dhënat e kontributeve të marra nga shoqëritë e bëjnë dallimin në mes kontributeve individuale dhe profesionale të fondeve, përfshirë dhe fondet profesionale të veçanta. Nëse ky test duhet të bëhet, kjo ndarje duhet të kërkohej në fillim të vitit dhe të përfshihet në rregullore në kohën e duhur.

4.32 Analiza duhet ta bëjë AMF-në vigjilente për çdo ndryshim të papritur ose të pazakontë në nivelin e transfertave jashtë fondeve, të cilat duhet të ndiqen para ose gjatë një inspektimit (dhe duhet të vihen në dukje në FPMV-në përkatëse në përputhje me rrethanat).

Testimi i materialit të marketingut

4.33 Ky verifikim ndërmerret nga Departamenti Ligjor dhe mund të paraqesë një paralajmërim të hershëm të shitjes së gabuar. Ekipi i mbikëqyrjes duhet të mbajë lidhje të rregullta me Departamentin Ligjor për të verifikuar se çfarë problemesh, nëse ka, kanë dalë në pah. Çdo çështje që hedh dyshim mbi pajtueshmërinë e shoqërisë me parimet e menaxhimit të rrezikut të keqshitjes nuk duhet të shënohet në FPMV-në përkatëse, por do të ndiqet para ose gjatë inspektimit të ardhshëm.

Shqyrtimi i transfertave nga fondet e pensionit

4.34 Disa shqyrtime analitike të transfertave mund të ndërmerren si pjesë e analizës financiare të dokumentuar në formularin në shtojcën 4.5. Nëse kjo konsiderohet e pamjaftueshme për t'ju adresuar rreziqeve të përfshira, të cilat mund të përfshijnë rrezikun e mashtrimit, AMF duhet të kërkojë gjithashtu që të marrë të dhëna që i mundësojnë asaj identifikimin e transfertave individuale të kryera nga çdo fond pensioni, dhe në këtë mënyrë kanë paralajmërim të hershëm për probleme. Ato duhet të rishikohen në mënyrë periodike,

fillimisht një herë në tre muaj edhe pse mund të jetë e përshtatshme dhe një tjetër interval kohe, ose më i gjatë, ose më i shkurtër, në bazë të vlerësimit të rrezikut të mbetur. Analizuesi duhet të kontrollojë që transaksionet relativisht të mëdha të duken të arsyeshme dhe të identifikojë transaksionet që duken të pazakonta, dhe gjithashtu të kërkojë për të identifikuar llojet e transaksioneve që janë dukshëm më të mëdha se zakonisht. Ndonjëherë mund të mjaftojë të pritët inspektimi i ardhshëm në vend për të kontrolluar transaksionit, por në qoftë se transaksionet janë relativisht të mëdha apo të papritura duhet t'i bëhet menjëherë një telefonatë ose e-mail administratorit të fondeve. Në qoftë se nuk ka shpjegim të arsyeshëm, duhet të ndërmerret veprim i menjëhershëm, siç shpjegohet në paragrafët 4.17-19. Shtojca 4.7 mund të përdoret për ta dokumentuar këtë analizë, duke plotësuar shtojcën 4.5. Pragjet financiare të përdorura për të identifikuar se ku transaksionet duken jashtëzakonisht të mëdha duhet të rregullohen me përvojë.

Analiza e planit të biznesit të shoqërisë administruese

4.35 Planet e biznesit të shoqërisë administruese duhet të analizohen si pjesë e vlerësimit të rrezikut të qëndrueshmërisë së shoqërisë, dhe duhet të merret para çdo inspektimi që mbulon këtë rrezik. Vlerësuesi duhet të shohë në mënyrë të veçantë për mbulimin kuptimplotë dhe substantiv të artikujve të listuara në Kutinë 8 në Kapitullin 3. Pyetje në lidhje me cilësinë dhe sasinë e materialit në çdo plan duhet të ngrihen gjatë intervistave të nivelit të lartë, gjatë inspektimit në terren. I vetmi ushtrim që mund të jetë i përshtatshëm para inspektimit është të kontrolluarit nëse ka dokumente të tjera mbështetëse për ekzaminimin në vend. Kjo mund të përfshijë, në mënyrë të veçantë, edhe strategjinë e planit të blerjes / marketingut.

Analiza e kapitalit të shoqërisë administruese

4.36 Qëllimi i kësaj analize është të kontrollojë se kapitali i mbajtur nga çdo shoqëri administruese është në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe të japë informacion për pyetjet që do t'i bëhen strukturave administruese të shoqërisë lidhur me rrezikun e qëndrueshmërisë së shoqërisë gjatë inspektimit në terren (dhe për rregullore në të ardhmen për nivelin e kapitalit minimal të përshkruar). Prandaj, niveli i kapitalit duhet të krahasohet me shpenzimet gjatë viteve të fundit, duke pasur parasysh se duhet të ketë dhe disa mbrojtës kundër rrezikut. Trendi në nivelin e përfitimit duhet të monitorohet për të ndihmuar me pyetje rreth planifikimit të biznesit të shoqërisë. Duhet të përdoret Formulari në shtojcën 4.8 (Excel). Ky formular duhet të ndihmojë gjithashtu për paraqitjen e analizës për kostot dhe rrezikun e detyrimeve dhe paraqitjen e paralajmërimit të hershëm të problemeve financiare.


4.37 Çdo shkelje ligjore duhet të ndiqet me veprimet përkatëse menjëherë. Përndryshe, çështjet me vlerë për t'u eksploruar gjatë inspektimit duhet të theksohen në FPMV-në përkatëse.

Kapitulli 5. Inspektimet në vend të shoqërive administruese dhe depozitarëve

Vështrim i përgjithshëm

5.1 Edhe pse, për shkaqe praktike, proceset e inspektimeve në terren dhe analiza e dokumenteve janë dokumentuar në pjesë të ndryshme të këtij Manuali, në praktikë ato janë të lidhura ngushtë, siç tregohet në Figurën 18 më poshtë, për shkak se rezultatet e analizave të dokumenteve përbëjnë bazën teorike të inspektimit në vend dhe janë pjesë e procesit të vlerësimit të inspektimit në vend. Në kohën e duhur këto vlerësime shërbejnë si bazë për vendimet për analizën e dokumenteve dhe inspektimeve në vend për vitin e ardhshëm. Të pestë hapat në këtë kapitull korrespondojnë me kutitë në Figurën 18.

Figura 18: Cikli i inspektimit në terren



Llojet e inspektimit

5.2 Hapat në një inspektim në vend janë të ngjashme, pavarësisht nëse po inspektohet shoqëria administruese apo depozitari, edhe pse në praktikë inspektimi i një depozitari zakonisht përfshin më pak punë, dhe shoqërohet me dokumentacion më të thjeshtuar. Pjesa tjetër e këtij kapitulli jep udhëzime të përgjithshme lidhur me qasjen ndaj inspektimit, duke i lënë seksionet e mëposhtme të mbulojnë çështje që janë specifike për një lloj subjekti ose një tjetri.

5.3 Shkalla e inspektimit e shoqërisë së administrimit varet nga numri i rreziqeve për t'u ekzaminuar; ato janë identifikuar përkohësisht në planin trevjeçar, por mund të jetë e nevojshme të bëhen ndryshimet që dalin nga gjetjet e analizave të dokumenteve. Qëllimi

duhet të jetë të kufizohet numri i rreziqeve objekt ekzaminimi vetëm për ato rreziqe që mund të mbulohet nga një ekip prej katër personash në një inspektim dy-javor në vend. Duhet të shqyrtohet edhe qeverisja për të ndihmuar në sigurimin e një vlerësimi të plotë të çdo rreziku, siç përcaktohet në Kapitullin 3. Kur qeverisja në një subjekt është vlerësuar si tërësisht ose kryesisht në përputhje me vitin paraprak, mund të justifikohet një mbulim i reduktuar i qeverisjes, duke çliruar më shumë kohë për ekipin për të shqyrtuar rreziqe shtesë. Në këtë rast, qëllimi i vlerësimit të qeverisjes mund të kufizohet tek kontrolli për çdo ndryshim të rëndësishëm në mënyrën si është drejtuar shoqëria dhe të personelit të përfshirë në drejtimin e tij. Përveç kësaj, shqyrtimi i mënyrës sesi menaxhohet rreziku mund të identifikojë çështjet e qeverisjes. Në qoftë se këto procedura të kufizuara tregojnë për një ulje të konsiderueshme të qeverisjes, objekti i shqyrtimit të qeverisjes mund të kenë nevojë të rritet.

- 5.4 Në përgjithësi duhet të supozohet se rreziqet e zbatuara në depozitarë duhet të shqyrtohen të gjithë gjatë një inspektimi në vend, por rreziqet më të vogla ndonjëherë mund të hiqen për të optimizuar përdorimin e burimeve të pakta.
- 5.5 Në rastet kur identifikohet një problem serioz në një subjekt si rezultat i analizës së dokumenteve mund të jetë i nevojshëm një inspektim urgjent, pasi situata nuk pret dot për inspektimin e ardhshëm të planifikuar. Në këtë rast, duhet të përgatitet për miratim një projekt memo planifikimi për inspektimi (shih Hapi 1 më poshtë) nga strukturat e larta drejtuese, ku theksohen arsyet pse kërkohet inspektimi dhe përmbajtja e inspektimit të propozuar emergjent. Udhëheqësi i ekipit duhet të bëjë propozime për riplanifikimin e punëve të tjera të planifikuara. Inspektimi urgjent ose do të përqendrohet vetëm tek rreziku (rreziqet) e identifikuar, duke qenë kështu një inspektimi i shkurtër, ose të jetë një inspektim i plotë i dalë si rezultat i planit.
- 5.6 Ndërsa qasja e përgjithshme e dokumentuar në këtë pjesë për inspektimet urgjente do të shtjellohet më tej, jo të gjitha detajet mund të zbatohet.

Qëllimet dhe procesi i përgjithshëm

5.7 Qëllimet e një inspektimi në terren janë:

- Të kontrollojë nëse janë zbatuar rekomandimet e mëparshme që i janë bërë subjektit;
- Të vlerësojë sesa mirë po i zbut rreziqet e identifikuar në planin e mbikëqyrjes si zëra që kanë nevojë për vlerësim subjektit;
- Të vlerësoj qeverisjen e shoqërisë administuese deri në shkallën e kërkuar nga plani i inspektimit, në veçanti për të siguruar që këshilli mbikëqyrës ka të dhëna që rreziqet po zbuten në mënyrë efektive dhe të marrë masat e nevojshme kur nuk bëhet kjo gjë;
- Të bëjë rekomandime për përmirësime; dhe
- Të shqyrtojë nëse nevojiten masa zbatuese si rezultat i inspektimit, dhe nëse jo, të vendoset çfarë të bëhet.

5.8 Hapat në inspektim janë:

- Hapi 1: **planifiko** inspektimin, duke përfshirë pyetjet që do të bëhen dhe testet që do të ndërmerren;

- Hapi 2: **intervisto** drejtuesit e lartë të subjektit deri në masën e nevojshme për zbatimin e planit të inspektimit dhe më pas bëj një analizë të ndërmjetme për të përcaktuar nëse rezultatet e intervistave kërkojnë ndonjë ndryshim në planin e inspektimit;
- Hapi 3: merr përsipër **testimin** siç kërkohej nga plani (i përditësuar) dhe bëj intervista pasuese nëse ato janë të nevojshme;
- Hapi 4: bëj **një vlerësim të cilësisë së zbutjes së rrezikut** në subjekt, duke përfshirë qeverisjen në shoqëritë administruese, duke vendosur se çfarë rekomandimesh do të bëhen për strukturat drejtuese të shoqërisë dhe, në rast se problemet janë serioze, për strukturat drejtuese të AMF-së, lidhur me masat ndreqëse;
- Hapi 5: **raporto** tek subjekti, së pari me gojë dhe më pas me shkrim, si dhe bëj raportim të brendshëm dhe sigurim cilësie; dhe
- Hapi 6: **ndiq** rekomandimet e bëra për shoqërinë, duke ndërmarrë masa zbatuese, nëse është e nevojshme.

Qasja e përgjithshme ndaj vlerësimit dhe dokumentimit

5.9 Çdo hap në procesin e inspektimit duhet të dokumentohet në mënyrë të përshtatshme, siç është përcaktuar në këtë manual. Pjesa më e madhe e dokumentacionit të detajuar përfshihet ose referohet në Formularët e Planifikimit të Mbikëqyrës dhe Vlerësimit (në Excel), të cilat nga ana e tyre bazohen në parimet mbikëqyrëse përkatëse. FPMV-të përdoren për të dokumentuar vendimet se si do të testohen zbutjet e rreziqeve dhe për të dhënë rezultatet e këtyre testeve në mënyrë që të mundësojë vlerësimin e çdo parimi.

5.10 Pyetjet që duhet të bëhen gjatë një inspektimi në vend mund të mendohet në tre nivele:

- Çfarë sjellje, përfshirë qeverisjen, pritet nga subjekti i mbikëqyrur në mënyrë që të zbutet çdo kategori rreziku që mbulohet gjatë inspektimit. Kjo përshkruhet në strategjitë e rrezikut dhe zgjerohet më tej tek **parimet mbikëqyrëse të zbutjes së rrezikut** dhe tek materiali mbështetës për vlerësimin e çdo parimi të mbuluar në Kapitullin 3.
- **Praktikat e mira të pritshme nga subjektet e mbikëqyrura** në mënyrë që ato të zbatojnë parimet. Një grup i parë i tyre përfshirë në FPMV. AMF-ja duhet të kërkojë zbatimin e këtyre veprimeve bazuar në qasjen "përputh ose shpjego ". Subjektet e mbikëqyrura mund të bëjnë diçka të ndryshme për aq kohë sa ato mund të shpjegojnë se pse ajo çfarë ata po bëjnë ende është në përputhje me parimet e nivelit të lartë.
- duhet të përgatiten **pyetje specifike gjatë inspektimeve**, duke e planifikuar inspektimin në bazë të parimeve dhe praktikave të mira të pritshme, si dhe duke marrë parasysh atë që dihet për subjektin në fjalë. Pyetjet duhet të jenë shumë specifike për rrethanat e subjektit dhe duhet të jenë specifike për çdo inspektim.

5.11 Për vlerësimin e shoqërisë administruese ka katër grupe parimesh dhe, si rrjedhojë, katër FPMV. Ka një grup të mëtejshëm parimesh (dhe FPMV) për depozitarët. Parimet janë dhënë në Kapitullin 3 të këtij manuali.

Formularët e Planifikimit të Mbikëqyrjes dhe Vlerësimit (FPMV)

5.12 Qëllimi i FPM-ve është që të identifikojnë të dhënat që nevojiten për të testuar secilin parim. Dokumentet e FPMV-së, për secilin parim janë:

- Teksti i vetë parimit;
- Rezultatet e analizës së dokumenteve të lidhur me çdo praktikë të mirë - duhet theksuar se do të ketë shumë praktika të mira për të cilat nuk ka analiza dokumentesh specifike, edhe pse burimet më të përgjithshme të analizave në vend, të tilla si raportet e auditimit, mund të jenë të rëndësishme për gamën e plotë të praktikave më të mira. Ka pak vlerë që FPMV-të të plotësohen me burime të tilla të përgjithshme, në përjashtim të rastit kur, për shembull, dihet se auditimi i brendshëm i jep vëmendje të veçantë e të rëndësishme një praktike të mirë; të dhëna përkatëse nga burime të përgjithshme duhet t'i shtohen FPMV-së nën këtë kolonë gjatë fazës së planifikimit të inspektimit;
- referenca për dokumentimin e analizave të dokumenteve;
- Implikimet e rezultateve të analizave dokumentare për planifikimin e intervistave dhe testimin e programit në vend; për shembull, këto analiza mund të vënë gishtin tek diçka që ka nevojë për ekzaminim të mëtejshëm në vend, ose mund të tregojnë se mund të jetë i nevojshëm testimi i ca praktikave më të mira;
- Nxitje lidhur me linjat e pyetjeve që mund të ndiqen gjatë intervistave, duke përfshirë aspektet e praktikave më të mira në mbështetje të çdo parimi;
- Dokumentet apo procesin / kontrollat që mund të testohen për të siguruar dëshmi mbështetëse për konkluzionet e nxjerra;
- Referenca të shumëfishta për të mbështetur intervistat në vend dhe testimin;
- Referenca të shumëfishta për parimet e tjera, qoftë në këtë FPMV ose në një tjetër, ku rezultatet e inspektimit të këtij parimi mund të përdoret edhe si dëshmi në vlerësimin e një parimi tjetër. FPMV-të e mbushura paraprakisht do të tregojnë se ku këto referime janë më të mundshme;
- Përfundimet e përgjithshme nga testimi i dokumenteve, nga testimi në terren dhe nga intervistat (ndikimit dhe probabilitet);
- Arsyet për përfundimet;
- Rekomandime për menaxhimin e subjektit; dhe
- Ndryshime që sugjerohen në qasjen ndaj inspektimit për vitin e ardhshëm, që dalin nga ky kontroll, për shembull, përmirësime në analiza apo testim, apo çështje që mund të hulumtohen ose ndjekur më tej.

5.13 Në fund të çdo flete pune jepet një rresht që do të përdoret për të dokumentuar vlerësimin e parimit, për çdo parim. Formulari në Tabelën 3.1 duhet të përdoret për të kombinuar vlerësimet e çdo parimi në vlerësimin e plotë të rrezikut për shoqëritë administruese. Për depozitarët, FPMV përkatëse, në Tabelën 5.5, shtohet.

Vlerësimi i lidhur me kategoritë e rrezikut dhe qeverisjen e shoqërisë administruese

5.14 Ka katër FPMV për shoqëritë administruese, të cilat harmonizohen me parimet e mbikëqyrjes dhe mbulojnë:

- Qeverisja (Prova 5.1 Excel)
- Zbutja e rrezikut të investimit (Prova 5.2 Excel)
- Zbutja e rrezikut operacional (Prova 5.3 Excel)
- Zbutja e rrezikut të biznesit (Prova 5.4 Excel)

5.15 Për tre FPMV-të e fundit, në lidhje me kategoritë në kuadër të rrezikut të pensioneve të zbutur në shoqëritë e pensione, çdo kategori rreziku ka një fletë pune korresponduese brenda dosjes së FPMV-së. Në shumicën e rasteve ka më shumë se një parim në fletën e punës. Vlerësimet e këtyre parimeve janë të kombinuara për të dhënë vlerësime për kategorinë e vetë rrezikut. Prandaj këto FPMV dokumentojnë punën që do të ndërmerret për të vlerësuar rrezikun dhe rezultatet e vlerësimit. Ndërsa jepen pyetje të detajuara për të ndihmuar në identifikimin e llojeve të ndryshme të praktikave të mira, që mund të kontribuojnë në vlerësimin e përgjithshëm të zbutjes së rrezikut, vlerësimi i zbutjes së rrezikut përqendrohet tek rreziku i përgjithshëm. Prandaj, jo çdo pyetje potenciale apo praktikë e mirë sugjeruar nga informacioni i dhënë duhet të hulumtohet për arritjen e një vlerësimi në përputhje të plotë.

5.16 Trajtimi i qeverisjes është paksa i ndryshëm. Qeverisja është potencialisht një zbutje për të gjitha rreziqet, edhe pse, siç shpjegohet në Kapitullin 3 [veçanërisht paragrafët 3.22 dhe Figura 12ç jo çdo parim i qeverisjes mund të jetë i rëndësishëm për çdo rrezik. Në çdo rast të gjashtë parimet e qeverisjes përfshihen në FPMV-të për qeverisjen, edhe pse vlerësimi i përgjithshëm i qeverisjes duhet të dokumentohet në formularin në Provën 5.1.

5.17 Ndërsa investimi është një funksion bazë (i brendshëm) i shoqërive administruese, siç është menaxhimi i rreziqeve që lidhen në mënyrë specifike me shoqërinë, disa funksione të tjera operative që i mbështesin shoqëritë jepen me nënkontraktim tek shoqëria mëmë. Funksione të tilla mund të përfshijnë mbajtjen e shënimeve, infrastrukturën e IT-së dhe auditimin e brendshëm. Prandaj, objektivi për qeverisje dhe menaxhim rreziku të fondit është mbikëqyrja se sa mirë këto funksione i ofrohen fondit, ngritja e çdo mangësie me shoqërinë mëmë, dhe jo të kontrollohen funksionet. Shtojca 2 në këtë Manual përfshinë udhëzime të veçanta për vlerësimin e rrezikut nga nënkontraktimi.

HAPI 1: Planifikimi i inspektimeve në vend

5.18 Planifikimi i çdo inspektimi të një shoqërie administruese ose depozitar mund të dokumentohet duke përdorur një memo planifikimi të inspektimit. [Prova 5.2], mbështetur nga Formularët e Planifikimit të Mbikëqyrjes dhe Vlerësimit (FPMV-ve), gjysmë të përfunduar, për rreziqet që inspektohen. Memorandumi është kritik për shkak se ai përcakton kornizën për të gjithë punën që do të bëhet në shoqëri. Ekipi për mbikëqyrjen e fondeve të pensionit duhet të takohen për të rënë dakord për përmbajtjen e memo, të paktën gjashtë javë përpara datës së planifikuar për fillimin e inspektimit.

5.19 Pika e fillimit për planifikim është specifikimi për inspektimin që përmbahet në strategjinë tre-vjeçare. Kjo identifikon rreziqet që do të inspektohen në çdo njësi. Ekipi duhet të shqyrtojë nëse informacioni, përfshirë edhe rezultatet e analizave të dokumenteve, i marrë që nga koha e përgatitjes së planit të inspektimit dhe analizës, ka ndryshuar lidhur me çfarë duhet inspektuar. Ai duhet të identifikojë gjithashtu edhe

veprimet e rëna dakord më parë për përmirësimin (shih në vend Hapi 5), të cilat duhet të ndiqen më tej.

5.20 Rreziqet që do të inspektohen dhe masa në të cilën do të vlerësohet qeverisja duhet të reflektohen në memo. Detajet mbështetëse duhet të dokumentohen në kohën e duhur në Formularët Planifikimit të Mbikëqyrjes dhe Vlerësimit.

5.21 Drejtuesi i ekipit sipas udhëzimit të inspektimit pastaj duhet të vendosë:

- Cilët anëtarë ekipi do të marrin pjesë në inspektim dhe kush do të jetë përgjegjës për vlerësimin e cilit rrezik dhe qeverisjeje (për shoqëritë);
- Koha e saktë;
- Cilët punonjës të subjektit të mbikëqyrur do të intervistohen në fazën e parë të inspektimit; dhe
- Cilët dokumente duhet t'i ofrojë paraprakisht ekipit njësia ekonomike (nëse ka), dhe cilat duhet të vihen në dispozicion gjatë inspektimit.

5.22 Në këtë fazë, ekipi duhet të mendoj dhe për testimin dhe verifikimin e procedurave në vend, që ata të presin të realizojnë pas intervistave të nivelit të lartë, në mënyrë që të bëhet njoftimi paraprak për strukturat drejtuese të subjektit lidhur me çfarë ata duan t'u vihet në dispozicion. Ekipi duhet ta bëjë këtë duke përdorur FPMV-të. Shtrirja e këtyre testeve nuk mund të finalizohet deri pas raundit të parë të intervistave, por ekipi duhet të ketë një ide paraprake të mirë lidhur me llojet e testit që do të nevojiten. Qëllimi i testimit mund të jetë të:

- Konfirmojë ekzistencën dhe përmbajtjen e dokumenteve që kanë të ngjarë të marrin strukturat drejtuese në mbështetje të deklaratave në lidhje me praktikën më të mirë që ato ndjekin - këto duhet të reflektohen më parë në FPMV;
- Kontrollujë për ekzistencën dhe përditësimin e të dhënave të domosdoshme, sidomos ato që përdoren për të gjeneruar të dhëna për analizën e dokumenteve;
- Testojë procedurat e kontrollit që janë thelbësore për identifikimin e masave zbutëse të rrezikut;
- Kontrollujë që veprimet e premtuara për zbatim nga subjekti janë zbatuar; dhe
- Testojë sistemet e TI-së dhe ushtrijë kontrollet përkatëse për masat zbutëse të rrezikut që po përpiqet të verifikojë ekipi.

5.23 Drejtuesi i ekipit është përgjegjës për finalizimin e memos dhe për të kërkuar autoritet nga Drejtori i Mbikëqyrjes nëse propozohen shmangie të konsiderueshme nga plani trevjeçar. Prezumimi duhet të jetë që të paktën tre anëtarë të stafit të AMF-së duhet të marrin pjesë në një inspektim, në mënyrë që rolet e ndryshme të mund të ndahen ndërmjet anëtarëve të grupit. Në të vërtetë, për një inspektim të plotë të shoqërisë administruese, do të preferoheshin katër anëtarë të AMF-së. Nëse do të përfshihen specialistë të tilla si ekspertët e IT-së, mund të duhen dhe më shumë vetë.

5.24 Memo e planifikimit duhet të nxjerr në pah çështje të rëndësishme që kanë dalë për ndjekje nga inspektimet e mëparshme në vend, analiza të dokumenteve apo raportet e auditimit të jashtëm apo të brendshëm. Ekipi i inspektimit duhet, në mënyrë të veçantë, të jetë i vetëdijshëm për çdo çështje të ngritur nga auditori i jashtëm i njësive ekonomike dhe për statusin aktual të këtyre çështjeve, si dhe duhet të ketë një kopje të letrës së

menaxhimit nga audituesi, ku audituesi përmbledh çdo çështje që duhet të korrigjohet nga institucioni. Ekipi duhet të shqyrtojë mundësinë e kontaktimit të audituesit të jashtëm të njësisë ekonomike përpara inspektimit, nëse besohet se diskutimi me të mund të japë informacion shtesë për të ndihmuar zbatimin e inspektimit. Në qoftë se është organizuar një takim i tillë, subjekti duhet të ftohet të dërgoj një përfaqësues të saj në takim. Takimi me audituesin e brendshëm të njësisë ekonomike zakonisht planifikohet gjatë javës së parë të inspektimit, por nëse takimi është i pamundur në këtë kohë, ai duhet të mbahet më herët.

Kërkesat paraprake të inspektimit

- 5.25 Është e rëndësishme për efikasitetin e procesit të inspektimit që ekipi të kontaktojë me administratën e subjektit (të paktën pesë javë) përpara kohe, në mënyrë që të njoftohen për çdo informacion specifik AMF në lidhje me kërkesat, për të cilat duhet kohë për përgatitje dhe është e rëndësishme që informacioni të arrijë tek AMF më shumë se një javë përpara inspektimit. Nëse nuk bëhet njoftimi paraprak, mund të humbet kohë e çmuar. Duhet të mbahet parasysh se strukturat e menaxhimit të subjektit janë të zëna dhe do ta vlerësonin nëse do të merrnin njoftim paraprak në lidhje me informacionin që u nevojitet inspektorëve. Një qasje që shpesh funksionon mirë për inspektorët është që, në vend që t'i kërkohej njësisë ekonomike që të prodhojë dokumente ose raporte të veçanta, t'i shpjegohet strukturave drejtuese se çfarë informacioni kërkohej dhe më pas t'u kërkohej atyre se çfarë informacioni kanë dhe çfarë informacioni mund të ofrohet. Kjo qasje mund të fitojë respekt dhe të ndërtojë besimin mjaft shpejt, duke i bërë inspektimet më të lehta si për subjektet dhe për AMF-në.
- 5.26 Kur plani është dakordësuar nga kreu i ekipit të mbikëqyrjes, ai/ajo duhet t'i shkruajë njësisë ekonomike që jep detaje për stafin, kohën dhe informacionin që nevojitet, siç përcaktohet më sipër. Letra duhet të kërkojë që njësia ekonomike ta njoftojë AMF-në se cilin person cakton njësia ekonomike si përgjegjës për të koordinuar inspektimin. Informacioni i dërguar paraprakisht duhet të kërkohej që të dorëzohet të paktën një javë përpara fillimit të inspektimit. Çdo vonesë në paraqitjen e informacionit duhet të ndiqet menjëherë me koordinatorin e njësisë ekonomike.

Përgatitja e pyetjeve dhe e testeve

- 5.27 Gjatë javës përpara inspektimit secili anëtar i ekipit të cilit i janë caktuar rreziqet ose parimet e qeverisjes që do të vlerësojë, duhet të përgatisë linjat e pyetjeve për secilën prej intervistave të planifikuara, duke u bazuar në informacionin tashmë të disponueshëm, për AMF-në dhe të dhënat paraprake nga subjekti. Kjo është detyrë e rëndësishme që nuk duhet neglizhuar, pasi tek ajo mbështetet suksesi i mundshëm i procesit të intervistimit. Më shumë detaje rreth kësaj pike jepen në seksionin tjetër. Duhet të mblidhet dhe dokumentacioni i nevojshëm për të realizuar testimin në terren.
- 5.28 Hapi i parë është identifikimi se cilat fletë pune të FPMV-së janë të rëndësishme për inspektimin, duke mbajtur parasysh rreziqet që do shqyrtohen. Fletët e punës për rreziqet që nuk po shqyrtohen mund të shënohen si të tilla, por duhet të mbahen si pjesë e

dokumentacionit të inspektimit në rast se provat e mbledhura gjatë inspektimit identifikojnë çështje që duhet të ndiqen ose vlerësohen në këto rreze. Nëse nuk po bëhet një inspektim i plotë i qeverisjes së shoqërisë administruese (paragrafi 5.3 më sipër), FPMV-ja për qeverisjen mund të përdoret në nivelin e parimit për të regjistruar ndryshimet e bëra në vlerësimin e mëparshëm që rrjedhin nga puna e ndërmarë.

5.29 Anëtarët e ekipit më pas duhet të mbledhin dëshmi nga analizat e dokumentacioneve, duke përfshirë çdo raport auditimi dhe ankesa të pranuar, që sipas FPMV-së janë të rëndësishme për çdo parim dhe praktikë të mirë, dhe të marrë parasysh se çfarë implikimi ka prova në vend, nëse ka. A i jep ajo linjat e duhura të pyetjeve? A etiketon ndonjë testim shtesë të nevojshëm? A e heq nevojën për të testuar ekzistencën e praktikave më të mira, sepse tregon se tashmë është duke u ndjekur?

5.30 Pastaj linjat e pyetjeve duhet të përgatiten për intervistat me anëtarët e këshillit mbikëqyrës dhe zyrtarë të tjerë të lartë. Formularët e Planifikimit të Mbikëqyrjes dhe Vlerësimit (FPMV) sigurojnë informacion të përgjithshëm për linjat e pyetje, të cilat mund të ndryshohen për të marrë në konsideratë informacione specifike lidhur me njësinë ekonomike. Ekziston një prirje e natyrshme që në qoftë se dikujt i bëhet një pyetje e përgjithshme, ai/ajo që do të japë një përgjigje të përgjithshme rreth asaj që i intervistuari mendon se do të dëgjojë intervistuesi. Për këtë arsye, i intervistuari mund të përshkruaj praktika ideale jo praktikën aktuale. Por fokusi duhet të jetë tek ngjarjet aktuale dhe çfarë në fakt ka ndodhur në situata reale. Prandaj, ekipi duhet të identifikojë paraprakisht vendimet ose situatat në të cilat përfshihet i intervistuari, të cilat do t'i bëjnë të mundur të intervistuarit të përshkruajë se çfarë ka ndodhur me të vërtetë. Linjat e tilla të marrjes në pyetje për një shoqëri administruese mund të përfshijnë, për shembull:

- Si është zhvilluar një strategji e veçantë, në bazë të çfarë prove dhe diskutimi dhe për çfarë qëllimesh - Sa të bashkuar kanë qenë këshilli mbikëqyrës / komiteti i investimeve në pikëpamjen e tyre?;
- Si ka vendosur këshilli mbikëqyrës të bëjë një ndryshim të veçantë për të financuar investimet dhe çfarë mundësish janë marrë parasysh. Çfarë vendimesh morën ata dhe pse. Sa e kanë monitoruar nëse vendimi i marrë ishte vendimi i drejtë?;
- Çfarë ka ndodhur kur ka qenë e qartë se një anëtar i këshillit mbikëqyrës, anëtar i komitetit të investimeve ose menaxher kishte konflikt interesi - në çfarë mase ajo që u bë ishte në përputhje me politikën e shoqërisë për konfliktin e interesave dhe çfarë është bërë saktësisht për ta shmangur vendimmarrjen nga persona me një konflikt aktual apo të perceptuar mbi çështjen;
- Kur ka qenë hera e fundit kur këshilli mbikëqyrës ka shqyrtuar nëse anëtarët e tij kanë njohuri dhe kuptim të mjaftueshëm për të përmbushur përgjegjësitë e veta, si dhe për të realizuar funksionimin e këshillit në përgjithësi; si u bë vlerësimi dhe çfarë bëri në lidhje me të;
- Çfarë e ka shqetësuar këshillin mbikëqyrës në rastin më të fundit kur u bisedua për profilin e rrezikut të njësisë ekonomike ose të fondit, dhe mbi çfarë bazash. Çfarë u identifikua prej tij si rrezik më i madh, sa u nda ky kuptim i përbashkët dhe çfarë ka në plan të bëjë në lidhje me rreziqet e patolerueshme;
- Aty ku ka pasur dështim të madh të kontrollit, si u informuan saktësisht subjekti dhe këshilli mbikëqyrës për dështimin; çfarë vendosën të bënin rreth kësaj situate dhe si kanë kontrolluar që zbutja ka qenë efektive; dhe

- Çfarë ka bërë këshilli mbikëqyrës, apo menaxherët e njësive, për të kontrolluar se shoqëria mëmë ka sisteme dhe kontrole efektive për të siguruar ofrimin me efikasitet të një funksioni të caktuar të nënkontraktuar në mënyrë efikase, efektive dhe me rrezik minimal për njësinë ekonomike ose kontribuesit .

5.31 Udhëzime të mëtejshme për formulimit e pyetjeve jepen në Hapin 2 (raundi i parë i intervistave) më poshtë.

5.32 FPMV për inspektim duhet të pajisen me këto linja pyetjeje. Ato mund të përdoren edhe për të identifikuar ose për të konfirmuar lidhjet me parimet e tjera, ku rezultatet e intervistimit apo testimit për një parim të ndihmojnë në vlerësimin e parimit tjetër. Për shembull, të treguarit se si është trajtuar një konflikt interesi kur u bë miratimi i një strategjie mund të ndihmojë të vlerësojë dy parime të qeverisjes.

5.33 Lidhjet ndërmjet FPMV-ve janë të rëndësishme. Mund të shihet nga linjat e marrjes në pyetje, përmendur më sipër, se të gjitha pyetjet në lidhje me ngjarje reale ka të ngjarë të jenë të rëndësishme si për vlerësimin e qeverisjes dhe për vlerësimin e një (ose më shumë) rreziqesh në kuadrin e rreziqeve. E thënë ndryshe, cilësia e qeverisjes së zbutjes së një rreziku mund të vlerësohet në të njëjtën kohë dhe me vlerësimin e zbutjeve të tjera të rrezikut, dhe mund të ndihmojë për të nxjerr konkluzione në lidhje me qeverisjen që mund të përdoret për vlerësimin e të gjitha rreziqeve përkatëse. Për këtë arsye, në përgatitjen e FPMV-ve ekipi mbikëqyrës duhet të bjerë dakord se cilat parime zbutjeje të rrezikut do të testojë si pjesë e vlerësimit të çdo parimi të qeverisjes.

5.34 Mund të ndodhë që të gjitha parimet e zvogëlimit të rrezikut që mbulohen nga intervistat të mund të mbulohen nga linja pyetjesh të përqendruara tek qeverisja, dhe që shqyrtimi i qeverisjes të mund të shtyjë procesin. Figura 13, në Kapitullin 3, tregon lidhje të mundshme ndërmjet parimeve në formatim e matricës. Lidhjet e treguara nuk janë shteruese.

5.35 Seksioni i FPMV-ve që lidhet me testet në vend mund të duhet të përditësohet për të pasqyruar dokumente ose kontrole shtesë që mund të dëshirojë të verifikojë ekipi pas studimit të informacionit të dhënë paraprakisht dhe të formuluar në linjat e detajuara të pyetjeve. Në këtë fazë duhet të jetë i përgatitur dhe të vihet në dispozicion të koordinatorit të njësisë ekonomike për inspektim një program i përkohshëm për intervistat dhe testimin, pas përfundimit të raundit të parë të intervistave. Informacioni i mbledhur si pjesë e procesit të planifikimit përpara inspektimit duhet të përdoret për të përditësuar profilin e rrezikut të njësisë sipas rastit.

Aspekte specifike për inspektimet e depozitarit

5.36 Planifikimi i një inspektimi tek depozitari është një proces shumë i ngjashëm me planifikimin e një inspektimi në shoqërinë administruese, përveç se ka vetëm një FPMV të vetme që i mbulon të gjitha parimet depozituese (Prova 5.5, Excel), dhe çdo çështje që lidhet me qeverisjen mbulohet nga këto parime dhe nëpërmjet lidhjes me mbikëqyrësit bankarë.

HAPI 2: Ndërmarrja dhe dokumentimi i inspektimeve në vend

5.37 Aktivitetet gjatë inspektimit në terren janë si më poshtë:

- Takim prezantues;
- Raundi i parë i intervistave me shoqërinë administruese;
- Takimi i ndërmjetëm i ekipit;
- Procedurat e testimit dhe verifikimit;
- Intervistat pasuese të nevojshme;
- Vlerësimi përfundimtar; dhe
- Takimi përmbyllës .

Dy aktivitetet e fundit të këtyre aktiviteteve mbulohen përkatësisht në Hapin 3 dhe 4.

Takimi fillestar

5.38 AMF mund ta konsiderojë të vlefshëm fillimin e inspektimit me një mbledhje të shkurtër hapjeje me administratën e lartë të subjektit. Për një depozitar, ky duhet të jetë menaxheri i lartë përgjegjës për funksionin e depozitarit dhe për një shoqëri administrimi duhet të jetë të paktën Administratori dhe Kryetari i Këshillit. Në këtë takim, ekipi duhet të shpjegojë se si do të kryhet inspektimi dhe se çfarë kërkon të realizojë ekipi. Në të duhet të përfshihet dhe një pasqyrë e shkurtër e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, dhe se si inspektimi është brenda kuadrit të strategjisë së AMF-së. Ekipi duhet të bëjë një përmbledhje të praktikave të mira në menaxhimin e rrezikut dhe qeverisjes që ai kërkon të verifikojë dhe duhet të sigurohet që strukturat drejtuese të kenë një kopje të parimeve mbikëqyrëse përkundrejt të cilave do të bëhet inspektimi. Një mbledhje e tillë mund të mos jetë e nevojshme për subjekte të vogla ose mund të kombinohet me intervistë me Administratorin e Përgjithshëm/CEO (Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv) nëse mbahet si intervistë e parë.

5.39 Ekipi duhet të sigurojë që të zgjidhen të gjitha çështjet e lidhura me çështje pezull që kanë të bëjnë me kohën e takimeve dhe testimin. Ai duhet ta ftojë njësinë ekonomike të ngrejë shqetësimet e përgjithshme që mund të ketë dhe nëse ka pyetje lidhur me procesin dhe metodologjinë.

Raundi i parë i intervistave

5.40 Takimi i parë pasohet nga takime më të detajuara të projektuara për të vlerësuar menaxhimin e rrezikut dhe qeverisjen.

5.41 I vetmi aspekt i qeverisjes përkatëse për një depozitar është shkalla në të cilën menaxhimi mbikëqyr kuadrin e kontrollit të brendshëm dhe siguron që ai është efektiv. Për këtë arsye, duhet të mjaftojë një takim i vetëm me ekipin menaxhues të depozitarit dhe një takim me audituesin e brendshëm. Këto takime mund të jenë të mjaftueshme dhe për inspektimin e shoqërisë administruese, e cila nuk po e shqyrton në detaje qeverisjen. Takimi i thelluar me strukturat drejtuese në këto raste mund të kombinohet me takimin e parë, nëse është e mundur.

5.42 Kur qeverisja e shoqërisë administruese është objekt vlerësimi më i detajuar, ekipi duhet të synojë të takohet individualisht me secilin prej zyrtarëve kryesorë të shoqërisë (ose në qoftë se nuk është e mundur, në grupe nga dy vetë), në mënyrë që njohuritë dhe perceptimet e secilit të mund të testohen për të siguruar një pamje më të plotë. Pyetjet që i bëhen secilit prej tyre mund t'u përshtaten roleve të tyre specifike. Zyrtarët kryesorë të shoqërisë administruese për qëllime të qeverisjes janë:

- Tre deri në pesë anëtarë të këshillit mbikëqyrës, njëri prej të cilëve është edhe administratori dhe një ose dy prej të cilëve janë anëtarë të pavarur në praktikë;
- Shefat e zyrës së pararojës, së mesme dhe të pasme;
- Menaxheri i këshillit të shoqërisë mëmë, i cili është i pranishëm në mbledhjet e këshillit mbikëqyrës, dhe që mund të klasifikohen si anëtar 'kontrollues' në ligj; dhe
- Audituesi i brendshëm.

5.43 Në ngjarjen shumë të mundshme, kur inspektohen rreziqet e investimeve, ekipi duhet të takohet edhe me anëtarët e komitetit të investimeve, por edhe pse ata janë anëtarë të këshillit mbikëqyrës apo menaxherë, përmendur dhe më sipër, kjo mund të rrisi numrin e takimeve.

5.44 Për çdo mbledhje duhet të planifikohen dy orë, plus të paktën gjysmë ore për diskutim përmbledhës më pas përveçse tre orë janë të preferueshme për intervistën e Administratorit të Përgjithshëm/CEO (Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv). Kjo do të thotë se maksimumi i intervistave që mund të bëhen në ditë është tre dhe se në një shoqëri administruese programi i plotë i intervistave ka të ngjarë të marrë pjesën më të madhe të javës së parë.

5.45 Pas shpjegimeve dhe pyetjeve hyrëse, secila intervistë duhet të bazohet në linjat e pyetjeve të identifikuar gjatë planifikimit përpara inspektimit. **Qasja ndaj intervistave paraqet një ndryshim të madh për AMF-në dhe për vetë subjektet.** Stafi AMF-së duhet të jetë i trajnuar dhe të ketë njohuri për t'i realizuar pyetjet në mënyrë efektive. Qasja duhet të shpjegohet në mënyrë të qartë për strukturat drejtuese të subjektit në letrën që i është dërguar paraprakisht përpara inspektimit dhe në takimin e parë.

5.46 Në formulimin dhe bërjen e pyetjeve dhe gjatë shqyrtimit të përgjigjeve, ekipi i inspektimit duhet të kërkojë të konstatojë **substancë dhe jo formë**. Për të qenë të suksesshëm, duhet të theksohen pikat e mëposhtme:

- Bëju të ditur të intervistuarve paraprakisht se cilat janë temat e gjëra që do të mbulohen, në mënyrë që ata të jenë në gjendje t'i përgjigjen pyetjeve. Informacioni duhet t'u dërgohet me shkresë përpara inspektimit dhe në takimin e parë;
- Mundohuni të aplikoni njohuritë e marra nga analiza e dokumenteve, procesverbalet e bordit ose dokumentet e shqyrtuara që më parë për të formuluar pyetje të sakta, kontrolloni njohuritë e detajuara dhe vëreni "në qendër të vëmendjes të intervistuarin";
- Bini dakord për rolet specifike të anëtarëve të ekipit gjatë çdo interviste, si më poshtë:
 - Kush i bën pyetjet përgatitura për secilin subjekt;
 - Kush duhet të jetë gati për të bërë pyetje shtesë kur nga një përgjigje nuk jepet informacion i mjaftueshëm;

- Kush regjistron përgjigjet për secilën lëndë; dhe
- Kush është udhëheqësi i ekipit, i cili duhet t'i orkestrojë pyetjet dhe të përqendrohet në respektimin e dinamikës së takimit për të vëzhguar se çfarë nuk është thënë dhe çfarë ndodh me të vërtetë dhe duhet të jetë i përgatitur që t'i përgjigjet sfidave që mund të dalin nga të intervistuarit dhe të ndërhyjë për kthimin tek programi i pyetjeve nëse ka devijim nga pyetjet e planifikuara.
- Bëni pyetje të hapura, duke filluar me fjalë të tilla si 'si', 'çfarë', 'kur' ose 'pse', në mënyrë që i intervistuari të duhet të shpjegojë se çfarë ka ndodhur;
- Bëni pyetje që kërkojnë shembuj të veçantë - kështu që pyetjet duhet të jenë zakonisht në kohën e shkuar, për shembull "çfarë ndodhi kur ... 'ose' si e vendosët se ...";
- Planifikimi përpara inspektimit duhet ta ketë mundësuar ekipin të dijë se çfarë përgjigjesh priten prej të intervistuarve dhe të jenë në gjendje të hetojnë më tej me anë të pyetjeve shtesë kur përgjigjet janë të ndryshme ose duken të paplota ose të paqarta;
- pyetjet plotësuese duhet të përdoren në çdo rast për të marrë detaje të mjaftueshme për përgjigje bindëse dhe të rëndësishme;
- Pyetjet e mbyllura (po / jo) duhet të përdoren për të kërkuar konfirmim në rastet kur përgjigja është e paqartë, e veçantë apo të çuditshme, si dhe për ta detyruar të intervistuarin për të rënë dakord me interpretimin e AMF-së lidhur me çfarë ka ndodhur. Anëtarë i ekipit që merr shënime duhet të jetë i përgatitur të ndërhyjë me një pyetje të mbyllur në rastet kur shënimet janë të paqarta. Udhëheqësi i ekipit duhet të jetë i përgatitur të ndërhyjë me një pyetje të mbyllur kur është e rëndësishme të arrihet në një përfundim;
- Shmangini bërjes së ftesave për gjepura dhe të folurit për tema për të cilat struktura drejtuese ka opinione të forta ose fjalëshume.

5.47 Pikat kryesore që ngrihen në çdo takim duhet të dokumentohen menjëherë pas takimit. Është e dëshirueshme, të paktën derisa të filloj realisht mbikëqyrja e bazuar në rrezik, që ekipi të organizojë një takim të shkurtër pas çdo interviste për të rënë dakord lidhur me pikat kryesore të diskutimit. Kur informacionet e marra nga intervistat janë në të njëjtën linjë me përfundimet e FPMV-së, kjo duhet të përmendet në pikën përkatëse në FPMV-së. Duhet të përgatiten dhe të zbardhen minutat e takimeve, përveç rasteve kur bisedat janë regjistruar elektronikisht. I duhet dhënë rëndësi dhe të kërkuarit të marrëveshjes për regjistrimin e intervistës nga personi (at) objekt intervistimi; ata duhet të pyeten nëse është e mundur që regjistrimi të përdoren si dëshmi në procedura të mëvonshme.

Takimi i ndërmjetëm i vlerësimit

5.48 Pasi ka përfunduar raundi i parë i intervistave, ekipi duhet të organizojë një mbledhje të ekipit për të diskutuar gjetjet e përkohshme. Ajo duhet të marrë formën e një vlerësimi të parimeve përkatëse në FPMV, duke përdorur metodologjinë e shpjeguar në Kapitullin 3. Mbledhja nuk duhet të bëhet me rigorozitet të madh; konkluzionet dhe vlerësimet impresioniste duhet të mjaftojnë në këtë fazë. Qëllimi i vlerësimit në këtë fazë është që t'i bëjë të mundur ekipit të vendosë:

- Për një vlerësim provizor të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe zbutjes së rrezikut nga subjekti;
- Nëse, bazuar në provat në dispozicion, nuk nevojiten më disa elementë të testimit të planifikuar;

- Nëse ka zbutje shtesë që duhet të verifikohen përtej zbutjeve të planifikuara, të cilat do të duhet të dokumentohen;
- Nëse duhen intervista pasuese, ose intervista të tjera, të cilat nuk janë planifikuar; dhe
- Nëse nevojitet testim shtesë. Në fakt, mund të nevojiten më shumë prova kur ekipi arrin në përfundimin se duket se ka një dështim të rëndë, i cili mund të mos pranohet nga strukturat drejtuese nëse nuk ka prova të tjera, ose nëse duhen prova të mëtijshme për të mbështetur një hetim formal, ose një proces sanksionues.

5.49 Për këtë arsye, ndryshimet mund të jenë të nevojshme për të rënë dakord për programin e testimit në vend, rast në të cilin duhet të përgatitet një program i rishikuar për pjesën e mbetur të inspektimit. Shtesat dhe ndryshimet në program duhet të diskutohen me koordinatorin e inspektimit të njësisë ekonomike. Ndryshimet e rëndësishme duhet të miratohen nga udhëheqësi i ekipit të mbikëqyrjes së pensioneve dhe fondeve të investimit. Procesverbali i vlerësimit fillestar duhet të dorëzohet në formë elektronike.

Testimi në vend

5.50 Hapi tjetër për ekipin e inspektimit është kryerja e testimit dhe intervistave të tjera të nevojshme për të përfunduar inspektimin dhe për të mundësuar një vlerësim të rreziqeve dhe çështjeve të përcaktuara në memon e planifikimit të inspektimit. Ndërkohë që intervistat ofrojnë informacion lidhur me masat lehtësuese që mendohet të ekzistojnë në kuadër të subjektit të mbikëqyrur, ata nuk mund të japin prova bindëse për të vërtetuar se procedurat e përshkruara janë në të vërtetë funksionale. Një verifikim i tillë është i nevojshëm për sistemet dhe kontrollat mbi të cilat AMF-ja mbështetet kryesisht, ose kur ka dyshime të mëdha në lidhje me besueshmërinë e përgjigjeve të dhëna në intervista. Mund të jenë të nevojshme të futen në program dhe disa testime të tjera shtesë në rast se duhen më shumë të dhëna për të vërtetuar mangësitë në sisteme apo në kontroll, të cilat mund të jenë aq serioze sa të çojnë në sanksione ligjore, në mënyrë që të përforcojnë rastin (ose për të treguar që nuk është mjaft i fuqishëm).

5.51 Llojet e testimeve të mëposhtme që mund të përdoren në varësi të asaj që duhet të verifikohet:

- **Analizimi i raporteve që janë vënë në dispozicion nga subjekti i mbikëqyrur**, të cilat ofrojnë njohuri lidhur me mënyrën sesi është duke u menaxhuar dhe kontrolluar subjekti dhe çfarë informacioni nuk është në dispozicion në mënyrë rutinore në formë dokumenti. Shembujt mund të përfshijnë raportet e auditimit të brendshëm, shkresa të drejtuesve të brendshëm lidhur me ekspertët e jashtëm kontabël, procesverbalet e takimeve të këshillave dhe komisioneve dhe raportet informative për strukturat drejtuese.
- **Vëzhgimi**: Kjo metodë është e përshtatshme për të kuptuar se si, për shembull, një person nga stafi i "rregullon" rregulloret e brendshme për përdorim më të përshtatshëm, zakonisht në kryerjen e detyrave rutinë. Këto "rregullime" dhe rrugët e shkurtra mund të çojnë në përkeqësimin e riskut në njësi. Në këtë lloj testimi, punonjësi i tregon anëtarit të ekipit se çfarë hapash bën për kryerjen e një funksioni ose kontrolli me të dhënat reale, etj. Ky quhet ndryshe dhe "test shëtites". Mangësi e kësaj metode është që punonjësit mund të mos sillen siç sillen zakonisht.

- **Vizitat rastësore** janë të ngjashme me vëzhgimin në kuptimin që ato përdoren për të vëzhguar se si funksionojnë në praktikë proceset e punës, por në këtë rast në sistem hidhet një transaksion i caktuar për të parë nëse gjenerohen rezultatet e duhura në mënyrën e drejtë, dhe për të kontrolluar nëse aplikohen procedurat e duhura, për shembull, në rastin e futjes së një anëtarë të ri në skemën e pensioneve.
- **Verifikimi fizik** zakonisht kryhet për të verifikuar praninë ose mungesën, ose konformitetin, e disa objekteve materiale (fizike), me ndihmën e specialistëve të njësive ekonomike nëse është e nevojshme, si për shembull, për të verifikuar të dhënat fizike që mbahet nga një kompani pensionesh ose mjetet financiare të mbajtura nga një depozitar.
- **Krahasimi** mund të përfshijë krahasimin e të dhënave të dy ose më shumë bazave të të dhënave në një moment të caktuar në kohë. Si rregull kjo metodë nuk i njoftohet subjektit paraprakisht. Të dhënat mund të verifikohen përmes ekstrakteve të bazës të të dhënave të kërkuara në vend, ose me anë të verifikimit vizual të të dhënave në ekranet e kompjutrave. Ajo si alternativë mund të përfshijë krahasimin e një transaksioni të vërtetë të të dhënave me dokumentin origjinal. Kur vihen re dallime, është e nevojshme të kontrollohet nëse dokumenti origjinal është gabim. Është e rëndësishme të regjistrohen këto gabime, pasi zakonisht ato kundërshtohen nga njësia ekonomike në një datë të mëvonshme.
- **Analiza financiare ose analiza të llojeve të tjera** mund të përdoren për të zbuluar devijimet e shifrave, raporteve të caktuara, etj. nga niveli normal ose i pritshëm, i cili në vetvete mund të japë arsye për shqyrtim më të thellë të një procedure, kur të dhënat nuk janë në mënyrë rutinore në dispozicion në formë dokumentesh.

5.52 Rezultatet e të gjitha llojeve të testimeve në terren duhen të hidhen dhe të dokumentohen në FPMV-në përkatëse, me shënimet përkatëse lidhur me dokumentet më të detajuara të punës që nevojiten për të hedhur detajet e testimit (një fletë standarde për këtë qëllim është Prova 5.6). Volumi i nevojshëm i testimit është një çështje gjykimi që duhet të verifikohet nga lideri i ekipit. Vetëm një numër i vogël vrojtimesh, që janë rezultat i analizave të mëparshme dokumentare dhe të intervistave në vend, mund të jenë të nevojshme për të konfirmuar qëndrimin se sistemi dhe kontrollet funksionojnë sipas synimit. Aty ku AMF mund të duhet t'i provojë administratës dhe ndoshta gjykatës se sistemi nuk po funksionon, duhet të ndërmerren teste të mjaftueshme për të justifikuar gjetjen e inspektimit që dëshiron të realizojë AMF.

Intervistat pasuese

5.53 Intervistat pasuese mund të jenë të nevojshme me anëtarët e këshillit, drejtuesit apo stafin për të mbushur boshllëqet në njohuritë e AMF-së, për të konfirmuar pikat që janë të paqarta apo për të eksploruar më tej çështje që janë identifikuar. Këto intervista duhet të planifikohen me koordinatoren e inspektimit në njësinë ekonomike sa më shpejt që të identifikohet nevoja për to. Duhet të sigurohen arsyet për këto takime. Zakonisht mjafton që në takim të jenë të pranishëm dy anëtarët e ekipit. Këto takime duhet të regjistrohen në të njëjtën mënyrë si edhe takimet e raundit të parë.

HAPI 3: Vlerësimi i zbutjes dhe shqyrtimi i rreziqeve

5.57 Faza e parë e vlerësimit është vlerësimi i ndërmjetëm i shpjeguar më lart në hapin 2 në vend. Pa diskutim që kjo fazë është shumë e përgjithshme. Pas përfundimit të inspektimit, me përjashtim të takimit përmbyllës, ekipi i inspektimit duhet të bëjë një **vlerësim përfundimtar** më rigoroz të qeverisjes dhe rreziqeve të ekzaminuara, duke mbajtur një takim për këtë qëllim si dhe duke bërë dokumentimin e përfundimeve në FPMV-të përkatëse. Metodologjia për vlerësimin tashmë është shpjeguar në Kapitullin 3. Ajo duhet të dokumentohet në formularin në Provën 5.2.

5.58 Nëse janë gjetur probleme serioze, ekipi duhet të marrë në konsideratë gjithashtu nëse penalitetet ose ndërhyrjet janë të përshtatshme, duke pasur parasysh piramidën e zbatimit/shkallën e ndërhyrjes në Figurën 5 (Kapitulli 1) dhe proceset në Hapin 5 më poshtë. Mundësia e nevojës së kësaj mase duhet t'i dërgohet menjëherë Shefit të Mbikëqyrjes, dhe nëse është e nevojshme, dhe Drejtorit të Përgjithshëm, për të shqyrtuar nëse është e nevojshme ndërhyrja e menjëhershme dhe për të siguruar një shqyrtim fillestar të vendimit për nevojën e një përgjigjeje serioze.

HAPI 4: Raportimi dhe sigurimi i cilësisë

Verifikimi i gjetjeve dhe vlerësimi i tyre

5.59 Përpara vlerësimit formal të rezultateve të inspektimit, ekipi duhet të diskutojë në mënyrë informale gjetjet e tij kryesore me menaxherin e lartë të subjektit. Për të verifikuar se gjetjet nuk përfshijnë gabimet faktike ose lëniet jashtë për të njehsuar përgjigjen e mundshme të subjektit ndaj llojeve të konkluzioneve dhe rekomandimeve që mund të hartohen. Lideri i ekipit duhet të njoftojë gjithashtu Drejtorin e Mbikëqyrjes për të gjitha gjetjet serioze. Kjo duhet të paraqesë një bazë mjaft solide për dokumentimin dhe raportimin me shkrim.

Dokumentimi i gjetjeve të inspektimit

5.60 Volumi i kohës së nevojshme për të dokumentuar inspektimin nuk duhet të nënvlerësohet. Duhet të lejohen disa javë ndërmjet fundit të fazës në vend dhe përfundimit të draft-raportit të inspektimit. Dokumentacioni i mirë është thelbësor nëse gjetjet, në çfarëdo kohe në të ardhmen, sfidohen dhe paraqesin një evidencë të qartë për Drejtorin e Mbikëqyrjes se konkluzionet, në mënyrë të veçantë ato kritike, janë të bazuara mirë. Ai mund të ndihmojë gjithashtu në përgatitjen e inspektimeve të ardhshme. Paketa e dokumentacionit, e cila duhet të depozitohet në fund me informacione të tjera që ekipi ka në subjekt, duhet të përfshijë:

- Memorandumin e planifikimit për inspektim;
- Të dhënat e intervistave;
- Të dhënat e testimeve në vend;
- FPMV-të;
- Formulari i kombinuar për vlerësimin e rrezikut dhe qeverisjes; dhe
- Të dhënat/proces-verbali i mbledhjes përmbyllëse, siç është pranuar nga subjekti.

Draft-raporti i inspektimit – përgatitja dhe sigurimi i cilësisë

5.61 Sapo të ketë qartësi të mjaftueshme në lidhje me konkluzionet dhe rekomandimet e inspektimit, hartimi i raportit (zakonisht nga lideri i ekipit) mund të procedojë paralelisht me dokumentacionin e detajuar të gjetjeve të shpjeguara më sipër. Aty ku është e përshtatshme, ai duhet të përfshijë një draft të plan-veprimit të parë në mënyrë që subjekti të ndërmarrë veprime rikuperimi brenda shkallëve kohore të specifikuara. Lideri i ekipit duhet të paraqesë raportin tek Drejtori i Mbikëqyrjes për sigurimin e cilësisë. Ai/ajo duhet të verifikojë, në mënyrë të veçantë, që:

- Inspektimi ka mbuluar rreziqet, parimet e mbikëqyrjes dhe çështje të tjera (p.sh. ndjekja e rekomandimit) siç është planifikuar;
- Rezultatet janë dokumentuar në mënyrë të qartë ashtu siç duhet nga ky manual;
- Konkluzionet janë në përputhje me evidencën dhe konkluzionet negative mund të mbështeten nga evidenca e marrë;
- Rekomandimet japin përgjigje proporcionale dhe praktike për të gjitha problemet e identifikuar dhe janë në përputhje me rekomandimet e bëra në situata të ngjashme në inspektime të tjera përkatëse.

5.62 Lideri i ekipit më pas duhet të dërgojë draft raportin tek Administratori i Përgjithshëm për komente fillestare brenda një afati kohor një-javor. Qëllimi i saj është identifikimi i çështjeve të cilat janë adresuar tashmë, atyre që subjekti synon t'u adresohet (dhe si) dhe atyre që subjekti kundërshton. Ekipi duhet të takohet për të diskutuar përgjigjen dhe për të vendosur nëse dhe si ai do të ndryshojë konkluzionet dhe rekomandimet që do të paraqiten dhe qëllimin në lidhje me tolerancën për zërat e kundërshtuar.

Mbledhja përfundimtare dhe pranimi i konkluzioneve dhe rekomandimeve

5.63 Faza tjetër është mbajtja e një mbledhjeje formale (zyrtare) me administratën e lartë të subjektit. Për shoqëritë administruese, takimi duhet të bëhet me këshillin mbikëqyrës, ose me sa shumë anëtarë të këtij këshilli të jetë e mundur, por në çdo rast në takim duhet të jetë i pranishëm Kryetari dhe Administratori. Për depozitarët duhet të jetë i pranishëm menaxheri i përgjithshëm ose ekuivalenti i tij. Në çdo rast, Drejtori i Mbikëqyrjes mund të dëshirojë të marrë pjesë aty ku parashikohen aksione ose veprime zbatimi (shiko Hapin 5) ose ku ka pika të tjera delikate në lidhje me subjektin.

5.64 Paraqitja e ekipit duhet të përfshijë rekomandime të pjesshme për veprime korigjuese dhe njoftim paraprak të dënimeve ose formave të tjera të ndërhyrjes që parashikohen për subjektin. Përgjigjja e njësisë ekonomike për çdo përfundim dhe rekomandim

duhet të shqyrtohet me kujdes dhe mund ta bëjë ekipin që të bëj ndryshime tek përfundimet dhe rekomandimet. Në të vërtetë, mund të realizohet negociimi i një mënyre për të arritur gjerësisht objektivat e AMF-së, megjithëse në një mënyrë të ndryshme nga ajo e parashikuar nga AMF. Aty ku zgjidhja, megjithëse vërehet një përmirësim krahasuar me gjendjen më parë, nuk është plotësisht në përputhje me parimet e mbikëqyrjes, kjo duhet të bëhet e qartë, ndërkohë që pranohet se pozicioni i kompromisit duhet të shërbejë për kohën aktuale.

5.65 Negociimi mund të jetë i përshtatshëm sepse ekziston avantazh i konsiderueshëm kur AMF dhe njësia ekonomike bien dakord për përfundimet e inspektimit; në fakt, ky duhet të jetë qëllimi. Nëse njësia ekonomike nuk arrin të marrë masat e duhura përmirësuese, do të jetë më e lehtë të përshkallëzohet përgjigja e AMF-së në qoftë se ka marrëveshje me shkrim lidhur me praninë/ekzistencën e problemit. Kjo mund të jetë veçanërisht e rëndësishme në qoftë se masat përfshijnë hyrjen në lojë të gjykatave. Prandaj, ekipi i inspektimit duhet të mundohet të jetë fleksibël lidhur me mënyrën se si paraqiten gjetjet, në mënyrë që ato të pranohen nga njësia ekonomike. Por, ky fleksibilitet nuk duhet të komprometojë rekomandimet për ndryshim kur ka një dështim të madh në qeverisjen ose në ekspozimin ndaj rrezikut.

5.66 Duhet shënuar se AMF mund të jetë më fleksibël për veprimet që do të konvertonin një K në P sesa në lidhje me një mos-përputhje më serioze. “Plotësisht në përputhje” veçanërisht për qeverisje, është një standard i lartë, i cili kërkohet po aq shumë për përfitimin e AMF-së si kontribues. Arritja e saj i lejon AMF-së që të marrë mbështetje të konsiderueshme nga qeverisja dhe menaxhimi i rrezikut në subjekt dhe, në këtë mënyrë të reduktojë volumin e punës së ardhshme të nevojshme.

5.67 Një proces-verbal i mbledhjes duhet të përgatitet dhe, nëse subjekti ka pranuar ndryshimet përtej atyre që jepen në përgjigjen (et) e mëparshme duhet të kopjohet (dërgohet gjithashtu) tek subjekti për pranim nga ana e tij, e cila duhet të ndihmojë dhe në sigurimin e marrëveshjes me njësinë ekonomike lidhur me përmbajtjen e raportit të inspektimit. Raporti i takimit duhet të dorëzohet në formë elektronike.

Raporti Final

5.68 Sapo konkluzionet dhe rekomandimet të jenë paraqitur dhe ripunuar nëse ka qenë e përshtatshme, raporti mund të finalizohet dhe paraqitet tek CEO e AMF-së, i cili do ta dërgojë për shqyrtim në një nivel më të lartë dhe do t'ia dërgojë Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë administruese ose Drejtorit të Përgjithshëm të depozitarit.

5.69 Personat që e marrin raportin brenda njësisë ekonomike duhet të kthejnë përgjigje formale lidhur me raportin brenda një periudhe të caktuar në raport, zakonisht brenda katër javësh. Ata duhet të sigurojnë përfshirjen e një plani veprimi përfunduar me reagimet e tyre. Kur ka mosmarrëveshje në lidhje me faktet ose me praktikitetin e rekomandimeve, AMF-ja duhet të bëjë të pamundurën për të negociuar formulimin, pa kompromentuar pika të rëndësishme të parimit.

5.70 Pasi të jenë zgjidhur çështjet e diskutueshme, përgatitet **raporti përfundimtar i rishikuar**, i cili i dërgohet Bordit për marrëveshje me shkrim prej tij.

5.71 Më pas duhet të finalizohet vlerësimi i rrezikut të subjektit, duke marrë parasysh ndryshimet e miratuara brenda për brenda, ose me njësinë ekonomike, dhe futet në dosjen e subjektit të mbikëqyrur. Vlerësimi duhet të përbëj pikënisje për planifikimin e vitit të ardhshëm, dhe duhet të përdoret për rishikimin e vlerësimit të përgjithshëm të rreziqeve në sistem (hartat e rreziqeve). Ekipi mbikëqyrës duhet të nënvizojë dështimet që nuk janë vënë re më parë, ose që nuk janë përfshirë në mënyrë të qartë në kuadër të metodologjisë së vlerësimit dhe të kërkojnë kontrollimin për praninë ose jo të tyre në subjekte të tjera.

HAPI 5: Ndërhyrja dhe ndjekja në vijimësi

Përshkallëzimi i nivelit të ndërhyrjes në përputhje me nivelin e rrezikut

5.72 Siç shpjegohet në Kapitullin 1 (paragrafët 1.24-1.25) ashpërsia e masave të përcaktuara nga AMF-ja në vijim të një inspektim duhet të jetë në proporcion me nivelin e vlerësuar të rrezikut. Masat duhet të marrin gjithashtu parasysh nëse njësia ekonomike ka dështuar të marrë veprime efektive në vijim të rekomandimeve të mëparshme të AMF-së. Në disa rrethana, aspektet në lidhje me ndërhyrjen, përcaktuar më poshtë, mund të jenë të rëndësishme për probleme serioze të konstatuara nga analiza e dokumenteve, kur nuk ka kohë ose nuk është e përshtatshme të ndërmerret një inspektim urgjent në vend. Për shkak se raportet e inspektimit mbulojnë disa rreziqe, nivele të ndryshme përgjigjeje mund të jenë të përshtatshme për rreziqe të ndryshme. Raporti tek subjekti duhet ta bëjë të qartë se cilat çështje janë subjekt i kujt niveli përgjigjeje.

5.73 Në parim, ekziston nivel i ndryshëm i përgjigjes për çdo nivel (ngjyrë) rreziku të mbetur të vlerësuar - shih Figurën 32 më poshtë. Më shumë detaje për secilin nga këto nivele jepet më poshtë. Megjithatë, ka rrethana ku niveli i përgjigjes nuk lidhet drejtpërdrejt me vlerësimin e rrezikut të mbetur:

- Në qoftë se AMF-ja është e detyruar të përsërisë një rekomandim në mungesë të një përgjigjeje efektive, mund të jetë me vend që ndërhyrja të shkallëzohet deri në nivelin pasues të piramidës; për këtë arsye, piramida njihet shpesh dhe si shkalla e ndërhyrjes;
- Megjithatë, në çdo rast, duhet të merret një vendim edhe në lidhje me pozicionin e çështjes me ligjin, sipas AMF-së. Nëse këshillimi ligjor tregon se një sanksion i caktuar nuk përbën mjet efektiv ligjor në kuptimin e ligjit, atëherë ky sanksion nuk mund të jetë i përshtatshëm, por duke pasur parasysh se në qoftë se AMF percepton një rrezik shumë serioz, ajo duhet të ndërmarrë veprime me forcë, edhe në qoftë se rrezikohet humbja e çështjes; nëse humbet çështja, AMF duhet të ketë arsye shumë të forta për forcimin e kompetencave dhe pozicionit të saj;
- Nëse ka tregues të fortë se njësia ekonomike po merr aktualisht masa substanciale për të reduktuar nivelin e rrezikut, AMF-ja mund të dëshirojë të zgjidhë një ndërhyrje në një nivel më të ulët sesa tregohet, sepse një përgjigje e një niveli më të lartë do të dërgonte sinjale të gabuara në lidhje me besimin e njësisë ekonomike tek AMF;

- Drejtimi i rrezikut është i rëndësishëm. Nëse ai ka ardhur duke u ulur, mund të jetë me vend një përgjigje më një ngjyrë më pak intensive sesa tregohet në piramidë. Në qoftë se rreziku po përkeqësohet, mund të jetë e përshtatshme një kodim me ngjyra më të forta.

Figura 32: Piramida e zbatimit /shkalla e ndërhyrjes



5.74 Ndërhyrjet që janë të disponueshme në secilin nivel në Figurën 32 mund të zgjerohen më tej si më poshtë, duke u mbështetur tek zgjidhjet efektive që parashikohen në nenin 80-81 të Ligjit "Për Pensionet Vullnetare".

- Kur rreziku i mbetur është **i gjelbër**, autoriteti mund të këshillojë të licencuarin të ndërmarrë veprime të caktuara ose të përshtasë një drejtim të caktuar veprimi, për sa kohë nuk shkelen dispozitat e këtij ligji neni 80(3). Këshillimi duhet të jetë formal (dhe nëse është e mundur të bihet dakord në mënyrë formale me subjektin) nëse rreziku është me ngjyrë të gjelbër të lehtë dhe mund të jetë objekt përshkallëzimi tek niveli tjetër në rast se nuk përmbushen detyrimet. Në rastet kur rreziku i mbetur është me ngjyrë të gjelbër të errët, këshillimet janë informale dhe të pazbatueshme.
- Kur rreziku i mbetur është **i verdhë** ose kur ka përshkallëzim problemi nga ngjyra e gjelbër për shkak të mos marrjes së masave, zbatohet neni 80(2) (a). Në këtë rast AMF-ja "urdhëron të licencuarin të ndërmarrë veprime të nevojshme për të parandaluar ose korrigjuar shkeljet e këtij ligji dhe të rregulloreve të miratuara në zbatim të tij". Për këtë qëllim, parimet mbikëqyrëse do të konsiderohen se kanë forcën e ligjit. Megjithatë ligji e kërkon hartimin e një plani masash vetëm atëherë kur kapitali është i pamjaftueshëm¹⁴, edhe në këtë rast do të kërkohej

¹⁴Neni 80 (2)(b)

një plan veprimi. Mospërmbushja e masave të parashikuara në planin e masave, në varësi të domethënies së tyre, çon në përshkallëzimin në nivelin tjetër.

- (iii) Kur rreziku i mbetur është **portokalli**, ose kur një problem përshkallëzohet nga ngjyra e verdhë për shkak të mosmarrjes së një mase të caktuar, duhet të lëshohet një urdhër që i kërkon subjektit të marrë ose të mos marrë masa të caktuara specifike, dhe në qoftë se urdhri nuk respektohet gjatë një periudhe të arsyeshme kohore, do të vihet një gjobë në përputhje me nenin 101 ose 102 të Ligjit. Duhet të bëhet po ashtu e qartë se nëse inspektimi i rradsës tregon se nuk ka pasur përputhshmëri, atëherë duhet të bëhet përshkallëzimi në një nivel më të lartë për rrezikun. Nëse në vend të masës/masave, ose plus tyre, lejohet nga rrethanat, duhet të zbatohet neni 80(2)(c): “kërkon nga i licencuari kryerjen e një auditimi të veprimtarisë së të licencuarit, me shpenzimet e këtij të fundit, nga një auditues i zgjedhur nga autoriteti, shkarkimin e çdo audituesi të të licencuarit dhe emërimin e një tjetri, me afat të përcaktuar nga autoriteti”.
- (iv) Kur rreziku i mbetur është **i kuq**, ose kur një problem është përshkallëzuar nga ngjyra portokalli (ose e verdhë¹⁵) për shkak të mosmarrjes së masave në një nivel më të ulët, duhet të aplikohet një ose më shumë nga ndërhyrjet e mëposhtme, të cilat janë më të përshtatshme për uljen e nivelit të rrezikut:
 - a. Një gjobë mbështetur në nenin 94-104 të Ligjit, sipas rastit, duhet të aplikohet menjëherë nëse është e mundur, në përjashtim të rasteve kur ajo krijon shpërqendrim nga një ose më shumë masa të tjera të përshkruara më poshtë dhe të konsideruara si të nevojshme. Në rast se masa përfshin ndryshime në përbërjen e këshillit mbikëqyrës, gjopa ose sanksionet personale mund të jenë me vend pasi të jetë siguruar siguria e subjektit. Në rast se kompetenca për gjobë mbështetet vetëm në nenin 101 ose 102 lidhur me mospërmbushjen e urdhrave, duhet të nxirret një urdhër bazuar në nenin 81, i cili kërkon zbatim të menjëhershëm me gjobë për mospërputhshmëri;
 - b. Përveç gjobës mund të shqyrtohen dhe sanksione të tjera penale, kur mendohet se gjykata mund ta konsiderojë këtë masë si të përshtatshme;
 - c. Mund të lëshohet një urdhër mbështetur në nenin 81(dh) të Ligjit për t'i kërkuar të licencuarit të transferojë kontrollin e aseteve të një klase specifike, ose përshkrimin e një personi të miratuar nga Autoriteti;
 - d. Në rast se mungesa e ekspertizës mendohet si shkak i riskut, duhet të zbatohet neni 80(2)(ç), i cili “kërkon nga i licencuari, me shpenzimet e këtij të fundit, të emërojë një person që të këshillojë të licencuarin për veprimtarinë e tij dhe të raportojë pranë autoritetit, brenda tre muajve nga emërimi i këtij personi”;
 - e. Në rast se administratori ose një nënpunës tjetër i autorizuar shihet si shkak i rrezikut, ose si pengesë për ndreqjen e rrezikut, mund të lëshohet një urdhër në përputhje me nenin 81(g) ose (gj) të Ligjit për zëvendësimin ose heqjen e administratorit ose të nëpunësit tjetër;
 - f. Nëse ndikimi i padrejtë nga shoqëria mëmë shihet si shkak i rrezikut, ose dështimi për ndreqjen e saj, mund të lëshohet një urdhër bazuar në nenin 81(h) të Ligjit për heqjen e shoqërisë ndikuese;

¹⁵Zakonisht është e logjishme që niveli i riskut të përshkallëzohet në këtë nivel (nëse përshkallëzimi në portokalli dështon) vetëm atëherë kur ndikimi i mundshëm i riskut është i lartë, rast në të cilin çdo gjë që mund të çojë në uljen e riskut mund të jetë e nevojshme.

- g. Nëse Këshilli Mbikëqyrës nuk është i gatshëm të marrë masat e nevojshme, ose në rast se subjekti nuk ka likuiditet, zbatohet neni 80(2)(d) duke e vendosur të licencuarin në administrim të veçantë, me shpenzimet e këtij të fundit, duke emëruar një person tjetër për të marrë kontrollin e veprimtarisë së të licencuarit. Administratori me emërim të posaçëm do të jetë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Autoritetit dhe, me kufizimet e nevojshme, do të ketë të gjitha kompetencat e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve të kompanisë;
- h. Në rast se nuk konsiderohet e sigurt që fondi i pensioneve do të vijojë t'i marrë kontributet deri sa të jetë ulur rreziku, bazuar në nenin 80(2)(dh), AMF duhet të pezullojë tërësisht ose pjesërisht licencën e shoqërisë administruese, depozitarit ose miratimin e kontratës dhe të prospektit të fondit të pensionit;
- i. Në rast se nuk konsiderohet e sigurt për subjektin që të vijojë me ushtrimin e një ose të gjitha funksioneve të veta, AMF duhet t'ia heq plotësisht ose pjesërisht licencën shoqërisë administruese, depozitarit ose miratimin e dhënë për kontratat e fondit të pensioneve dhe të prospekteve të tij.

5.75 Në praktikë, për të mbrojtur interesat e kontribuesve, çdo revokim i licencës zakonisht shoqërohet me emërimin e një administratori të veçantë, si në rastet e pezullimit të licencës, në varësi të rrethanave përkatëse. Në Kutinë 9 më poshtë jepen disa shembuj.

Kutia 9: Shembuj të ndërhyrjeve që dalin nga lloje të ndryshme rreziqesh	
Ngjarje potenciale	Përgjigjja me ndërhyrje
1. Shoqëria mëmë e një depozitari po hyn në fazë likuidimi, ose është shumë pranë kësaj faze.	Pa dyshim që kemi të bëjmë me një rrezik të kuq. AMF-ja duhet të marrë nën kontroll depozitarin duke përdorur kompetencat që i jep neni 81 dhe po mbështetur në këtë ligj të urdhërojë shoqëritë administruese të fondeve të pensionit të prekura të kontaktojnë me një depozitar tjetër të cilit mund t'i transferohen asetet.
2. Disa prej aseteve të fondit të pensionit i janë transferuar në mënyrë të paligjshme një personi ose shoqërie tjetër.	Bëhet fjalë për një rrezik të kuq. Bazuar në nenin 80, AMF-ja duhet të emërojë drejtorin e SHAFP-së, dhe të pezullojë administratorin ekzistues në mënyrë që të parandalojë transferta të mëtejshme dhe të vlerësojë nëse SHAFP-ja duhet të mbyllë aktivitetin, apo të vijojë me tregtimin. Duhet masa dhe për kthimin e parave të tregtuara. Ose duhet përfshirja e policisë.
3. Agjentët e një SHAFP -je janë kapur për të dytën herë duke u shitur pensione personave jo të përshtatshëm për ta.	Ndërsa bëhet fjalë vetëm për një rrezik të verdhë, duke qenë se bëhet fjalë për një vepër të përsëritur, rreziku duhet të konsiderohet si rrezik portokalli. AMF mund të kërkojë një auditim të procedurave të shitjes, me kosto të SHAFP-së, në mënyrë që mund të forcohen këto procedura. Në çdo rast, ajo duhet të lëshojë një urdhër që i kërkon SHAFP-së që ta ndërpresë këtë praktikë, ose në të kundërt do të gjobitet.
4. Një SHAFP nuk ka marrë masa kur një punëdhënës nuk i ka paguar kontributet sipas skemës së kontributeve dhe punëdhënësi ka hyrë	Ky rrezik është të paktën rrezik portokalli dhe në skenarin ideal SHAFP duhet t'i sigurojë kontributet e pambledhura. Në rast se bëhet kjo gjë, mund të lëshohet një urdhër duke kërcënuar për gjobë në rast se nuk përforcohen

në fazë likuidimi, me pak gjasa që të paguaj kontributet e papaguara.	procedurat. Në rast se SHAFF-ja nuk vepron kështu, rreziku mund të kategorizohet si rrezik i kuq për shkak të qeverisjes së keqe dhe, nëse është e mundur, të vihet gjorbë.
5. Shoqëria mëmë i ka vendosur tarifa më të larta në mënyrë demonstrative SHAFF-së për shërbimet e ofruara, duke ulur kështu përfitimin e saj.	Bëhet fjalë për një risk të verdhë. AMF duhet të lëshojë një urdhër për ndërprerjen e tarifave të tepruara dhe kthimin e diferencës. Në rast se SHAFF nuk e respekton këtë urdhër, pa dyshim që rreziku duhet të përshkallëzohet në rrezik të kuq.
6. Kontrollat e papërshtatshme të IT-së për zbulimin e sulmimit të sistemit, duke marrë disa të dhëna të kontribuesve, por kjo gjë nuk është bërë publike.	Ky është rrezik (vetëm) portokalli; duhet të jetë e mjaftueshme për AMF-në të lëshojë një udhëzim që të forcohen kontrollat dhe një gjorbë për papërpunshmëri, ose të kërkojnë auditimin e kontrolleve përkatëse.
7. SHAFF-ja ka investuar një pjesë të konsiderueshme (të madhe) të aseteve të fondit në asete likuide, për shkak të mos kuptimit të drejtë të situatës	Në rastin më të pakët, ky është rrezik portokalli. Duhet të nxirret një udhëzim për përmirësimin e strategjisë dhe procesit të planifikimit të likuiditetit, me kërcënimin ose të një gjobe, ose mbase të emërimit të një administratori të pavarur për të mbikëqyrur përmirësimet, në rast se nuk do të merren masa të tjera menjëherë (dhe përshkallëzimin në nivelin e rrezikut të kuq). Qeverisja është kaq e keqe, saqë masa duhet të merret menjëherë.

5.76 Kur rekomandohen dënime apo ndërhyrje ligjore, të cilat miratohen nga Shefi i Mbikëqyrjes, dokumentacioni duhet t'i vihet në dispozicion Departamentit Ligjor për të marrë masat zbatuese të rëna dakord. Gjatë përgatitjes së dokumentacionit ekipi duhet të jetë i vetëdijshëm se ai duhet të përmbushë standardet e provave të kërkuara nga ky Departament. Për këtë arsye, të gjithë dokumentet përkatëse, përfshirë dhe email-in dhe të dhënat nga bisedat, duhet të mbahen në vend të sigurt dhe nga ku mund të aksesohen lehtë¹⁶. Ekipi duhet të monitorojë nga afër mbarëvajtjen e procesit ligjor dhe të jetë i përgatitur për të dhënë ndihmë sipas nevojës.

5.77 Në qoftë se në një njësi ekonomike ka një numër relativisht të madh rekomandimesh të bëra për të shmangur rreziqet portokalli, mund të jenë me vend të caktohet data e inspektimit të ardhshëm. Nëse inspektimi është parashikuar brenda vitit kalendarik, duhet t'i vihet në dispozicion memo Shefit të Mbikëqyrjes dhe Drejtorit Ekzekutiv. Përndryshe, ky duhet të jetë një ndër faktorët e marrë parasysh gjatë planifikimit vjetor.

Rekomandimet pasuese

5.78 Progresi në zbatimin e rekomandimeve duhet gjurmuar nga vetë subjektet dhe nga AMF-ja. Planet e masave të rëna dakord me subjektet e mbikëqyrura duhet të përdoren si dokument për kontrollin mbi zbatimin e rekomandimeve. Në qoftë se njësisë ekonomike i është kërkuar të bëjë përmirësime, asaj i duhet kërkuar në raportin

¹⁶ AMF mund të blej, në kohën e përshtatshme, një sistem IT-je për menaxhimin e dokumenteve për të lehtësuar ruajtjen e provave që mund të jenë të nevojshme për në gjykata.

përfundimtar që t'i raportojë përsëri AMF-së pasi të jenë vënë në jetë përmirësimet. Nëse nuk merret konfirmimi se janë ndërmarrë veprime kur është rënë dakord, ekipi duhet ta sqarojë subjektin se çfarë ka ndodhur dhe duhet të marrë në konsideratë veprimin përshkallëzues, siç parashtrohet në seksionin e mëparshëm. Procedura për fillimin e këtij veprimi duhet të jetë në përputhje me atë që ndërmerret për çështje (të tjera) serioze jashtë vendit, në paragrafet 4.17, etj.

- 5.79 Veprimet e premtuara duhet të konsiderohen si pjesë e inspektimit të ardhshëm në vend, së bashku me dokumentacionin e masave pasuese të vetë subjektit. Ekipi i mbikëqyrjes duhet të mbajë një regjistër të rekomandimeve, së bashku me raportet e zbatimit të tyre nga subjektet, si dhe konfirmimin nga inspektimi tjetër që këto rekomandime janë zbatuar. Siç është shpjeguar në Kapitullin 2, për aq kohë sa subjekti raporton progres të mirë kundër plan-veprimit dhe qeverisja e tij është K ose më lart, mund të mos ketë asnjë nevojë të ngutshme për një inspektim të mëtejshëm, me gjithë çështjet e gjetura me rreziqet individuale.

Aneksi

Lista e shtojcave

Shtojca 1: Parimet e mbikëqyrjes

Shtojca2: Vlerësimi i qeverisjes dhe menaxhimit të rrezikut në subjektet e mbikëqyrura

Lista e materialeve

Këto formularë përdoren për planifikimin dhe dokumentimin e mbikëqyrjes së fondeve të pensioneve dhe janë të disponueshme ose në versionin në Word ose në Excel. Ato listohen këtu duke specifikuar dhe Kapitullit ku përmendet ekzistenca ose përdorimi i tyre.

Kapitulli 2

2.1 Dokument model për strategjitë e zbutjes së rreziqeve sipas kategorive

2.2 Skeduli përmbledhës për rrezikun e pranishëm të Fondeve të Pensionit

2.3 Skeduli i matjeve të performancës

2.4 Skeduli i strategjive për mbikëqyrjen e Fondeve të Pensionit

Kapitulli 3

3.1 Formulari për kombinimin e vlerësimit të parimeve nga provat e dokumentuara në FPMV-të përkatëse

3.2 Matrica e asaj çfarë duhet të dinë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës qoftë individualisht dhe bashkërisht

Kapitulli 4

4.1 Shqyrtimi i procesverbaleve të këshillit të shoqërisë administruese dhe të komitetit të investimeve

4.2 Analiza e raporteve të auditimit dhe marrëdhënia me audituesit

4.3 Analiza dokumentare mbi strategjinë e investimeve

4.4 Analiza e portofolit të investimeve (Excel)

4.5 Analiza e të dhënave nga shoqëritë administruese dhe depozitarët (Excel)

4.6 Testimi i materialeve të marketingut (për tu plotësuar nga AMF-ja)

4.7 Shqyrtimi i transfertave nga fondet e pensionit (Excel)

4.8 Analiza e kapitalit të shoqërisë administruese (Excel)

Kapitulli 5

5.1 Formular për Planifikimin e Mbikëqyrjes dhe Vlerësimin: qeverisja e shoqërisë administruese (Excel)

5.2 Formular për Planifikimin e Mbikëqyrjes dhe Vlerësimin: zbutja e rrezikut të investimeve (Excel)

- 5.3 Formular për Planifikimin e Mbikëqyrjes dhe Vlerësimin: zbutja e rrezikut operacional (Excel)
- 5.4 Formular për Planifikimin e Mbikëqyrjes dhe Vlerësimin: zbutja e rrezikut të biznesit (Excel)
- 5.5 Formular për Planifikimin e Mbikëqyrjes dhe Vlerësimin: Depozitarët (Excel)
- 5.6 Fletë Pune Standarde për rezultatet e testimit në vend